

ALEKSANDËR BOJAXHI

**FJALORTH NDIHMUES PËR BJESHKATARËT,
GJURMËSAT DHE ALPINISTAT**

Dy fjalë për përdoruesit

Në pranverën e vitit 2005, tek kryeja leximin e fundit të botimit “Nëpër Bjeshkët e Namuna” (Botimet TOENA, 2005), vura re se në mjaft raste nuk kisha fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar elementët e natyrës ose të reliefit malor ashtu sikundër i kisha përjetuar. Ky fakt më dëshpëroi, por edhe më shtyu që pas dorëzimit të materialit për botim të ulem e të korrigjoj këtë mangësi në fjalorin tim të gjuhës së folur e të shkruar. Për këtë qëllim kalova nëpër duar botimin “Fjalor i Shqipërisë së Sotme” (Botim i vitit 2002), si dhe fjalorë të tjerë dhe nxorra prej tyre më të shumtat e fjalëve të gjuhës sonë që përshkruajnë elementët e natyrës e të reliefit, por edhe fjalë të tjera për të cilat përvoja e veprimtarive në natyrë më shtynte të mendoja se janë të nevojshme për tu shprehur dhe për të komunikuar shumëçka që lidhet me jetën në natyrë. Kjo punë më dha këtë fjalorth.

Në këtë fjalorth ka fjalë të cilat kanë më shumë se një kuptim a përdorim. Në kësi rastesh jam kufizuar kryesisht në spjegimin e përdorimit të fjalës, me ndonjë përjashtim të rallë, që lidhet me elementët e natyrës dhe të reliefit.

Uroj që për dashamirësit e natyrës, gjurmësat e alpinistat ky fjalorth të jetë i vlefshëm si për të shprehur e komunikuar sa ma mirë e ma drejtë atë që përjetohet në natyrë, ashtu edhe për të hedhur në ditarë sa më plotësisht përjetimin!

Aleksandër Bojaxhi, Prill 2005 - Nëntor 2007

A

Acar/í = acarinë = të ftohtë i madh, i thatë e me ngricë, cingërimë, cikmë, thëllim, akullimë, fraq, athtimë; acërim/ë/a = acari.

Af/i/e/et = shkëlqim i diçkaje i cili ndryshon në vartësi nga këndi i ndriçimit.

Afërina/t = afërsi.

Áfraz = áfrazi = nga afër.

Aft = frymë, afsh. (përdoret për dukuri të natyrës : *afti i borës bjen të ftohtë; bahen/piqen pemët prej aftit të lumit*).

Aftím = pui e mëngjesit a e mbrëmjes.

Ag = drita e dobët para se të dalë dielli, fillimi i agimit.

Agth = fillimi i agut të ditës.

Agmí = zbardhëllimë, koha pak para agut; i pastër, zemërbardhë.

Agoshi-i = rrëke-ja.

Agshól = agu i mëngjesit.

Agullimë = ag.

Agullohet = vishet, mjegullohet.

Aht-i = aft (ahti i kullotave të freskon).

Ájem = enjtem.

Ajgët/oj/ova/uar = shquaj për së largu; përgjoj nga larg.

Ajhá = sajë me rrëshqitë në borë, fylë (rrëshqitës).

Ajkësin/ë/a = tokë e butë që mban ujë; tokë mbujake (mbujake = që është nën ujë; i lagësht).

Ajnik = erë e fortë që fryn nga deti.

Ajri = hapsirë e lirë mbi tokë.

Ajrish/ëm-me = prej ajri, si prej ajri.

Ak/el = kamare e vogël në faqen e brendëshme të murit pranë dritares.

Akull = ujë i ngrirë, cingor.

Akullaç/i/ë = rrasë akulli.

Akullemë = mjaft i ftohtë (uji, moti).

Akullishtë = vend i mbuluar me akull; akullnajë; copë a hell akulli; akullaç = rrasë akulli.

Akullsi = akulluar = shumë ftohtë.

Alb/ër/ra = ashkël a cifël druri.

Albërishë = vendi ku çahen drutë.

Aliq = guralec; tokë me guralecë.

Alpinist/e/a = një që ngjitet në male a kacavarret në shkëmbinj nëpër rrugëkalime të njohura ose të pa njohura.

Allgí-ni = gacë e shuar.

Ambient = mjedis.

Amcanik-u = lidhëz opinge, gjalmë.

Amë = burim (edhe fig) + am/ë-a = shije dytësore (në gojë) e mirë ose e keqe.

Ámëz = erë tjetër e lehtë që e merr një ushqim; kundërmim (amëz e keqe); era që shoqëron afshin e zjarrit a të tokës së lëruar.

Ámtë (i,e) = i pa shije.

Amt/on/oi/uar = fundëron, bie në fund; bie ngadalë; qëmton (bora).

Anavend = anë, vend, vis.

Ançinë = anë mali a kodre me bimësi të varfër; rrip toke pa vlerë për kullotë a mbjellje.

Anepërqark = rreth e rrotull.

Anëcak-u = gur që lihet pak i dalë në një mur e që shërben si shkallare.

Anëmi-a = vend që nuk e zë era.

Anëpërtej = në këtë anë e matanë, nga një skaj në tjetrin.

Anëpranë = rrotull, përreth.
 Anësisht = tërthorazi, jo drejt e lart.
 Anësoj = rregulloj anët e një barre që të peshojnë njëlloj, barazpeshoj.
 Anësuj/ë/a = ishull.
 Áng/ërr/rra = + zgavër.
 Angël = në gjendje të ngrirë, koçan: *jam ftohur e jam bërë angël*.
 Angështi = ngushtësi.
 Ænie/a = rrip i ngushtë anës arës që lihet i pa punuar = anurinë, anëse, ceparak, fundajë, mëkrejsë, brinajë.
 Anore-ja = sejcila nga dy pjesët e përparme të xhupit.
 Ánz/ë-a = shumë i ftohtë (uji): *kroni e ka ujët anzë*.
 Apokalips/i = fundi i botës (sipas fesë së krishterë).
 Aput/ë-a = dredhë lëkure me të cilën qepet ose thurret opinga e grisur; dërzllinë, zhdevllinë.
 Ara-mara = rrëmujë.
 Aralec-i = bisht are, arë e vogël.
 Araret = etje.
 Áras = jashtë në fushë; nëpër ara; sheshit (doli áras).
 Ardhángur (i, e) = i këndellur, i fuqizuar, i ripërtërirë.
 Ardhágem = fitoj njomësi e gjallëri; këndellem = gjallërohem.
 Arnaj/ë-a = arë.
 Aroj = marr rrugën, drejtohem kah: *dhitë po arojnë kah shpija*.
 Artos/ë-a = dera e vathës.
 Aruq = grellë (vend i ngrënë nga uji, humnerë buzë ujit), humnerë.
 Arrtim = alltim = të ftohtë i madh, cegmë.
 Astrid/ë-a = xixë.
 Ash/e/ja = shkurre e viseve malore, me gjethe të ndritëshme, me gjëmba e gjithnjë të blerta e me lule të bardha e cila rritet edhe si bimë zbukuruese.
 Ashkël = copëz e hollë druri që del kur çajmë a presim një dru me sopatë, bujashkë, bluashkë, ashër, citë, lashkë, flashkë, cifël, cipal, cokël.
 Ashk/u = gjendje e ngrohtë e tokës gati për mbjellje; fig. *dëshirë e zjarhtë*.
 Ashpëran = i ashpër, i egër, i rreptë (*burrë ashpëran*).
 Ashpëri = ashpërsi; acar, kohë shumë e ftohtë.
 Ashpërinë = tokë e thatë dhe e shkërmoqur.
 Ashra = copa druri të cilat mbulojnë çatinë.
 Ashtë = ahishtë.
 Atjenalt/e-ja = arë a vend që ndodhet lart krahasuar me vendin ku ndodhem; e kundërta: atjeposht/ë-ja.
 Ath = mpij (na athti duart acari).
 Athtimë = athëtimë = të ftohtë i thatë e me erë = thëllim = fraq, acar, ngricë, cikmë.
 Atthohem = mpihem nga të frohtit.
 Aureolë = brerore, rreth i shkëlqyer përçark një sendi të ndritshëm, lëmë.
 Aurorë = ndriçim i qiellit përpara se të lindë dielli, agim, ag, zbardhëllim.
 Av/ëm-ma = erë e rëndë (e diçkaje si ushqim, etj.).
 Áv/ër/ra = zagushi; afsh i nxehtë; afsh zjarri (*bën avër*); erë e mprehtë dhe e ftohtë, thëllim; akullishtë.
 Áv/ër/ri/ra/rat = vend i hapët, hapësirë; tokë e gjërë e pa punuar.
 Avis = greminë, hon.
 Avrohem = ënjtem e skuqem nga thëllimi (*mu avruan duart*).
 Avullá-ni = zjarr i madh, flakadan.

B

Babunjosur = fryrë, ënjtur (*këmbë të babunjosura*).

Back/-a = lesh i mbledhur e i bërë kokër në dyshek, i bërë bas: *e lava thesin e fjetjes dhe është bërë backa-backa*.

Baç-i = dizgë, brezëmbrek (“kanali” nëpër të cilin kalojmë llastik ose fill në veshjet tona, në qese, etj.).

Baçill/ë-a = ujmbledhës i vogël për ujitje, pus.

Baçun-i = brigje kënetash krijuar prej rrënjësh.

Bahe-ja = bake-t = prag (kërrabë me llastiqe për të gjuajtur zogj, gjojcë).

Bah/ër-ra = litar.

Bajm-i = pagëzim; bajmoj = pagëzoj.

Bajmakthi = (ecje) duke i hedhur këmbët anash.

Bajtës = bartës, transportues.

Balco/j = bëj baltë; thërmoj, coptoj.

Balç-i = litar i hollë.

Balçak-u = tokë me ose pa bar që kullon ujë; tokë e qullët, butí, përلاغë, ujishtë.

Balçinë = kullotë me ligatina, balçak.

Balok = shteg i dukshëm.

Baltik = që ka lagështirë: tokë baltike = tokë me lagështirë.

Baltovinë = vend me baltë, baltinë, batac, baltishtë, lluc, llum.

Balladër = ujvarë; humnerë.

Ballamar = litar i trashë për të lidhur anijen në port, cimë.

Ballanike = dërrasë që përdoret në vend të tjegullës.

Ballësinë = shpat, shpatinë.

Ballësore = vend i rrafshët në një shpat mali.

Ballicë = shami që lidhet në ball.

Ballishtë = shpat mali i qitur që shihet dhe sheh nga të gjitha anët ; vend për të soditur visoren/pamjen.

Ballk-u = tokë e fortë, tokë që mezi punohet.

Balltog-u = gur lumi.

Bang/ëc-ci = top bore, bas bore.

Baqun = trung i gërryer ku pijnë ujë bagëtija, koritë.

Barasit = rrafshoj, nivevoj, logit.

Barashk/ë-a = shi i shkurtër që bie me rrëmbim.

Bardh/ë-a = thupër me lëvore të hequr (e lëvoruar) që ngulet ditën e Shën Jozefit (19 Mars) në kullotë si shënjë se ajo kullotë u zu.

Bardhëditë = ditë e bardhë; më e mira mbarësi.

Bardhësirë = agu i ditës (ra bardhësirë).

Bardhështinë = tokë deltinore e shkrifët e pjellore.

Bardhiçkë = tokë e bardhë e jo pjellore.

Barin/ë-a = vend i mbuluar me bar, barishtje.

Baromë = gjellë pa shije e pa kripë.

Bartore-ja = vig.

Bas = top bore, bangëc.

Bastar = kasolle.

Bashkàre-t = mbetje bujashkash, shkopinjsh, etj.

Bashkarí = kullotë e përbashkët.

Basamak/u = shkallare; kangjella anës shkallëve; rradhë gurësh përforcues në të dy anët e rrugës me gurë.

Bast/ër-ra = erë e nxehtë e jugut e cila i than bimët.
 Bat-i = shkop me thumb në majë për të grahë kafshët.
 Bati-a = lodhje, plogështi, këputje e trupit.
 Batim = anim, përmbysje.
 Batinë-a = gur i madh që shërben si shenjë rruge.
 Batllak = moçal.
 Batull = dherat që ngrihen pranë bregut të detit; gur nënujor i rrezikshëm për mjetet e lundrimit.
 Baujtës/e-ja = ujare, grua e ngarkuar me ujë dhe që e bart ate.
 Bdoro/hem = gatohem, gatitem, bëhem gati (për rrugë).
 Benë/a = ana e veriut; vend që e rreh era.
 Beçit/ë/a = hurdhë me ujë që buron nga toka.
 Berrebaj/ë-a = tokë e lënë djerr.
 Bërlin/ë-a = tokë gurishtore.
 Bërmaj/ë-a = pëlhurë marimange; endë, pezhishkë.
 Bërshniz/ë-a = flokë bore përzier me pika shiu; shtresë e hollë bore.
 Bërrakë/a = pellg me ujë të ndenjtur, hurdhë; moçalishte.
 Bërrore-ja = bërore.
 Bërrylor/e-ja = rrugë me leqe, me lakadredha; leqe.
 Bëstin/ë-a = thupër.
 Bëz/i/e/et = breg a kodër e vogël rëre buzë detit; plis i madh dheu; copë toke me bimësi të dendur në mes të kënetës; grumbull kashturinash në kënetë që lëviz e duket si ishull.
 Bëzdyç-i = cung, trup lisi i thatë.
 Bicul/e-ja = shpat a lëndinë e vogël me bar e rrethuar me drurë; lirishtë.
 Bifk/ë-a = bisk, pip, pipth i shurtër në majë të beretës a qeleshes.
 Bigë = shkëmb me majë; mal me dy maja.
 Bigurr-i = gur gëlqeror; fundëri e gurtë që le uji kur zihet në enë.
 Biraçok/u = vrimë e vogël.
 Bir/ë-a = shpellë, guvë me grykë disi të ngushtë (kur është vertikale nuk ka kuptimin e shpellë-s).
 Birëzez/ë-a = vorbull në lum (në gojdhana si e pafundme a si banesë qeniesh mitologjike); dredhujë.
 Bírrem = (vetveprorë) bie e coptohem prej një lartësie; vritem.
 Bistek = një lak i vogël (në opinga laku ku kalon dredha për tu shtrënguar pas këmbës).
 Bishinjë = rrip toke midis dy rrjeshtash me hardhi.
 Bishtak-u = vend i veçuar në mal a në pyll.
 Bizhatë (me) = mpihet trupi a një pjesë e tij e bahet sikur lëvizin miza nëpër te.
 Bjeshkë = mal i lartë me kullota verore.
 Bjeshkatar = një që ngjitet maleve e sodit malet, turist malor, alpinist.
 Bjeshkësi = malësi.
 Bjezgë = ashkël e vogël druri, spicë.
 Bjezgo/j-va = bëj në fije a copa të vogla (p.sh. një dru që të ndez zjarrin); ashkloj, spirroj.
 Blacë = kullusmë, ferrishtë, kule, pyll i ulët, vend me shkurre, ferra e driza; dëndësirë.
 Blerinë = vend me blerim; lëndinë.
 Blerishtë = vend i bleruar.
 Bleror-e = blerak, i blertë: *kullat e bardha mes livadheve blerore*.
 Blerosh = i blertë.
 Blirim = vërshim.
 Blokëra/t = lëmishte, të fshirat (*fshiu blokërat*).
 Bllacë = truall i vogël me ujë e baltë (bllacore), ligatinë.
 Bllatishtë = vend me ujë e baltë.
 Bllut/ë-a = baltë e ujshme.
 Boenë = vërshim i ujrave jashtë shtratit të lumit, përmbytje, vërshim.

Boj/ë/a = shtat; lartësi sa shtati i njeriut.
 Bokë = tokë e ngritur e me gurishte; vend i çveshur.
 Bokz/ë-a = shpat mali.
 Bórde/ja = e çarë në mur; birë, vrimë.
 Bordollin/ë-a = gjir(vorbull, shtjellë) uji.
 Borë/a = fije, endë; pah, fjolla bore.
 Borëbrym/ë-a = borë e hollë si brymë; borësinë, zborimë, llohë.
 Borëto/j-n = bie borë, lëshon borë.
 Boricë/a = dëborë e hollë e me erë shumë të fortë; erë shumë e fortë që sjell borë.
 Borigë = pishë e zezë, çetinë.
 Borimë/a = borë e imët e përzjerë me shi, brazimë, mjellazë.
 Bornajë/a = borë e madhe që ka mbuluar një vend; hapsirë me borë të shumtë e të qëndrueshme.
 Boronicë = frut nga shkurret e Bjeshkëve në ngjyrë blu, qershigël = thrashegër.
 Botil/je-ja = enë me kapak a tapë për mbajtjen e gjërave të lëngëta (*botilje me ujë, botilje me vaj*).
 Botin/ë/a = vend me baltë, moçalishte.
 Brac-i = vjedhës xhepush, vjedhës gjërash të vogla.
 Bracan = hell akulli, akull që varet nëpër strehë si shkop.
 Braj/ë-a = xhungë që del pas një goditjeje.
 Brajkë = tokë e keqe, jo prodhuese.
 Brambullimë = zhurma e shiut mbi tendë (kur bie fort).
 Brazim/ë/a = brymë; borë e hollë dhe e ngrirë.
 Bregaloj = rrokullis teposhtë nga një lartësi e vogël (*bregaloi një gur*).
 Breg/ël/la = bregore e vogël.
 Breginjë = vend me brigje e bregore.
 Bregishtë = vend brigje-brigje; tokë brinjë, e thatë dhe e ftohtë.
 Bren/ë-a = tokë e rrëzuar, e shembur; greminë, vend i thyer.
 Brerimë/a = shi i madh e i rrëmbyer; të ftohtë i hidhur me shi e me erë; zhurma e shiut në kulm, tokë, etj.; zhurmë tjetër e ngjashme me këtë.
 Breron = bie shi i imët e i dendur pa pushim, shinon, imton, qëmton, rigon.
 Breshman = shkëmb i madh me gurë (si breshër) e me dhé nëpër te (si i gatuar me gurë e dhe).
 Breshni = breshër i dendur dhe i hollë.
 Breshnizë-a = borë e imët; borë brëshni.
 Bresht/em/a/ur = ngrij, bëhem akull; fig. *bëhem i egër*.
 Brez-i = brezabel, shokëqielli, vojufull, (turqisht ylber), ngjyrosh, brezi i diellit, brezi i shiut, brezi i zonjës, shika e shiut, shoka e zonjës.
 Bri/g-u = plis që e çon plori në arë.
 Brijok/e-ja = brinjë e vogël mali, brijzë.
 Britm/i = vjeshtë; britmi i parë = Shtatori; britmi i dytë = Tetori.
 Briz/ë-a = kullotë a pyll në brinjë; shpat, vend i pjerrët.
 Brokë = xhungë, bëllungë; + enë për lëngje, kanë, çini.
 Bruhaj/ë/a = tokë e shkrifët.
 Brus-i = grihë, gur i ashpër që përdoret për të mprehur.
 Bruztë = i kaltër në të gjelbërt; i rimtë bruztí = kaltërsi.
 Brymishtë = borë e imët që ka zbardhur tokën.
 Brymo/hem-n = mbulohet me brymë.
 Braçin/ë-a = tokë që kullon ujë; ujë bërrakash, moçalesh.
 Bresharak-u = breshërim-a = breshër i hollë.
 Breshnohem = ngrij, ngurtësohem.
 Bric/ë-a = strall.
 Britm-i = vjeshtë/ë-a.

Brym/ë-a = rreshje si borë që krijohet nga ngirja e vesës mbi tokë, bar, etj., brazimë, mardh, caf, ciknë, cikmë.
 Brymës-i = Nëntor.
 Brymori = Nëntori.
 Bubulak-u = zjarr me flakë të mëdha dhe që brambullin, flakadan, brambull.
 Bubulin/ë-a = zjarr.
 Bucak-u = moçal.
 Buc/ë-a = plis are; plis me bar, bukëbar; top bore.
 Bucin/ë-a = bar i njomë që del vonë në vjeshtë; borë e butë; mot i butë me shi por pa erë e pa të ftohtë.
 Buçall/ë-a = vendi në pendë, pritë, ku grumbullohen ujrat.
 Buç-i = gjarpër-i.
 Buçill-i = vend i thellë në lumë ku lahemi.
 Buçill/ë-a = pus me ujë të ndenjtur, llogaçe.
 Buen/ë/a = bujanë = vërshim ujrash; rrjedhë e gjërë ose pellg i madh e i thellë.
 Bufnjak-u = bor/ë-a.
 Bufnjak-e = e shkrifët.
 Buhaç = dhé i shkrifët në ngjyrë kafe.
 Buhar-i = tokë e thërmuar.
 Buj = flej, kaloj natën; kaloj disa ditë si mik diku; banoj.
 Bujashk/ë-a = ashkël druri, petëz e hollë dërrase që del nga zdrukthi.
 Bujtarí = mikpritje, bujtësi.
 Bulçim-i = bulçim/ë-a, vapë e madhe, ufëm.
 Bulqizë = fermë, (çiflig në turqisht).
 Bulso/j = buron, rrjedh (uji).
 Bullake = vend me ujë, pellg, pus.
 Bum-i = maja e gjetthes.
 Bun-i = truall i tëbaneve; tbanishtë, telë; vend ku me kalie natën; vend ku flenë gjëja, ahër.
 Bunac/ë-a = errësirë, sterrë; amulli.
 Bunak-u = dru që mbështetet mbi dy urëzat e oxhakut me i mbajtë drutë e tjera kur do të ndizet zjarri; ancë, unak.
 Bunishta-t = hedhurina.
 Bunishtë = stan në bjeshkë, bun, telë; vend ku qitet plehu, plehërishtë.
 Bukëbar/i = plis dheu me bar të dendur që pritë e përdoret për zbukurim diku (në lulishte).
 Bulçim/i = vapë e madhe mbytëse; ufëm.
 Bullëndër = ujë i ngrohtë me kripë për të përvëlur këmbët.
 Bun/i = tëbanë, shtëpi a kacolle me gurë të palidhur.
 Bunac/ë/a = det i qetë para furtunës; errësirë e madhe; fig. *qetësi e plotë*.
 Bund/ë-a = erë e fortë e me lagështirë.
 Buq-i = gur lumi i bardhë e i rumbullakët.
 Burbuqet = çelet e lulëzohet.
 Bur/ë/a = det i trazuar.
 Burisht/ë/a = vend me burime të vogla uji; ligatinë.
 Burmak-u = shkop i fortë me një burmë të trashë në majë, çomage.
 Buron = del, gurron, shpërthen, gufon.
 Butac-i = tokë e butë e mirë për perime.
 Butësin/ë = vend me bar të butë; bucinë.
 Butësir/ë/a = mot i butë, kohë e ngrohtë (sidomos në dimër); vend i butë e me lagështirë.
 Buti-a = vendi i lagët, me baltë; zgori (gropa) i kroit, pjesa e gërryer e vendit ku del uji.
 Butthohem = shfaqem, dukem, dal në shesh.

Buxhil-i = gropëz ku del pak ujë nga poshtë e nuk rrjedh; luxhik (pus, bunar i vogël që shterr); krua me pak ujë e jo të mirë; pusi a gjiri ku bie ujvara.

Buzëbreg = toka buzë ujit të mullirit.

Buzëgallë = vend i errët e i thellë, hon.

Buzm = kërcu i madh; kërcu i trashë që vihet në zjarr natën e kërshtëndrellave (nata e buzmit = nata e kërshtëndellave, apo e krishtlindjes).

Buzërripë = shembëtitirë, shkarëzimë, shkazmë, rrëzimë.

C

Cabik = pjesa e tringut që mbetet pak mbi sipërfaqe kur pritet një pip; shkurre; çapur.

Cabok/u/ë/ët = stom (stom/i = rrip toke që ngrihet për së gjati në një vend të rrafshhtë; breg dheu, bregore; ledh që ndan arat; rrip toke në mes të një lumi a në mes të një kënete); copë dheu, guri a druri; kërcu i vogël.

Cak-u = vija anësore që kufizon diçka, skaj, brinjë, anë, kufi.

Cakërr = i kulluar, i kthjellët: *uji i cakërrt*.

Cakërrí /a = shi i ftohtë i përzjerë me borë, llohë; acar.

Cang/ë/a = frut i papjekur e i fortë.

Cang/ël/la = mbërtheckë; kapse robash; varur pezull (*e mbante këmbën cangël*); (*e ka mendjen cangël = ende nuk ka vendosur*).

Capan = yzengji; litarët e bëroreit me të cilat lidhen barrët e kalit.

Cap/ë-a = dhë a shtrat dheu i forcuar si çimento, i gurëzuar; dhë i bardhë.

Capinë/ a = tokë të cilës i është gërryer pjesa e punueshme dhe i ka dalë tabani; tokë me capë.

Caran = gur vatre.

Cavurr/ë-i = gur i vogël, guralec.

Ceg/ëm-ma = i ftohtë i madh e i thatë, acar; arrtim, të cegmët, të cemtë; ngricë, shuku i të ftohtit.

Ceg/ëm-mi (i, e) = acari; që është me acar: *dimër i cegëmt*.

Ceh-u = tokë me gurë e ranë.

Celinë = taban i tokës; gurishtë; ngricë, të ftohtë i madh.

Cem = përrua malor me ujë të ftohtë e të kulluar.

Cemtë = shumë i ftohtë e i kthjellët; cegëm, ngricë.

Cënuq-u = krejçë, nënkrejçë, përkresë, cumër, (turqisht *jastëk*).

Cetin/ë-a = cegëm: *asht cetinë e madhe*.

Ceparakthi = kryqas.

Cepik/u/ë/ët = hell akulli.

Cër/i = pisku i vapës (*në cër të vapës*), zhegu.

Cërk/ë/a = cirk/ë/a = pikë e vogël uji që bie nga lart e përplaset me forcë.

Cërkohem = ciklohem = bëhem me cirkëla.

Cërri = vijë fare e vogël uji që ndahet më vehte nga një rrjedhë; rrem uji; mulli që bluan me një vijë të hollë uji; cërron = rrjedh nga pak, del si curril).

Cërrkaç /i/ë/et = krua me pak ujë = cërran; vijë fare e vogël uji e cila ndahet më vehte nga një rrjedhë uji, rrem uji).

Cërka/ni = curril, rrëke.

Cërmok = tokë e fortë me guralecë.

Cërrfat = shkrep urët e zjarrit që të ndizen më mirë.

Cërrkaç-i = rrjedhë me një curril të hollë uji.

Cërrlek-u = curril.

Cfag/ë-a = pëlhurë marimange.

Cibak-u = cibarak = acar, cegëm.

Cibël = pus i vogël që mbushet me ujrë e shirave; sternë.

Cig/ë- a = gur i butë; cipë e hollë që ve guri prej lagështisë; bigor, çmërs.
 Cigore/e-ja = vend që e merr djelli tërë ditën.
 Ciknë/a = acar, ngricë; brymë.
 Cikol/i = kodër me majë; majole (*cikol më cikol = majë më majë*).
 Cil/ik/ku = përrua i vogël; rrëke.
 Cilivang = pezull.
 Cimbthi = shtrënguar (*nyje e lidhur cimbthi*).
 Cim/ë/a = litar i trashë për lidhjen e anijes në breg; litar.
 Cingrimë = të ftohtë i madh; acar; ngricë.
 Cingëroj = mbërdhij shumë.
 Cingëruar (i) = i akulltë.
 Cingor-i = acar-i, akull-i, hell-i (i akullit).
 Cirkatë = curril që del me forcë cirka-cirka, cirkojë, cërcatë, curril.
 Cit/ë-a = cif/ël-la, kunj, pykë, sfinë.
 Cjepur-i = ciklon-i, vorbull-a.
 Cmil = ve për udhë, lëmbar; cmilem = vihem për udhë, lëmbarem.
 Cog-u = gur që vihet tek pragu i derës për me hy lehtë; mur rrethues i një pusi.
 Cokat-a = e pres pak; i bëj një kllapë.
 Cok/ël-la = copë e cogël guri; ashkël; guraçok (guralec).
 Crog/a/ur = e zhvesh një vend nga drurët; i heq qimet ose pendët (për shpendët).
 Crogë = vend i çveshur nga drurët; vend i çveshur në mes të pyllit; pullë; larë.
 Cubak-u = dru, shkop i shkurtër e i trashë.
 Cufël/la = flokë të trashë dëbore.
 Cuk-u = guralec.
 Cuk (ndajfolje) = mënyrë puthje formale (zyrtare): *e puthi cuk në faqe*.
 Cukan-i = majë guri.
 Cuk/ël-a = copë e vogël mjegulle a reje.
 Cuklaj/ë-a = majë mali e çveshur; çukë.
 Cukth-i = kodër e vogël.
 Cungal = hell i shkurtër e i trashë akulli.
 Cungshtë = tokë me trungje, cungajë.
 Cunglaj/ë-a = mal i çelur për tokë buke.
 Cupërrel/ë/a = majë e thepisur e një kodre; kodrinë e çveshur.
 Curr = shkëmb i lartë me anë të thepisura.
 Cyc-i = kapuç i palltos a i xhupit.

Ç

Çaf/ i = brymë; cipë akulli.
 Çakëllimë = gurishtë.
 Çallamit/em = coptohem keq në një përplasje duke rënë nga një lartësi.
 Çallatë/a = e thelluar që bëhet në dru, në gur, etj., kur hiqet a pritët një pjesë; plasë.
 Çam = bredh.
 Çanësim-i = orientim.
 Çaparaqorras = duke ecur si i verbër.
 Çapëtir/ë-a = moçal me dy gisht ujë.
 Çapua = thua i fortë; kthetër; pjesë e diçkaje të kthyer si kthetër.
 Çardak = pìrg gurësh që shënon vendin e një ndodhie; vend për të ndenjtur në shtëpi.
 Çar/ë/a = plasaritje e thellë.
 Çavarr-i = gur që çahet lehtë.

Çavarrinë = vend me çavarrë.
 Çavran = gur gëlqeror që nuk gdhendet a latohet.
 Çbu = mënyrë e zbrazjes së një thesi a çante duke e përmbysur e duke i nxjerrë të gjitha gjërat mënjëherë: *veç kur i bënë/lëshuan/bane teshat çbu prej thesit.*
 Çeftir/ë-a = vend i fshehtë.
 Çek-u = skaj (turqisht qoshk).
 Çekáh = nga një vend që nuk dihet.
 Çelí-a = mal a pyll i çelur i shndëruar në tokë buke; cunqlajë.
 Çelnik-u = pronar i një tufe të madhe bagëtish, skutér-i.
 Çelojç/ë-a = çeltinë, lirezë, lëndinë.
 Çelovin/ë-a = vend i parrethuar, i pagardhuar.
 Çeltinë = çeltirë, lirishtë (lirishtë = kullotë e vogël në mes të pyllit); *Çeltina, emër vajze.*
 Çem = gdhe; degë e thyer lisi e thatë; çepur; gremçat e brirëve të kaprollit.
 Çem/ërr-rra = marrje mendsh sidomos në shkëmb, pemë, urë, etj.
 Çepka = karthje të thata për zjarr.
 Çepoj/ë/a = borde/ja = e çarë.
 Çeptirë/a = pellg i vogël me ujë = ligatinë, pelligshte, moçal.
 Çetinë = pishë e zezë; borigë; fig. *flokë të ngritur përtpjetë (e që sot janë në modë).*
 Çetinak-u = çetinë e re; çetinë si shkurre.
 Çërroj = rrjedh ujë me zhurmë prej gurrës.
 Çërrokull/a = rrjedha e krojtit.
 Çikël (uji) = cirkë = stërkite (uji, pyshtyme).
 Çikërrán-i = burim i vogël uji me një curril të hollë, cikërrim-i.
 Çikërron = pikon nga pak = stërpik.
 Çikul/i/ë = rreth me thupra shelgu që shërben për të ecur mbi borë e duke u lidhur nën këpucë.
 Çil = i përhimtë, i hirtë.
 Çilatet = lirohet e hapet paksa (dera, kapaku).
 Çlidhje = zgjidhje.
 Çlirët = që është liruar a është lidhur jo shtrënguar.
 Çog-u-gje = vend i sheshtë në një brinjë mali a majë kodre.
 Çojë/ = shpërngulja e bagëtisë nga fusha në bjeshkë për të veruar; bagëtia që është shpërngulur për të jetuar në bjeshkë, verimi.
 Çol-i = moçal-i.
 Çopárka/t = rraçe, rrangulla.
 Çrras = heq diçka të rrasur.
 Çrrasët (i,e) = jo i dendur, i shkrifët, i çlirtë.
 Çuç/i/a/at = zog i porsadalë.
 Çuçlon = gurgullon = çuçurit = shushurinë (ujrat).
 Çufrak/e = tufshat (që ka tarjtën e një tufe, që del në tufë: *gentiana është një lule tufshake*; i dendur e i derdhur (për flokët); që e ka shtatin të shkurtër, trupvogël, shkurtabiq (*plak çufrak*).
 Çukar-i = gropa me bar për kullotë ndërmjet shkëmbejve; gërdhatë.
 Çuk-u = mëz; majë gropore e malit.
 Çuklin/ë-a = vend i ngritur në formë mollake.
 Çukal/e/ja = çukë e vogël.
 Çukë/a = majë e lartë, zakonisht e veshur e një mali a një kodre; mal a kodër me një majë të tillë.
 Çurkajë = çurkë e madhe; rrëke.
 Çup-i = truall, vatër zjarri.
 Çupalinë = ashkël me ndez zjarrin; mjet fillues i zjarrit.
 Çurg/u = fill uji që rrjedh nga lëfyti i kroit ose burimit (turqisht çesmë).
 Çurrel-i = curril.

D

Dadë-a = mëmëzonjë (turqisht gjyshe); nënë; motra e madhe.
 Dal/ë-a = jashtëqitje.
 Dallgore = breg shkëmbor ku përplasen dallgët.
 Dash deti = pelikan.
 Daulinë = tufë me bar të thatë ose me kashtë të cilën fëmijët e ndezin dhe e mbajnë si pishtar në ditën e verës (14 Mars) ose për Shëngjergj (5 Maj).
 Daravit = heq, shpërndaj.
 Dardall/ë/a = shkop i gjatë që lëviz lirisht duke u mbështetur mbi një shtyllë pingule dhe që ka në majë një rretë për të zënë peshq buzë lumejve ose në pellgje ; patok.
 De-ja-jat = vend i rrafshët, i shtrirë.
 Degurina = copa degësh, shkarpa.
 Dejë = vend ku bora ka shkrirë fare ose është ulur; cektinë.
 Deltinë = dhë i butë që përdoret për enë balte, argjilë.
 Denik/u = erë e ftohtë që fryn nga deti e sjell shi.
 Derdhazë = vërshim; përmytje.
 Dersh/ë-a = shi i fortë, i papritur; rrebesh; shqotë.
 Dredhë/a = + shtjellë, vorbull, shakullinë (dredhë dëbore, tymi, pluhuri, ere).
 Dërrm/ë/a = faqe mali shumë e pjerrët, me gurë e pak shkurre; shkarëzimë; greminë.
 Derrp/ë-a = pyll me lëndë të shpeshtë; vend me ferra të shpeshta.
 Det/ël-la = erë e fortë me shi; detnik.
 Diellishtë = shullë.
 Dimërbardhë = dimër me borë por i qetë.
 Dimnisht/ë-a = ushqime dimri si ajvar, proshutë, reçel, turshi, etj.
 Diz/gë-ga = gjalmi që shërben për të mbajtur shtrënguar pas këmbës tirqt, çorapet, etj.; shirit a rrip prej leshi me të cilin lidhin foshnjën në djep, ndrizë, baç, urje, retër, gjalmë.
 Dóne-t = benevrekë-t.
 Doráshe-t = dorezë ku katër gishta futen bashkë në një mill dhe gishti thumbues futet më vehte.
 Dorç = mot me shi.
 Dra-u = fundëri që mbetet nga gjalpi i tretur; llum, lurbë; shtresë e rrëshqitshme e me ngjyra nëpër gurët e lumit e të ujrave të rrjedhëshme.
 Drebak-u = mal me bimësi të shpeshtë, të dendur, nëpër të cilin nuk mund të kalohet.
 Dredhaj/ë-a = vorbull ere që përdridhet duke çuar gjethe e pluhur; dredhë; pështjellcë.
 Dredh/ë-a = shirit me fill (fije) të përdredhur.
 Dredhni/e-ia = vorbull ere.
 Dredhuj/ë-a = vorbull uji që të thith, birësesë; shtjellë lumi.
 Drekt/ë-a = tryezë dekmie, mort.
 Dridhac-e = mbërdhac-e.
 Dri-ni = qull: *jam ba dri në djersë*.
 Drino/hem = fundosem, pustohe; ngrihem, ngrij së ftohti.
 Dritës-a = bishtuk, fitilaçë, kandil.
 Dritëz-a = bira në trajtë dritoresh shumë të vogla në krye të tymtajës (turqisht oxhak) e që lehtëson daljen e tymit.
 Drithërim = drithërohem.
 Drobit = raskapit; drobitem.
 Droboll = druaj shumë, drojë e madhe.
 Druç = që është prej druri; i drunjte.
 Drum = udhë e madhe ku kalojnë karvane, etj.
 Drumít = ngjesh duke e shkelur; rrah e shtyp me këmbë.

Drumoj = i bie shkurt, duke bërë rrugë aty ku nuk ka.
 Drunishtë = vend me dru; fushë drush.
 Drunohem = mbërdhij shumë, bëhem dru nga të ftohtit, drunjosem.
 Dufall/ë-a = fryrës i zjarrit, puhacë, rrëshiq, shakull.
 Dufim/ë-a = erë që ta zë frymën; duhi e nxehtë, e keqe.
 Duham/ë-a = era e fortë që i paraprin ortekut a një shembjeje masive.
 Duhi = furtunë, stuhi, shtrëngatë; mot i duhishëm.
 Duhmë = erë e keqe; ufëm (vapë e madhe e mbytëse, bulçim); 2. vrulli i erës; duhi.
 Duk-u = efekti.
 Dultin = dulltak = granit.
 Dull/ë-a = bira buzë lumejve ku mblidhen peshqit.
 Dumbllin/ë-a = ushtimë.
 Dund-i = vend ku rrëshqet dheu.
 Dun/ë-a = kodër rëre
 Duq = shuk; rrumbullak.
 Dyjoj = ndaj një mall në dy pjesë sipas cilësisë; përzgjedh.
 Dyltinac/ë-a = tokë e bardhë e jo pjellore.
 Dyndallë = vërshim.
 Dynym = 1.000 m² sipërfaqe.
 Dyshtoj = ndaj më dysh.
 Dyzyn/ë-a = mbulesa anash syve që i vihet kalit.
 Dyfaq/ësh-shi = që përbëhet nga dy faqe, që ka dy anë; diedër: *më tej itinerari vazhdonte më një diedër/dyfaqësh që si një libër i hapur ngrihej lart për 60 metra.*
 Drag/ë-a = ortek bore, reshpe.

Dh

Dhan/ë-a = dhunti e natyrëshme: *dhana e Zotit.*
 Dhekuq = që ka dhé të kuq.
 Dhenar = bari delesh = delmer, delmatar.
 Dhend/ël-a = ashkël e vogël; blloshkë, luskë.
 Dheros = bëj me baltë.
 Dhiak/e-ja = rrugë e ngushtë mali; dhiare.
 Dhiar/e-ja = monopat, udhë shumë e ngushtë nëpër brinja e maja; rrugë dhishë.
 Dhagiç = petashuq, rrasik.
 Dhrimi = plakat, apo 12 ditët e Gushtit.

E

Ecatem = shetis, endem.
 Egërti = bishë.
 Ehu/ll/lli = hell akulli; vesë e ngrirë; erë e ftohtë që fryn në mëngjes herët.
 Elmash-i = lëmashk, myshk, lëmash.
 En-i = copë e vogël are (toke).
 End/ë-a = pëlhura e merimangës; bërmajë.
 Endëz-a = fundërrina e imët e sanës.
 Endj/e-a = flok bore: *është më i bardhë se endja e borës.*
 Erak = skifter.
 Erar/i/ë/ët = vend që e zë era ; vend ku pushon gjëja e gjallë gjatë verës.

Erë = rrymë ajri që lëviz në drejtime të ndryshme; ribë, bundë, ajnik, denik, malijë, veri, vore, fyryfyçkë, frashi.
 Erëborë = erë bore.
 Erëdredhë = shakullinë, dredhë.
 Erëdhë = që i vjen era dhë.
 Erëkeqe = erë e përzjerë, që fryn nga drejtime të ndryshme.
 Ernaj/ë-a = hapësirë ku fryjnë shumë erëra; erëra të shumta.
 Erëpirë-a = erë e ftohtë që të mpin, thëllim.
 Erëz-a = vend që e reh era.
 Erzin/ë/a = parfum.
 Errnatur (i,e) = që është errnatur; i errur.
 Errnic/ë-a = tokë e zezë.
 Es/ë-a = mëngjes
 Eshk/u = etje e madhe; eshkët (i,e) = fig. i *thatë*, i *rrudhur*; i *vakët* (për një njeri).
 Et/em/a/ur = kam dëshirë të madhe për diçka; më merr etja.
 Etje = rreshk.
 Ezheg/ë-a = boçë e gështenjës.

F

Fak-u = kurth për minj e për kafshë të egra.
 Faktu/j-n = shkrep, veton, vezullon.
 Falm/e-ja = perëndim, prarim (i diellit a hënës).
 Fang-i = shpuzë.
 Fangth-i = bar i shpeshtë e i imtë që rritet në vende kodrinore të thata.
 Faqetin/ë-a = faqe në kodër.
 Faracak = kalli a trangull për farë.
 Faraçë-t = misra të zgjedhur që lidhen gërshet e varen në mure.
 Fars = pjellor, që jep.
 Fash-i = plis dheu.
 Fashin/ë-a = thupër frashëri, shkoze, etj., që përdoret me thurr gardh.
 Fellut/ë-a = vend i thellë, zgavër, gropë; rrugë pa krye, pashtegie.
 Ferrc-e = që është me gjemba: *tel ferrëc*.
 Fënil-i = thëngjill; gacë gjysëm e shuar.
 Fërcall/e-ja = fërfëllaz/ë-a = shi e borë kur bien bashkë si dhe shoqëruar me erë të fortë.
 Fërfëlliz/ë/a = dëborë e imët e shoqëruar me erë të ftohtë = frulli/a, frullizë, furtunë, stuhi.
 Fërfëlloj = fig. *dridhem*.
 Fërkem/i = gjurmë që lënë pas njerzit, kafshët e egra e shtëpiake në dëborë, baltë, etj.
 Fërtom/ë/a = litar i trashë e i fortë; litar; fig. *pengesë a vështirësi*.
 Fështik-u = shteg i ngushtë që mezi kalohet.
 Fic/e-ja = fije shumë e hollë (bari, peni, etj.).
 Fiçor-i = guralec-i.
 Fierinë = vend me fier, fierajë.
 Figat/e-ja = moçal.
 Fijat = bie borë e imët dhe e rrallë, fije-fije, fijen, fjollon, frullis, mizon, puplon.
 Fijo/j-n = thurr kurorë me kallinj gruri.
 Fijon = bie borë fije-fije, qëmton, thekon.
 Fiklosh = lloj fiku i lëbardhmë që piqet në Gusht e fruti i rritet i madh gati sa ftoi.
 Filad/ë-a = thelë a rriskë e vogël mishi, djathi, etj.
 Filiç-i = rrahësi i tundësit të qumshtit.

Filiqe = filik = vrimë a vjegës ku futet kopsa apo ku varet roba, gojës, vjegës, thile, shtjekë, mbërthecë, syth.
 Filiz/ë-a = plasë fort e imët.
 Filtar-i = botile e vogël.
 Flokon = bie flokë-flokë (bora).
 Fillak = i gjatë e i drejtë (vertikal në pozicion).
 Fillc-i = ndelë, pelenë.
 Fillç/ë-a = pëlhurë me ind të çlirët që përdoret për të mbështjellë bukët.
 Fillo/hem-va = nisem për rrugë më këmbë a me kafshë.
 Filltar-i = punëtor i parë; rrugëtar i parë, ai që hap ose udhëheq rrugën a shtegun.
 Finc/e-ja = thupër e hollë.
 Firifick/ë-a = erë e lehtë.
 Fisk-u = thupër e drejtë dhe e hollë; bimë e re.
 Fiskajë = curril i hollë uji, etj.
 Fish = paluar: *batanija gjatë ditës mbahet fish*.
 Fit-i = pyk/ë-a.
 Fitilaç/ë-a = kandil.
 Fjollon = bie borë e imët, e rrallë.
 Flaknaj/ë-a = tërësi flakësh; flakë e madhe, përflakje.
 Flashkë = curril uji.
 Flisk/ë-a = thupër e hollë që përdoret për thurrije ose për djegje si çepka; shkarpë.
 Floçk/ë-a = flok bore kur bora bie “butë e trashë”.
 Flokësh-i = bar i bollshëm kullose.
 Flokon = bie bora flokë-flokë.
 Flosk/ë-a = flok bore; shtrat bore.
 Fluri-a = flutueshkë me të cilën lozin fëmijët e që vërtitet kur ata vrapojnë; borë që bie me flokë të rrallë e të imët; borë që fijat.
 Flyrç = që bën not a që shkon mbi ujë: dru flyrç.
 Fllad-i = puhi-a, freski-a.
 Flladnik-u = vend pak i ngritur ku e reh era e bën fresk.
 Fllusk/ë-a = flok bore, floçkë; shtresë e hollë bore: *ra një flluskë borë*.
 Foj/e-a = petë guri; rasapetë; grimcë guri e thyer.
 Fok-u = çdo bar që thahet në tokë pa u kositur.
 Fon/g-gu = hi e prush bashkë; shpuzë.
 Forb/ël/la = pjesët e qëruara të pëmëve (frutave) që i hedhim.
 Forfullaj/ë-a = vorbull ere.
 Fosk/ë-a = gropë e vogël, gërluq.
 Fous-i = burim uji jo i thellë.
 Frash/i/a = erë e ngrohtë që fryn nga jugu (*fryn frashía*).
 Frenjë = Gërbunjë = vile rrushi pa kokra.
 Freskohem = flladitem, fig. *këndellem*.
 Fri-a = grumbull, truç (truc) i madh bore i bërë nga era.
 Frij/ë-a = borë që e ka mbledhur era.
 Froj/ë-a = ortek, rreshme.
 Frulli-a = frulliz/ë-a, fërfëllizë, furtunë, stuhi.
 Frullis = bie borë e imët.
 Frulliz/ë-a = flok bore; borë e imët me erë.
 Frull/on/uar = fryn fërfëllizë.
 Frushkullon = fëshfërin era.
 Fruxh/ë-a = dërrasë-tjegull me të cilën mbulohet shtëpia.
 Fryer-i = rrubinetë druri në fund të vozave.

Fryj/ë/a = erë e fortë, frymë; borë e grumbulluar nga era në gropa e prarána.
 Frymë = + erë e fortë.
 Frymëfillad = që fryn fillad; ftohtues.
 Frymëz = tullumbace.
 Fryz/ë-a = pipë për të pirë një lëng.
 Fshehca = loja symbyllazi.
 Ftajk-u = i ftotë i thatë i madh.
 Ftik = thaj pak; (*i ftiku era petkat*).
 Ftik-u = acar-i.
 Ftohtësirë = të ftohtë = mot i ftohtë.
 Ftorit = përzrej ujë të ftohtë e të nxehtë për ta përshtatur për larje.
 Ftre-ni = merrlë bore.
 Fuf/ë-a = gur i madh që mezi meret në dorë.
 Furfule-ja = murrilan.
 Fukát = bie me forcë, lëshohet: *ia fukati shi*.
 Fulli-a = rrymë e ftohtë ajri.
 Fulltuk-u = ushël-a = flluskë që del në dorë nga puna e sforcuar ose në këmbë nga ecja e zgjatur.
 Furfule = erë e fortë dhe shumë e ftohtë.
 Furfullac-i = furfullajë, dredhajë.
 Furfullaj/ë-a = dredhnje e fuqishme, shakullimë.
 Furi = furtunë (*furitë e malit*); erë shumë e fortë, etj.
 Furtunë = erë e fuqishme e cila shoqërohet zakonisht me rreshje = shtërngatë = stuhi.
 Furzheg-u = shkop i njomë e i gjatë që përdoret me përhap shpuzën në furrë.
 Fushacak = banor i fushës, fushanJOR.
 Fushalo/g/gu/gjet = vend i rrafshhtë; shesh i hapur.
 Fushamir-i = barí-u.
 Fushëgropë = fushë e vogël që shtrihet në një vend si gropë.
 Fushëni = fushë, njerëzit e fushës; e kundërta e malësi.
 Fushëpyll = një copë fushë a shesh në mes të pyllit; lirishtë.
 Fushëtirë = fushë e vogël në një vend kodrinor a malor; luginë.
 Fushnajë = fushë e gjërë; vend i hapët fushor.
 Fushoj = vendosem përkohësisht në një vend me tenda e paisje të tjera gjatë një marshimi.
 Fushor/e-ja = vend i rrafshhtë e pak i hapur, fushë e vogël, vuth.
 Fushujë = tokë që mban ujë e lagështirë.
 Frylë = vrimë shumë e vogël.
 Fyl/ë-a = rrëshqitëse, ski.
 Fyryfyçkë= erë e fortë dhe e ftohtë.
 Fyt-i = lug i ngushtë në lartësi të pjerrta midis shkëmbejve; grykë e ngushtë lumi.

G

Gabzhor-e = i zgavërt, i brejtur prej krimbave: lis i gabzhuar.
 Gacon = shëndrit; shkëlqen.
 Gaç = hov: *jepi një gaç*.
 Gaçarrém = shkop me një gremçe që shërben me ulë degët e pemve e me u marë kokrat.
 Gaçitet = muzget, terrohet, errësohet.
 Gadishull = zgjatim toke në det i rrethuar nga tre anë me ujë, siujdhesë.
 Gafërr = gur i madh; popël.
 Gaft-i = aft; ajër: *sot është gaft i kulluar*.
 Gahas = dihas: *po gahasin delet*.

Gajgë = që e ka lëvoren të hollë e që i dalin lehtë thelpinjtë (*arrë gajgë*).
 Gajk/ë-a = vegëza për të shkuar rripin e pantallonave.
 Gajnik-u = rripi i pantallonave.
 Galamsh-i = lëmshe.
 Galamash = mbledhur lëmshe, grumbull.
 Galesh = vend shkëmbor me gurë të zinj.
 Galin/ë/a = plis i madh dheu; copë guri e shkëputur nga një shkëmb; zall = val.
 Gámu/ll/li/j/jt = ujvarë e vogël.
 Ganall-i = vend i thellë në ujë, gobenë.
 Gand = rastësisht, pa pritur, pa dashtur (*e ndeshi gand; e goditi gand*).
 Garb/ë/a = qyp a poçe me grykë të thyer; çallatë në tehun e diçkaje.
 Garbi-a = erë e fortë që fryn nga perëndimi ose j-p e që sjell shi.
 Gardhamël-i = gardh i thurur keq.
 Gardhëz-a = dajlan.
 Gardhisht/ë-a = kasolle e keqe.
 Gardhnapër-i = gardh 2-3 metra i lartë dhe hedhur ferra mbi te për të qënë i pakalueshëm.
 Garravel/i/a/at = kosh i madh për të mbledhur gjethe ose pleh.
 Garroq-i = zgavër; guall (mbulojë e fortë, si p.sh. tek breshka), zhguall.
 Garryell-i = gardh rrethor përreth një shorti (fidani) të sapombjellë për ta mbrojtur.
 Gashtull-a = copë (pllakë) dërrase ose metalike që përdoret për të lidhur pjesët e thyera eshtrore.
 Gauk-u = dru me zemër të kalbur; zgavër.
 Gaur-a = dru i gjatë fyshtë (i zbrazët përbrënda).
 Gaxhel-i = dru me degë të krasitura që përdoret për të mbajtur pjergulla, domate, etj.
 Gdhaç-i = nyje; degë e thatë që del tërthor degës së shëndetëshme të një peme.
 Geg/e-ja = kësulë e bardhë.
 Gemtë (i, e) = që del e shkon shtrembër, i shtrembër (*dru, rrugë*).
 Gemt/oj/ova/uar = shtrembëroj, eci me zigzage; fig. *dredhoj*.
 Gelvaç = mbledhur këmbë e duar.
 Gerl-i = shtomë nën dhe; gropë pa fund.
 Gerrl/ë-a = humnerë.
 Gërlluq-i = gropë e vogël.
 Gërbell/ë-a = ngushticë e thellë përroi aty ku dy brigjet afrohen shumë: *e ç'ka don me ba ndër gërbella t'Kapresë?*; shpellë.
 Gërben/ë-a = gërbet/ë-a = greminë në shkëmbinj; hon; kanion.
 Gërbunjë = vile rrushi pa kokra, frenjë.
 Gërç = tokë me çufra (kaçube) e ferra.
 Gërdhajt-i = nyell, nyje në dru a gur.
 Gërdham/i/e/et = plehra, diçka e përzier dhe e papastër.
 Gërdhatë = vend me shkëmbij të thepisur; vend i çveshur, gurishte; vend në bjeshkë në trajtë gropash me gurë e thepa ndërmjet të cilëve ka bar për kullotë; vend me çukarë (gropa me bar).
 Gërdhig/ël-la = arrë e thatë, pa thelb; arrë e fjeshkët.
 Gërdhit = cifloj; + fig. *cen a e metë e dikuj*.
 Gërdhojë = pjesë e pa dobishme e një fruti (diçkaje) që hidhet poshtë (*gërdhojat e pjeprit*).
 Gërfell/ë-a = përrua i thellë.
 Gërf/yell/yelli/ej/ejtë = shpellë e gjatë e me dalje në anën tjetër, tynel.
 Gërgallin/ë/a = copë toke e varfër e me gurë, bokërimë.
 Gërgo/j-va = tërheq një gjë lëndore: *gërgoj litarin*.
 Gërgul/ë-a = gur shumë i madh me strehë; shkëmb me strehë.
 Gërgyell/-i = zbrazëtirë në trajtë shpelle.
 Gërhal/ë/a/at = gur me majë të mprehtë e me sipërfaqe të ashpër; vend me gurë të këtitillë; = që e ka sipërfaqen të pa lëmuar; i ashpër.

Gërhat = shprish, nduk: *më është gërhatur litari në këtë lloj shkëmbi gjëmbaç.*
 Gërmajë = vend i gërmuar si guvë + shumicë, grumbull njerzish.
 Gërvell-et = gërryerje e shkaktuar nga uji a shiu: *e ka gërvellë shiu rrugën.*
 Gërvell/ë-a = gjurmë shiu në tokë; gërryerje nga shiu.
 Gërvoj/ë-a = lëvore druri e hequr me forcë prej tij.
 Gërxi/i = shkëmb i ashpër e me thepa, vend shkëmbor i tillë, thepajë; shkëmbor.
 Gërxyell-i = hell akulli që varet në strehë; stalaktit.
 Gërzhel/i = bar i gjatë që piqet ma shpejt e bie në tokë; bar i keq.
 Gëzhil/e-ja = sharku i gështenjës.
 Gërzhim-i = bar i shkurtër, i dendur e i fortë që rritet bokave me bush e dëllinjë dhe është i djegshëm.
 Gërran/e/a/at = vend i gërryer nga ujërat; gërrellë = përrua i rrëmyeshëm që e gërryen shpejt shtratin e vet; dheu, gurrët etj. që gërryen e merr me vehte një përrua a lumë i tillë.
 Gërrell/ë-a = zgavër e gërryer nga uji zakonisht buzë lumejve; vend i futur e i thellë në një shkëmb; shpellë; humnerë.
 Gërres/ë/a/at = vend i gërryer nga ujërat.
 Gërlam/ë-a = shtëpi, a vend i përmbytur nga ujrat.
 Gërrl/ë/a = gur i gërryer nga uji; gropë e thellë midis shkëmbenjve e gërryer nga uji; humnerë.
 Gësterë = errësirë e madhe; diçka e zezë sterë.
 Gëth/ep/epi/apë/apët = gremç në trungun e një druri a në degët e tij; kthetër; *gëthapët e kështjellës = bedenat e kështjellës.*
 Gëzhollët (i,e) = që është bosh përbrenda; i zgavërt.
 Gic më gic = plot e përplot.
 Gingal/ë-a = sejcili prej dy shkopinjeve të gjatë me një kërrabë afër fundit e ku vihet këmba dhe ecet për sport a për të kaluar një vend me ujë; kamxë.
 Gillam/ë-a = grumbull gurësh të bardhë; kodër me gurë gëlqereje.
 Gillanik/u/ë/ët = gryka e vatrës me gjithë tymtajën; vatër; guri i vatrës ku mbështeten drurët; gur i madh a rrasë guri që përdoret si shkallë, për të mbuluar diçka, etj.
 Gillofkë = zgavër; shpellë; strofkë; gropë.
 Goben/ë-a = pus i thellë në përrua ku mundet të lahemi.
 Gobet/ë-a = gobell/ë-a = gomell/ë-a = gob/ën-na = gropë e thellë në male.
 Gocá/n/ni = gur i madh por i lehtë që ka shumë vrima e që thërmohet shpejt; shkëmb shtufi.
 Gol/ë-a = ngolë = plengë, gjë që ngulet në dërrasë, etj.
 Goll/e/ja/et = vrimë e madhe; gropë (në dru a shkëmb).
 Gom/én/na = gropë në një lumë; pellg me ujë.
 Gomur-i = vend me gur të mëdhej e bar nëpër ta.
 Gomuraj/ë/a= gurishtë në faqen e një mali a më një rripë (shpat shumë i pjerrët në faqen e një mali); shumë i pjerrët.
 Goprrin/ë-a = vend i thyer, i pjerrët thikë.
 Gorajë = zgavër: *lis me gorajë.*
 Gorbush-i = trevë e gjërë e rrethuar me male dhe e përshkruar me lumenj.
 Gorg/ë/a = zgavër, zgërbonjë; shpellë; vend gropë.
 Gorre/ja = gropë e gërryer nga uji; gomën; greminë; humnerë; rrëke e vogël.
 Gorril-i = curril; gurrë, gyp në të cilin del uji i kroit.
 Gorrl/ë-a = birë, vrimë; plasë: *më ka rënë plenga (gola, ngola) në gorrlë.*
 Gorrmiç/ë-a = vorbull, gjir.
 Gos/e/a = hurdhë, vend me lagështirë.
 Gosk/ë-a = shtrat lendesh, gështenjash, arrash.
 Gotull/a = gji deti i vogël, zakonisht i formuar pranë grykës së një lumi.
 Goxhek = pjesë shkëmbore në shpat ose në kreshtë të malit me shkëmbj të vështirë për t'i ngjitur e që të detyron t'i kalosh përqark për të vazhduar ngjitjen drejt majës, kontërforst.

Gozhgorre-t = rrënjë të dala mbi dhë që pengojnë rrugën.
 Grab/ë-a = gropë.
 Grahui = gropë e madhësisë mesatare.
 Granit = shkëmb shumë i fortë.
 Grasim-i = masë në të ngrënë, dietë, pehriz.
 Grat-i = rendiment, dukje: *nuk më ka grat puna/studimi në këtë qytet (në këto kushte)*.
 Grath-i = kokriza a pabarazi që e ashpëronë një sipërfaqe.
 Grathç-e = që ka ashpërsi.
 Grathem = gërvishtem.
 Grath/i/ë/et = diçka e dalë si majë a thep.
 Grell/ë-a = rërë.
 Grellisht/ë-a = ranishtë; zallishtë.
 Greminë = vend i thellë e me anë të thepësura, humnerë, hon, xingonë, rrokullimë, dërmë, theqafje.
 Grend/ë-a = gur i rrumbullakët e sa një grusht, pesh-i, rrosh.
 Grill = gur i butë e petë-petë.
 Grish/ëm-me = i rrëpirtë, i thyer: *kjo pjesë mali është e grishme dhe ka vështirësi për ta kaluar*.
 Grishur (i,e) = ftuar: *më kanë grishur për darkë; të falenderoj për grishën*.
 Grizhtë (i,e) = ngjyrë hiri të hapët, i hirtë; i bardhëmë.
 Groll/e = kthyer si krrabë (*gjemb groll; hundë grolle*).
 Groj/ë-a = zgavër lisi.
 Gropisht/ë/a = vend me gropa = gropore.
 Gropnaj/ë-a = vend a hapsirë me gropa.
 Grumbullak = vend i ngritur, kodër me gurë grumbull një mbi një.
 Gryk-u = erë që fryn nga gryka.
 Grykel/e/ja/et = grykë e vogël mali.
 Gryknaj/ë-a = grykë malesh e gjatë dhe e thellë.
 Gruoll-i = trung i zgavruar që përdoret për qengjë (zgjua) bletësh.
 Gufallë = zgavër, zgërbonjë.
 Guf/ër/ra = grykë vullkani, krater.
 Gulf/ë/a/at = shpërthim i menjëhershëm i ujit, i gjakut, etj.; curril uji; fig. *shpërthim, zemërim, vrer*; si folje bëhet: gulfoj.
 Gufoskë = guvë, shpellë.
 Gulhuq-e = që është si gropë jo e thellë.
 Gulm-i = kujdes i madh; hall, pikëllim; shqetësim.
 Gumë = shkëmb i nënujshëm që del në sipërfaqe të ujit të detit.
 Gumërat/ë/a = grumbull gurësh; lëranë (vend me gurë të rënë nga mali; pjesë zalli a përrua me shumë gurë, etj.).
 Gumo/j-n = derdhet: *ky përrua gumon në Drin*.
 Guracak = që është me gurë; shkëmbor.
 Guranjë = gurishtë, gurinë, gurnajë.
 Guralec = gur i vogël e i lëmuar; gur zalli.
 Gurdar/e-ja = gropë në shtrat përroi e formuar nga njerëzit me gurë natyrorë e në trajtë dare për të mbajtur ujë më gjatë atëherë kur shterr përroi.
 Gurell/e-ja = vend nga buron ujë, prijë përroi.
 Gurës-i = gurë i bardhë e rrumbullak që i vihet pulës në çufrok në vend të vezëve.
 Gurgacë = strall = gurshkrepës = gurzjarr.
 Guriçkë = gur i vogël = guralec.
 Gurim = me shekë, me litarë (shiu): *bie shi gurim*.
 Gurinë = gurishtë; copa gurësh, gurë.
 Gurinor = gurishtor.

Gurishtë = vend a tokë me shumë gurë të vegjël.
 Gurishtar = që ka gurë të vegjël; gurishtë.
 Gurnajë = gurishtë e gjërë.
 Gurshkrepës = strall.
 Gurra-t = gryka a pjesa hyrëse e kamçeve (turqisht çorapeve).
 Gurrec-i = gurrë me ujë të prurë prej diku me anë të një vije, kryesisht për të larë.
 Gurrë = burim i një përroi a lumi, amë; krua, burim.
 Gurrëz = gurrë e vogël me pak ujë.
 Gurrështerpë = gurrë a burim që nuk ka ujë ose që shteron për një kohë të gjatë.
 Gurrni-a = vorbulla.
 Gurron = buron me shumicë; rrjedh si rëke.
 Gushána = qillota.
 Guvë = vrimë e madhe a gropë brënda në shkëmb a në tokë; shpellë; zgërbonjë.
 Guxhuvërë = vrimë e fshehtë.

Gj

Gjalmë = fill i trashë që bëhet zakonisht prej disa fijesh leshi (ose të një loji tjetër) të dredhura ose rrip i hollë lëkure që përdoret për të lidhur diçka, dizgë, ndortë; lidhëse.
 Gjam/i/e/et = tokë me gurë buzë ujit; zallishtë me pak drurë.
 Gjam/ën-na = strehë nën gur, strehë guri.
 Gjanë = lym.
 Gjanisht/ë/a; gjanisht/e/ja = lymishtë = shtresë toke e krijuar nga grumbullimi i lymit të lumejve a përrejt; tokë me lym.
 Gjarpëzi = duke bërë dredha (*ecën gjarpëzi*).
 Gjazë = vend me driza e drurë të dendur në mes të një fushe; shkorret (shkurrajë) në fushë.
 Gje-ni = bishë, egërsirë.
 Gjekëtimë = gjëmim, ushtimë.
 Gjelb/ë-a = lidhëse këpucësh, opingash; tojë me lidh thesin.
 Gjelbërem/ë/i/e = që vjen si i gjelbërt.
 Gjelbëri = gjelbërsi = ngjyra e diçkaje të gjelbërt, të qënëti i gjelbër.
 Gjembishtë = vend i mbuluar me ferra, ferrishtë.
 Gjeq = mugët, turbullt.
 Gjeq/i = mjegull e hollë.
 Gjerator/e/ja = vorbull, shtjellë.
 Gjerbë = pikë uji që bie nga çatia; vendi ku pikon çatia; streha e çatisë (*gjerba shpon gurin*).
 Gjerbon = pikon.
 Gjerdhishtë = shkurre me degë pushtake; gardh me huj e me ferra.
 Gjeshk/u/a/ë = gjethe të thata që kanë rënë nga drurët.
 Gjetkëz/a = vend i rretuar ku mbahen shpendë a kafshë shtëpiake për t'i majmur.
 Gjethatak = që ka shumë gjethe.
 Gjéthet = gjethohet = gjethësohet = mbushet me gjethe.
 Gjethishtë = shtresë gjethesh të rëna në tokë; vend me drurë e shkurre.
 Gjëllime/t = mbeturina të barit të thatë që ngelin aty-këtu nëpër livadh pasi mblidhet bari i korur; kokra të rralla të mbetura në pemë pas vjeljes së frutave.
 Gjëmë = bubullimë; ushtimë.
 Gjërrik-u = erë e ftohtë.
 Gjim-i = gjarpërim, lakim; gji i vogël lumi ose deti; gotull.
 Gjir/e/i/et = vorbull uji, shtjellë.
 Gjirm/ë/a = vend pak i thelluar në vatër ku ndizet zjarri; vatër.

Gjoca-ni = gur i gërryer në shkëmb prej ujrave; currel.
 Gjoç-i = shkëmb, kersh, gërdhatë.
 Gjojc/ë-a = kërraba me llastiqe për të gjuajtur zogi.
 Gjok/u = kalë i bardhë; (*koka gjok e mendja zog*).
 Gjokshár/i = fanellë burrash që vishet në mish.
 Gjol = baltë e madhe; llucë e hollë; liqen; kënetë.
 Gjol-i = bubullimë e thellë që duket se vjen nga brendësia e tokës dhe paralajmëron shumë borë; gjamë bore; murmurimë bore.
 Gjoll/ë-a = kripje, ngrënia e kripës; vend ku hidhet kripa për ta ngrënë bagëtia.
 Gjollishtë = vend plot ujë; gjol i vogël.
 Gjunjak = lloj kallcash prej stofi të leshtë që mbulojnë kërcinjtë nga syri i këmbës deri nën gju.
 Gjurrhum-i = ujvarë në përrenj 2-3 metra e lartë.
 Gjurmashk/ë-a = gjysëm kamçe (turqisht çorape), kamçe pa qafa; shputa.
 Gjurmës/e = njeriu i cili ngjitet në kodra a male, apo shkon fushave nëpër rrugëkalime të njohura apo të panjohura me qëllime njohje apo shlodhje aktive.
 Gjurmësia Shqiptare = shoqatë e hapur për gjurmuesë.
 Gjuro/j-va = mbledh çka ka mbetur pas; gjurat.
 Gjykohej = më shkon keq buka a uji duke më zënë frymën.

H

Haj/e-a = ushqim, ngrënie.
 Hajuk = djalli, qoftëlargu; shakullinë (erë e fortë e që ngre lart pluhur, dëborë, etj); shtjellë, dredhë, vorbull.
 Haliç/i/ë/ët = copë e vogël guri; guriçkë, zhur; haliçët = hedhurinat.
 Haliçer = vend që i përket të gjithë fshatit.
 Halisht/ë/a = pishnajë, vend me pisha.
 Hallkan/i = rreth i trashë hekuri që u vihet në qafë qenve të stanit kur mbahen të lidhur.
 Hallkom/ë/a/at = gropë e thellë e mbushur me baltë.
 Hamull-a = shtjellë, vorbull lumi.
 Hamull/i = zjarr i madh, flakadan.
 Hamull/on = digjet mirë, merr flakë.
 Hápas = ngadalë e me hapa të mëdhenj.
 Hapë/ja/të = hapësirë, vend i hapur; fig. *mbushulli, begati*.
 Harc/i/a/at = shkëmb a gur i madh me thepa; vend me shkëmbje a gurë të tillë.
 Harmóhet = (guri) coptohet, thërmohet, shkërmoqet.
 Hartosë = pullazinë = kulm a shtresë dërrasash ku shtrohen tjegullat.
 Harrik-u-ët = gurë të vegjël që dalin nga pastrimi i arave e që vendosen ndërmjet gurëve të mëdhenj të mureve rrethues të arës.
 Hatull = + qafore hekuri me thumba që u vihet qenve në qafë për të mos i ngrënë ujku.
 He-ja-të = haje, ngrënie, të ngrënë.
 Hedh/ë = flok bore.
 Hejz/ë/a/at = kurriz mali a kodre që ndan rrjedhën e ujrave; thepa të mprehtë majë maleve; akull i varur në strehë.
 Helik-u = hendek natyror në male, i thellë e i vështirë që të kalohet.
 Hep/e/a/at = plasë më mes të diçkaje; gropë pak e thellë; zgavër e madhe, shpellë; thep me majë të hollë, diçka e zgjatur e me majë; plasë, e çarë ujrash në shkëmb.
 Heqam/e-ja = dallgë e madhe; stuhi me erë të fuqishme që rrëzon pemë.
 Herë-a = kohë, mot.
 Hes/ë-a = hezë = dimnishtë, pekulate, ushqime (turqisht zahire).

Hijëç-e = hijedashës-e.
 Hijesirë = vend i ftohtë që nuk e zë dielli, vend me hije.
 Hijëz = ombrellë.
 Hij/oj/ova/uar = e djeg, e bëj hi diçka.
 Hipí /a = mullar, stivë.
 Hjeks/ë-a = vegëz litari.
 Hjimas = teposhtë: *kërceu hjimas*.
 Hol/e/ja = shtrat i vogël që tundet e që varet në dy trarë.
 Holol-i = maja ma e lartë e shkëmbit, pemës, etj.
 Holla/t/të = shkarpa shumë të holla.
 Hollsin/ë-a = shtresë e hollë bore, pluskë.
 Hon/i/e/et = gropë e thellë me anë të thepisura, greminë, humnerë; e çarë e thellë në një shkëmb.
 Hopangop = duke hedhur të lodhur herë njëren këmbë e herë tjetren (*ecin hopangop në dëborën e thellë*).
 Hordop/i/ë/ët = gropë e madhe në male që mbushet me borë.
 Horë/a = qëndër banimi, qytet a fshat.
 Horë = + zjarr, flakë (mori horë kasollja); si zjarr, si flakë (edhe fig).
 Hormo/j-va = gërryej, gërdhatoj.
 Hormoç-i = vend i gërryer prej përroit, hurdhë.
 Hosí/a = erë e fortë e mirë ose e keqe e diçkaje.
 Hrrina-t = mal i ulët me ah, shkozë a lajthi.
 Hudic/ë-a = shpellë; hepe.
 Hudiz/ë-a = rudinë, vend pa lisa.
 Hukam/ë/a/at = frymë e ngrohtë që del kur hukatim (nxjerr frymë të ngrohtë); frymëmarje e thellë; zhurma që dëgjohet kur hukatim ose kur marrim frymë thellë.
 Hulli-a = vija që hap plori në arë, brazdë.
 Hum-i = ujët e detit i fryrë prej erës.
 Humbak/u = vend i butë e me llucë; kënetë a moçal që të thëthin.
 Humbellë/a = gropë e madhe dhe e thellë që bëhet kur fundoset toka; shembëtirë.
 Humbishtë/a/at = vendi ku humbet një rrjedhë uji në tokë; vend shumë i pjerrët, hon..
 Humnerë = gropë e thellë me anë të thepisura, hon, greminë.
 Hunc-i = urë zjarri.
 Húpet = ngjishet, rraset (buka, etj.).
 Hup/ë-a = vend që fundoset vazhdimisht.
 Hupët (i,e) = i ndíshëm, i ndíçëm, i ndenjor, bajat (buka); i ngjeshur e i fortë, i ngurtë, i ngrirë (*borë e hupët*).
 Hurdh-i = bar që mbështillet rreth pemëve.
 Hurdhiq = i lagur e i bërë qull.
 Hurdhë = pellg i vogël me ujë të ndenjor; vend i thellë në rrjedhën e qetë të një lumi.
 Hurdhiq/i = hurdhë me shumë ujë.
 Hyrë = + gropë a e thelluar e vogël.

I

Ill/ë-a = lymi i mbetur në livadhe pas vërshimit të lumit a përroit.
 Imanent/e = që e përmban vetë sendi a dukuria; që është në vetë natyrën e sendit a dukurisë.
 Imshtaj/ë-a = tërësi imshtash, imtajë; copa degësh që mbeten pasi priten e ngarkohen drutë.
 Imt/ë/a = kohë shumë e shkurtër; çast, minutë; sekondë.
 Imti-a = zgjuarsi e hollë.
 Imtin/ë-a = pyll i imët; shpeshtinë.

Imt/oj/on/uar = bie shi i hollë ose dëborë e imët.
 Ipsht/ë-a = lisni ahash të rinj; imshhtë.
 Ipshtak-u = lis i ri, fillak.
 Iri-a = kullotë a vend i askujt, djerinë.
 Irnohem/irnosem = + nxihem në fytyrë nga të ftohtët.
 Ith/i = + ana a pjesa pas diçkaje.

J

Jaz/i/e/et = vijë që shpie ujin në mulli, arë, etj.; rrjedhë uji; vend a gropë e madhe ku grumbullohet ujë për vaditje.
 Jes/ë-a = egzistencë.
 Jezull-i = shtresë hiri që vesh gacat; puhol.
 Josht/ër/ra = erë e ngrohtë dhe e fortë që fryn nga deti dhe dëmton bujqësinë.
 Jugë = erë e ngrohtë që fryn nga jugu e që si rregull sjell shi.

K

Kacafik = kacolle e thjeshtë dhe e vogël e ngritur mbi katër hunj; kacolle e tillë ku fle bariu skaj deleve.
 Kacavarem = i ngjitem diçkaje duke përdorur duart e këmbët.
 Kacep-i = shkëmb që nisët i gjërë e vjen duke u mbledhur; majë shkëmbi, thep, shkrep.
 Kacit-i = më ngec në fyt një ushqim (*më kaciti ftoi*).
 Kacurret-i = shtatore gurësh që i ngenë barinjët në kullota; majë mali në trajtë konike.
 Kaçimb/ë-a = kreshtë.
 Kaçorr/e/ja = tendë e bërë me degë për tu mbrojtur nga dielli.
 Kajlë = push (i plepit).
 Kajnik-u = burim uji; skurrjel.
 Kajtj/e-a = interes: *ti po cënon kajtjet e ekipit tonë*.
 Kaladredhan-i = shkop i shtrembër e me nej.
 Kalarohem = kacavarem.
 Kalavarem = zbres poshtë me këmbë e me duar.
 Kalehtë = shumë lehtë, pa bërë zhurmë (*po ecja kalehtë*).
 Kalesë = vendi ku kalohet diçka.
 Kálfët (i,e) = që është pak i turbullt; që ka ngjyrën e ujit të ndenjtur.
 Kalikaxh/ë-a = mjegull e hollë; mjegullinë.
 Kalisher = varg hurdhash ose qepësh.
 Kalivar/e/ja = + diçka që rrjedh e derdhet; vijë që lë në një sipërfaqe diçka që rrjedh (*kalivare uji = ujvarë; kalivare djerse mbi fytyrë*).
 Kalmuq = grumbull plehrash bashkë me dhë; pleh gjethesh të kalbura.
 Kalojë = urë e varur për të kaluar një lumë, përrua, etj., (pasarel).
 Kalore = thupër për të goditur kafshët; purtekë e hollë.
 Kaltrin/ë-a = hapsirë e kaltër.
 Kalthi = me këmbë e duar (*ecën kalthi*).
 Kallagjuric/ë-a = sejcila prej dy veshëzave të bëroreit.
 Kallisht/ë-a = arë misri e korur.
 Kallm/i/a/at = rip toke që mbillet zakonisht me perime.
 Kamare = hapsirë e vogël si dritare në mur.
 Kambëtar = ecës.
 Kamnar = pasunik.

Kamot = shumë mote të shkuara.
 Kamotshëm = shumë i hershëm.
 Kampor = që lidhet me kampin, me fushimin.
 Kándet = kënaqet.
 Kandrit = zbukuroj, hijeshoj, rregulloj.
 Kanik/e/ja/et = kasolle e vogël që bëjnë barinjte në stan, apo rojtarët në vreshta.
 Kanoçe/ja = kasolle e vogël.
 Kanxhel-i = pjesa kërce e arrës që e ndan thelbin e saj, kllapin/ë-a, katrash, gozhitël, shalor; pjesa që mbetet në trung kur i pritet një degë.
 Kanjush/ë/a = lejlek.
 Kapcer/e-ja = kapërcyell, kapërcyes; shteg i mbyllur me një trinë ku mundet të kalohet duke kapërcyer.
 Kapçal-i = dru ku mund të varret diçka.
 Kapel/ë-a = tubë resh majë një mali.
 Kapër-ra = gaxhel = mbajtëse hardhish.
 Kapërce/lili/jtë = kapcere = shteg kalimi ose shkallë e thjeshtë me bigë të madhe mbi gardhin e një kopshti për të kaluar matanë; vendkalim i ngushtë në pyll a në mal = kapërcyes/i/it.
 Kapërçer-i = sejcili nga gurët e venë në një cektinë lumi/përroi për ta kaluar duke shkelur mbi ta.
 Kapërderdhës = shkarkues i ujit të tepërt në një digë a sfrac (pendë).
 Kapërthur/em-a = kryqëztoj, përdredh, ngatëroj, litarët, rripat, punët, etj.
 Kapran = i ngrirë: *duke ndenjtur jashtë në atë thëllimë u bëra kapran*.
 Kaprroz-i = borë e ngrirë që mbetet e kapur në degë; valë lumi e ngrirë.
 Kapt = prarom (turqisht hendek).
 Kapt/ë/a/at = qafë kodre a mali; anë tjetë e një mali a kodre.
 Kapth/i/e/et = shteg i ngushtë mali; kaptë.
 Kapuçprehtë = malësor prej Nikaj-Mërturi ose Dukagjini (*krahasuar me malsinë e Gjakovës, kapuçët e tyre të bardhë janë pak më të prehtë, pra jo krejt të rrumbullakët*).
 Kapullan/ë-a = zjarr i madh që ndizet në bjeshkë natën e zhdjegrave (*nata e fundit e qëndrimit në bjeshkë për atë vit. Fëmijët nisin të mbledhin degë një muaj ma parë duke i grumbulluar e bërë kapule. Synohet me pasë zjarrin ma të madh*); zjarr me flakë të madhe.
 Kaqot/ë-a = bardhak i vogël me qep (lëfyt) që përdoret me u dhanë qumësht a ujë fëmijve.
 Kárga = hiq, tërhiq, jepi forca!; plot e përplot, mbushur me majë.
 Kárm/ë/a/at = shkëmb i madh që ngrihet thikë në breg të një lumi a të detit; vend i thepisur a i çveshur; rrëpirë; kopicë sendesh (*karmë drushë*).
 Karmatisur = i rrethuar me shkëmbinj, shkëmbor.
 Karp/ë/a/at = shkrep, shkëmb.
 Karsh = kërsh = shpat shkëmbor; vend i mbuluar me shkëmbej e gurë.
 Karthje = shkarpë.
 Karraduc = gur i gjatë.
 Karratiq-i = zgavër.
 Kashtar-i-e = ai/ajo që shkon nga fryn era.
 Kashtor/e/ja/e/et = kasolle kashte; plevicë ku mbahet kashta; mullar kashte; botile e veshur me kashtë; kapele, karrige, etj., prej kashte.
 Káshtull = Kashta e Kumtrit = Rruga e Qumshtit.
 Katarakt = ujvarë.
 Katalloj = bëj një sy gjumë.
 Kataratë = arë a copë are katërkëndëshe.
 Katmin/ë-a = truall i tatës ose i trashëguar prej tatës.
 Kathep-i = thep i vogël; send i ngritur, me majë.
 Kelcar = i kalbët, i shkatëruar, gati në të rënë.
 Keloj/ë-a = tokë në dukje humusore, por ligatinë, me kallamishte e pak prodhimtare.

Kep = shkëmb i madh me majë ose me disa maja të mprehta; maja e një guri ose e një mali shkëmbor; thep, cep; breg shkëmbor që zgjatet në det (Kepi i Gjuhës), i kepët = i thepisur.
 Kepeç-i = sqep.
 Kepët (i,e) = i thepisur, me kepa. (*vend i kepët*).
 Keqin-i = kullotë e keqe, me ferra.
 Kersh-i = shkëmb.
 Kerrm/ë/a = ferrishtë.
 Kernnishta-t = tërësia e barërave që dalin nëpër megja e stomie.
 Këlyz-i = pip jo prodhues i hardhisë.
 Këlshed/ër/ra/at = llastar hardhije; fije e hollë që lëshon dega e hardhisë.
 Këllad/ë-a = këllaçë = rudinë në mal me fier e lagështi.
 Këll/ehet/ye (u)/yer = turbullohet (edhe në kuptimin fig.): *u këllye uji*.
 Këlliç = për së gjati, duke u mbështetur në faqen më të ngushtë (i vendos tullat këlliç).
 Këmbadoraz = me këmbë e duar në tokë.
 Këmbas = më këmbë (*e bëri udhën këmbas*).
 Këmbëcës/i = trotuar.
 Këmbëdele/ja = rradiqe = çikore.
 Këmbës = këmbësor.
 Këmbëse = shkallare e vogël për tu ngritur më lart kur lyejmë, vjelim a kërkojmë gjë.
 Këmbësor/e-ja = trotuar.
 Këmbëz = + shkallare.
 Këmbëzvarrë = duke i hequr këmbët zvarrë.
 Këmend/ë-a = lesh dhish.
 Këmetë-t = tëmëtu; djal a fëmijë tetë vjeç e poshtë.
 Këndájsí-a = andë, kënaqësi, argëtim
 Këndájt/ë-a = andë, këndajsi.
 Këndéllës-e = që këndell, që gjallëron; që të rilind.
 Këndit/em/a (u)/ur = shuaj urinë ose etjen, ngopem.
 Kënetë = moçal, kënetishtë, ligatinë, vurg.
 Kënetisht/ë/a/at = vend me pellgje uji e baltë; kënetë, moçal.
 Kërlik-u = kërrabë druri që përdoret me i zanë dhentë duke i kapur për këmbë.
 Kërlin/ë-a = gurinë; pa bimësi.
 Kërmit = djeg duke e lënë më shumë nga sa duhet në zjarr.
 Kërñall/e-ja = bokërrimë, rrëpirë.
 Kërsellic/ë-a = tokë e pllëshme.
 Kërsh = karsh = shpat shkëmbor; vend i mbuluar me shkëmbej e gurë.
 Kërshin/ë-a = shpat me gurë, bar, shkurre e lisa të rrallë, i mirë për kullosë dhishë.
 Kërthazi = ndajf. brinjazi; këlliç; shkarazi, rëshqanthi; tërthorazi.
 Kërthët (i,e) = që shkon tërthorazi; i tërthortë.
 Kërr = i zhveshur, pa drurë e pa bimësi. (*vend kërr*).
 Kërreç-i = ai që i kanë rënë krejt dhëmbët; shkërrban.
 Kërrl/ë/a = llucë e hollë, llum moçal.
 Kërrngall/ë-a = i ftohtë i madh e i thatë; cegëm.
 Kiemas = cangël, kithazi, diagonal.
 Kik/ë/a = maja e mprehtë e një mali a kodre; lafshë gjeli.
 Kik/ërr-rra = majë e një vendi krejt e çveshur.
 Kikël-a = pjatë e vogël me të cilën gostitet miku tek i jepet një lugë mjaltë a reçel.
 Kiligruc-i = cilado prej kërrabave që vihet në anë të bërores kur ngarkojmë një kafshë.
 King/ë-a = kupërr-a = maja e kokës.
 Kip-i = sup, krah (në): *kacavarësi ju ngjit kip shokut të tij dhe arriti të kapet ma sipër*.
 Kitë = hell akulli.

Kiti-a = shtresë si brymë; streç.
 Kitit = (me) krasit: *me kitit hardhinë*.
 Kitrohem = kitritthem = ngjitem duke u kapur me thonj.
 Kith/i = mjegull e hollë që vesh majat e maleve në verë ose që bie poshtë në vendet e ulta kur do të ndërojnë moti = cikth (cik ka kuptim edhe hirrë kosi a djathi).
 Kithi = tërthorazi, brinjazi.
 Kithët (i, e) = i pjerrët; i tërthortë (në hapsirë e jo në plan).
 Kithi = ndajf., tërthorazi, anash, brinjazi.
 Knjan/ë-a = sqepar i lugët me gërrye bucela, etj.
 Klekë = lloj pishe që rritet si shkurre në vendet a larta molore, me degë të shtrira përtokë.
 Kllaç/ë/a = gropë e vogël me baltë e ujë që krijohet pas shiut a pas shkrirjes së borës.
 Kallag/ër/ra = plis are; rrasë akulli; thumba akulli që çohen në tokë.
 Kllapanisht/ë-a = mal a pyll me dru të kalakryquar ku mesi kalohet.
 Kllap/ë-a = gjum i shkurtër që të ze ndenjtur.
 Kllaçin/ë-a = vend i lagësht, ligatinë.
 Knaj/ë-a = ndotje, ndragje.
 Knap = as gjërë e as ngushtë, por sipas trupit, a këmbës, etj.: *më erdhi këmisha knap*.
 Kocak/u = + tokëz rripi ose sandaleje; gërshet zbukurues.
 Kocomil = mulli i vogël fshati; mulli që punon me ujët e përroit në dimër; mulli në vend të frikshëm.
 Koçek-u = gur, thep, shkrep.
 Koçkun-i = kërçep, ferrë e trashë, copë e thatë dege.
 Kodërdhe = kodër me dhé, varr.
 Kodërsin/ë-a = vend i ngritur; kodër e vogël.
 Kodraç-i = vend i ngritur, kodër.
 Kodrapulë = kodër e vogël.
 Kodrinar = banor që jeton në kodër.
 Kodrishtë = kodërsinë = kodër me bar.
 Kodrinë = kodrishtë = kodër e vogël.
 Kof/ën-na = lug i thurur me thupra për të zënë peshk.
 Kojk/ë/a = majë e zhveshur e një kodre.
 Kojs/i/a = fik rrekë.
 Kokërdhak-u = gur i rrumbullakuar prej ujrave rrjedhëse.
 Kokojk/ë/a = majë mali a kodre; kodër e vogël; grumbull plehu.
 Kokolepsje = ngatërrim.
 Kolibe/ja = kasolle e vogël dhe e keqe; kasolle qeni.
 Kolir-i = shirit ose lëmsh dredhësh.
 Kom-i = kresht/ë-a.
 Koprik = zallishtë.
 Kopurat/em-a-u = ngrohëm gjatë e më nge pranë zjarrit.
 Koras-i = mocanik = bashkëmoshatar.
 Kori-a = vendi ku rrinë qingjat e ndarë nga dhentë.
 Korije = pyll i vogël me dushk a drurë të tjerë jo të lartë.
 Korth/ë-a = litar a dru ku vihen teshat për tu tharë.
 Korub/e/ja/e/et = zgavër në dru a në shkëmb.
 Kotar = vathë; kotec.
 Krac/ë-a = krahëza, krahoshe, tirandë, krahçë.
 Krahisht = përbri.
 Krahishtoj = mbarësoj = rregulloj gjënë a shtëpinë a dhomën në fund të ditës.
 Krahnez/ë/a = dëborë e ngrirë që ngjit mbi degët e drurëve; shtresë bryme e ngrirë, shtrezë; mot i ftohtë, acar.

Krahoh = jelek; pulovër.
 Kramshin/ë/a = vend me lagështirë ku kalben drutë e bëhen pleh.
 Krastë = kodër me shtresa rrasash; gurishtë.
 Kre-ja = cipa që vënë ushqime të lëngëta: *kreja e kosit asht e shijshme*.
 Kreisht/ë-a = maja.
 Krejc/ë-a = cënuq, nënkrejsë nënkresë, përkresë, kulter, cumër, pericë (turqisht jastik).
 Krenaj/ë/a = maja më e lartë e një kodre a mali; ana e sipërme; kreu; etj.
 Krençk/ë-a = degë e thatë; krande.
 Krenesht/ër-ra = degë e njomë që merret nga një pemë frutore e ngulet krye arës që sapo është mbjellë me urim si: *për shumë krenë të fortë si eshtën*.
 Krep/i/a/at = shkrep; shkëmb akulli.
 Kreshpët(i) = i kreshtë.
 Kreshkët (i, e) = që përbëhet nga disa shtresa si petë (shkëmbej/gurë të kreshkët).
 Kresht/i = pishë e zezë.
 Kreshtak/e = që ka trajtën e një kreshte.
 Kresht/ë/a = kurriz i mprehtë ose dhëmbë-dhëmbë i një mali a kodre; maja më e lartë dhe e thepisur e tyre.
 Krëndisht/ë-a = krëndullí-a = vend me drurë e shkurre të thata.
 Kridh/ë = baltë e madhe ku mundet të fundosesh.
 Krihcaz = mënyrë ngarkimi e një barre me dy rripa ose litarë që futen nën krahë si rripat e rancs së shpinës.
 Krihc/ë-a = lak, rrip i barrës së shpinës.
 Krik-u = erë jugu, shiu.
 Kripç = bar i fortë në bjeshkë.
 Krojç/e-a = krue i vogël.
 Krongji/ll/li = hell akulli.
 Kroq-e = që lakohet fort (thupër).
 Krua = kroi, burim, gurrë, ujmore, çikër, burim.
 Kryekis/ë-a = litar që u lidhet lopëve e qeve rreth brirëve.
 Kryelumë = pjesa e lumit sa ma afër burimit.
 Kryemot = Dita e Vitit të Ri = kryevit.
 Kryq/e-ja = shami koke trekëndore.
 Kryqe-t = kërbisht-et
 Krrin/ë-a = tokë shumë e varfër.
 Krrrojz/e-a = tokë e gryer prej shirash, e papunueshme.
 Kthap-i = vend ose shkëmb i thepisur, i vështirë për tu kaluar.
 Kthëllë (i,e) = (vend) i thellë.
 Kthellojë = vend i thellë nën dhe.
 Kucthi = (ecje) me hapa të vegjël e duke çaluar.
 Kufijar = ai që e ka tokën në kufi me dikë.
 Kufk/ë/a = guaska e kërmillit; fig., *i zbrazët, bosh*.
 Kul/e/ja = grumbull sendesh që janë vendosur një mbi një e pa rregull; ferrishtë e madhe, blacë (pyll i ulët a vend me shkurre).
 Kulin/ë-a = grykë mali; greminë.
 Kultere/t = hullitë e gëryera në një gur a shkëmb nga veprimi i ujrave.
 Kukupare-ja = varg me gështenja të zjera që mbahen rreth qafës a krahqafë.
 Kullot/ë-a = kullos/ë-a, mballesë, nome.
 Kullumbit = lëshoj një gjë në ujë ose në baltë; zhyt.
 Kullusm/ë-a = vend me bimë të dendura, dëndësirë, blacë.
 Kundraj/ë-a = vend përkundraill.
 Kung/ë-a = cep, qoshe, kënd, skaj.

Kungullar/i/ë/ët = kodër e rrumbullakët a pjesë mali e tillë.
 Kungj-i = pykël, pykë e vogël.
 Kunj-i = copë druri a metali që e ngulim diku (a del prej diku) për një qëllim të caktuar, pleng-u.
 Kuqar/i = vend me tokë të kuqe.
 Kuqëlin/ë/a = tokë deltinore me ngjyrë si të kuqe, kuqishtë, shiosë.
 Kuqishtë = tokë e kuqe.
 Kúri = përmbajtja në të ngrënë a pije, në shpenzime, veprime, etj.
 Kurít = thaj, ter pranë zjarrit.
 Kurupoqk/ë-a = tokë si pllajë, e çveshur e pa bimësi.
 Kurrm/ë-a = govatë, koritë guri.
 Kurrné-ni = rrymë ujore aty ku është e shpejtë dhe e shkumëzuar.
 Kyl = rrafsh.

L

Labërda-ni = vend i çlirët, hapësirë e lirëshme.
 Lac/e/a/at = larë e vogël në trupin e kafshës; rrip a copë e vogël litari e prerë për diçka (*lacë litari*); copë e vogël toke e pa punuar (*laca djerrinash*).
 Laç/i/e/et = vend që përmytet nga ujrata; vend me lagështirë, kënetishtë.
 Lagatërë = mot që është herë me shi e herë me diell; tokë që vende-vende është me lagështirë.
 Lagcin/ë-a = shi i imtë e i prajtë (jo i rrëmbyer).
 Lagtërsh/ëm-me = (i/e) paqëndrueshëm (moti), herë me shi e herë me diell.
 Lag/ë/a/at = pikë e vogël uji, pikë shiu; një pikë; sasi fare e vogël e një lëngu.
 Lagësirë/a = lagështirë; vend me lagështi, tokë e lagur.
 Lagësohem = lagem pak me ujë.
 Lagsht/ë-a = ves/ë-a, ag-u, vrug-u.
 Lagshtë = tokë me lagështirë; vend i lagët.
 Lagsin/ë-a = tokë që mban ujë.
 Lagsht/ë/a = vesë (*ka rënë lagshtë; e ka zënë lagshta*); fillimi i agimit, agu (*në lagshtë të ditës*).
 Lagshtik = (vend) moçalor.
 Lagush/i = shtresë gjethesh të lagura e të kalbura.
 Lagj/e-ja = sejcili prej litarëve të bërrores (bërrorit).
 Lakadredhas = me leqe e me dredha duke kaluar herë në njërën e herë në tjetrën anë, dredha dredha (*eci, iki, vrapoj lakadredhas*).
 Lakaluk-e = që ka shumë leqe, kthesa.
 Lakes/ë-a = kthesë rruge.
 Lakanisem = vetveprore, fig., *që mundohem shumë (u lakanisëm maleve)*; më bëhet lëkura copë-copë; shqyhem, coptohem.
 Lakatet = priset e grisat nga përdorimi i gjatë e i keq: *lakatet litari, ranci, këpuca, etj.*
 Lakavar/a/ur = e kthej a e përkul diçka si lak; varet.
 Lakavarem = varem, përkulem a lakohe; fig., *e lëshoj vehten krejt, më pritët fuqia*.
 Lakin/ë/a/at = lak mali a kodre, qafë; udhë gjarpëruese në një faqe mali; kthesë lumi, bërryl.
 Lakor/e-ja = që është si lak; i lakuar, e tërthor/e-ja.
 Lamth-i = log me bar.
 Lamtezónë = lamtumirë = tymirméc.
 Lapé/ja/të = vath dhie; rezhdë (gardh).
 Lapur-a = vend, shpat i zhveshur.
 Lar-i = dafin/ë-a (larishtë = dafinore).
 Laracohet = bëhet lara-lara; përshénjet.
 Laragan/e = i larmë, laraman.

Lar/ë/a = + vend i zhveshur në një shpat mali.
 Larginë/a/at = vend i largët. (*Vuthaj është një larginë për Thethjanët*).
 Larí-a = grumbull gurësh; pjesë toke e lëruar.
 Laric/ë-a = tokë që nuk ngopet me ujë.
 Larít = me shkri vende vende: *era e ka laritë tokën*.
 Lárm/ë/i/e = që është me lara-lara; që është herë i kthjellët e herë i mvrejtur (moti); i larmishëm.
 Lartas/i/ít = banor i krahinave të larta malore.
 Lartësir/ë/a/at = vend i lartë me shtrirje të gjerë; kodër a mal.
 Larushí/të = larmi.
 Laskar/e/ja/e/et = + pjesë e shembur e një kodre a mali; lasakrohet kodra (mali) = shembet një pjesë kodre a mali.
 Lashk/ë/a = ashkël e vogël (ashkla e lashka = ashkla e ashkla).
 Lat/ë/a = sopatë e vogël me teh të gjerë, cakorre; sopatë e madhe me qafë të gjatë; ana me teh e një sopate a kazme, etj.
 Lavar/e-ja = litar a një fill me lak në njerën anë që përdoret për të varur, për të lidhur a për të shtrënguar diçka.
 Lavashk/ë-a = varg misrash si kurorë; vëshallkë.
 Lavestër-a = copëz lëkure rreth plagës, thoit; (*një paragjykim: mos i prit thonjt në ditët që ngjiten buzët (e martë, e mërkurë, e premte) se të bahen lëvestra*).
 Lavërdan/i = vend i hapur; hapësirë e madhe.
 Lazhd/ë-a = lagshtë, vesë.
 Lebade-ja = krande e imët, e hollë; rrëfatë.
 Ledh/i/e/et = vend i ngritur buzë arave ose anës udhëve, hendeqeve, etj., trap; pendë dheu për të penguar ujrat, sfrac; etj.
 Ledh/i/e/et = lym, baltë; ledhishte, lymërishtë.
 Ledhisht/ë/a = vend me tokë me ledhe e me brezare; tokë a arë e mbuluar me lym nga vërshimi i ujrave; lymore, lymërishtë; baltak.
 Ledhoj = mbush me lym: *lumi ledhoi arat*.
 Ledhore/ja = vend i pashkruar në anë të faqes së një fletoreje, të një libri, etj.
 Leg/ë/a = dredhë e fortë ere (*frynte lega, shtjella, vorbulla*), ciklon.
 Lehtin/ë/a/at = ecje në këmbë për t'u çlodhur, shëtitje, (u kthye nga lehtina).
 Lekë/t = Malësorët e Mbishkodrës.
 Lekur (i,e) = i lodhur deri në marrje këmbësh.
 Leng/ë-a = litar për të varur robot.
 Lení/a/të = brez njerzish; gjindje; popull; komb; vend; trevë; krahinë (*leni me male të lartë*).
 Leq/e-ja = bërryl rruge; dredhë rruge, kthesë e fortë.
 Leqoj = dredhoj, shmang.
 Leq/oj/ova/uar = jokal, eci a vrapoj duke bërë dredha, gjarpëroj.
 Leran/ë/a = vend me gurë të rënë nga mali; pjesë zalli a përrua me shumë gurë; grumbull gurësh të sjellë nga ujërat ose të mbetura nga një ndërtim, rënojë, gërmadhë.
 Ler/ë/a = baltë e hollë; llucë; moçalishtë; pellg me ujë ku shkrin dëbora në vendet malore; gropë e madhe me ujë ku pinë ujë bagëtia në kohën e thatësisë.
 Lesjan-i = shi i imët që bie në mesditë e prish pemët, hardhitë, etj.
 Lesk/ër/ra = cipë a petë e hollë që shqitet nga sipërfaqja e diçkaje të fortë.
 Leshez-a = thupërz e pështjellë me penj leshi që shërben për të pastruar fyellin nga brënda.
 Leth-i = lym që le vërshimi i lumit.
 Levarash = që dridhet me shpejtësi; që fërgëllon.
 Lezare-ja = shënjë, shkop që ndan kufirin midis dy kullotave.
 Lëbardhet = zbardhëllon, lëbardh (lëbardhet dita).
 Lëbardh/ë/a = agu i ditës, agimi (u ngrit me lëbardhë; u ngrit para lëbardhës).
 Lëboz/ë-a = lëpen, horizont, mballim syri = hapësirë që zë syri.

Lëbyrem = + më vriten sytë nga drita; më erren sytë; verbohëm.
 Lëbyr-i = brezabel = ngjyrosh (turqisht ylber).
 Lëkërsh-i = bricë, gurgac, strall.
 Lëkor/e-ja = radhiqe.
 Lëkostër-a = lëvore-ja, koreja.
 Lëkuq/a/ur = e bëj të kuqëremë (*dielli lëkuqi majat e maleve; po lëkuq agimi*).
 Lëkuqe/ja/e/et = tokë në ngjyrë të kuqe.
 Lëmak-u = lëmsht fijesh.
 Lëmuq-i = top bore; shuk; grumbull i vogël i diçkaje.
 Lëmbar = vë për udhë.
 Lëmak/u/ë/ët = lëmsht fijesh.
 Lëmashk = myk
 Lëmaz/ë/a = cipë e hollë e diçkaje.
 Lëmbar/em/a = më bëhet mbarë për të nisur diçka; përgatitem mirë për të filluar diçka (*u lëmbara për udhë/sulmin drejt majës*).
 Lëmek/a/ur = + fig., e dobësoj a e lodh shumë dikë; i a pres fuqitë; e kapis; e mek; e vdes. (*e lëmekën ngjitjet e zbritet, temperatura, sëmundja*).
 Lëmes/ë/a = vend i lagësht me baltë ose borë ku rrëshqasin këmbët; rrëshqitë; shkazmë.
 Lëmoç/ë-a = akull mbuluar me një shtresë të hollë bore ku dhe rëshqet lehtë.
 Lëmuq/i = top bore; shuk; grumbull i vogël i diçkaje.
 Lëndisht/ë/a = pyll i mirë me dru për lëndë ndërtimi.
 Lëngësir/ë/a = lëngu i pemëve a bimëve të njoma, ujthi i drurëve; pije a diçka tjetër e lëngët, gjë e lëngëshme.
 Lëngíe = që ka shumë lëng, i lëngëshëm (*dardhë lëngie*).
 Lëngjer/ë/a = + vend me baltë e ujë të ndenjtur, batak.
 Lënurem = bëhem copë-copë, grisem keq; gërvishem shumë; fig., *vuaj e mundohem shumë, çfilitem*.
 Lëpa-ni = qetësi, gjendje e qetë; lëpá = në qetësi: *ra deti në lëpá*.
 Lëpen-i = horizonti.
 Lëpë/ja = mjegull e hollë, tis mjegulle (*ka rënë lëpe nëpër male*).
 Lëpirë = që është pa bimësi, pa gurë, etj.; (*kodër, pllajë, rripë e lëpirë*).
 Lëpith-i = vija ku duket se bashkohet qielli me tokën.
 Lëpizë/a = e dalë e shështë shumë e ngushtë (*shijakë* kur kjo është më e gjërë dhe *shtreth* kur në të vendoset këmba lirshëm)
 Lëqeth-i = liqen i vogël; lëket.
 Lëshe-ja = vrrulli.
 Lëtyr/ë/a = baltë e squllët, llurbëtirë.
 Lëvar/e/ja = ujëvarë; rrëke mali (*lëvarja e Thethit*); shpat mali a faqe shkëmbi e pjerrët si thikë; rrëshqitë; rrugë shumë e pjerrët në një faqe mali; gjurmë (*e ndoqi/e gjeti pas lëvarjes*).
 Lëvarem = varem pak; varem; kacavarem; fig., *lodhem e mundohem shumë në një punë, raskapitem, këputem*.
 Lëvarës/i = rrip i vogël e i hollë, i qepur në të dy anët si lak tek një send për ta varur diku (*tek palltoja vetëm një për t'a varur, tek pantallonat, disa për të shkuar rripin, etj.*); shtjekë.
 Lëvarrem = plagosem lehtë; çirrem; gërvishtem.
 Lëverd, lëverdhem = mer nga pak ngjyrë të verdhë.
 Lëvir/ë-a = rrëke-ja.
 Lidhak/e = i fortë (*frashër lidhak; njeri lidhak*).
 Lidh/ë-a = litar i vogël, i shkurtër.
 Lidhëse = gjalmë për të lidhur, liktyrë.
 Lidhm/ë/a = nyj/ë/a.
 Lidhuna-t = karnavale.

Ligaç/e = i dobët nga trupi; shëndetlig; fig., *shpirtkeq, zemërlig*.
 Ligat/ë/a = ligatinë = vend me bar që mban gjithnjë ujë, moçalishtë, bllacë, burishtë, ujnajë.
 Ligat/em-a = lagem e bëhem qullë.
 Ligcin/ë-a = rigë shiu; ligcon/j = rigon/j.
 Ligr/on/oi/uar = bie shi i imët.
 Lik/u = sipërfaqe e rrafshhtë; rrafsh (*liku i dheut, tokës*); *i shkoi për lik = e preku paksa*; e preu barin lik (rrafsh) me tokën; + drejt, sipër: *ju ngjit malit lik përpjetë*.
 Liktyr/ë-a = lidhëse; lagëtyrë (kashtë e lagur dhe e dredhur që përdoret për të lidhur të korat në duaj); dy a tre thupra të njoma e të përdredhura që përdoren për të lidhur diçka.
 Lilë = lloj lidhje që zgjidhet me një të tërhequr.
 Limac/ë-a = tokë e mirë, me lym.
 Limazhd/ë-a = vend ku rrëshqasin fëmijët me saja; zhagë.
 Limer = strofkë.
 Limët (i,e) = i lëmuar.
 Ling/u = ecje e kalit, e mushkës ose e gomarit me hapa të shpejtë por jo me vrap; ngut, nxitim.
 Linj/ë/a/at = faqore, tis, litë, pef, sendon (turqisht çarçaf).
 Lipardh/ë-a = shkop kërrabë me veshë përpjetë ku fëmijët varin gjeth që digjen për Ditën e Verës e vrapojnë duke i tundur lart që të duket sa ma shumë flaka.
 Liqenz/ë/a = era që fryn nga liqeni.
 Lirak/e = që i ka anët të çara thellë e me vriguj (me llapa) si në gjethen e dushkut, panjës, etj.
 Lirisht/ëa = lirez/ë-a = kullotë e vogël në mes të pyllit; çeltirë.
 Lisare/ja = pyll i vogël me lisa; lisanjë = lisni.
 Lisk/ë-a = dredhë lëkure.
 Litar-i = tufë fijesh të përdredhura në një fill të trashë që përdoret për të lidhur a shtrënguar shumëçka; tërkuzë.
 Litë (i,e) = pambuktë.
 Lizhd/ë-ra = përzjerje me gurë, dhé, kërcabël (copë druri që sjell lumi), etj., që sjell përroi a ulluku gjatë e pas shiut.
 Livadhisht/ë/a = kullotë e vogël; vend me kullota.
 Lkë/hem-u-hen = ndjek fort; i vihem me tërë forcën nga pas; i qepem hap pas hapi.
 Lo/g/gu/gje/gjet = lëndinë e vogël (zakonisht në male në mes të pyllit), shesh.
 Logetrog = në një gjendje shumë të shregullt, në pështjellim të madh; rrëmuje.
 Log/oj/ova/uar = sheshoj, rrafshoj.
 Logrin/ë-a = rigë shiu, lagcinë, piklim, pikrrimë, vrigjëm, rremb shiu.
 Logrit = rimon shi.
 Log-u = kërcu i gjatë druri i gdhendur i lurtë për t'i dhënë ujë a ushqim kafshëve, koritë.
 Logj-i = tokë e askujt.
 Logjeg-u = gropë.
 Logj/ë-a = truall i vogël.
 Llokomic/ë-a = thupër e epëshme me lidhë dengun e barit.
 Lubardh = sa nis me zbardh dita, agu.
 Lubardh/ë-a = agu i ditës, sa nis me u shque zbardhja mbi terrin; agth.
 Lugin/ë-a = vend i ulët midis dy malesh a dy kodrash.
 Lu/g/gu/gje/gjet = + luginë e vogël nëpër të cilën zakonisht kalon një rrjedhë uji; hulli e madhe në arë, në livadh, etj.; shteg në dëborë që është ratur nga të ecurit.
 Lugaj/ë/a = luginjë = luginë e gjerë dhe e thellë; luginë e madhe.
 Lugar/e/ja = + luginë e thellë.
 Lugështirë = vend i lugët, lug.
 Lugshtaj/ë-a = luginë e madhe me ujë e lisa a drurë të tjerë.
 Lugshtin/ë-a = luginë e vogël.
 Lugth-i = vend i vogël si lug.

Lugthell/ë/a = lug mali i thellë.
 Lulnaj/ë/a = vend me bar e me shumë lule, lëndinë e lulëzuar.
 Lumisht/ë/a = vendi në të dy anët e lumit; arë në anët e lumit.
 Lumth = lum i vogël, degë lumi.
 Lurm/ë-a = rrëmore; shumicë gurësh që sjellin ujrak kur bie shi i madh; valishtë, mollos.
 Lushtaj/ë-a = vend me barishte e fletë të rrëzuara; vend me lyshtër.
 Luxhik-u = pus i vogël që shterr; buxhil.
 Lyç = ndajf., keq, ngatërruar (*u bënë litarët lyç*).
 Lym/i = balta që sjellin ujrak e lumejve e përrejve.
 Lymanor/e-ja = tokë pjellore me shtresë lymi.
 Lysht/ër/ra/ rat = balta, zalli, rëra, etj., që sjellin lumejtë e përrejtë dhe e lënë gjatë rrjedhës së tyre; lyrishtë; rrëzimë mali ku shket dhe e bien gurët.

Ll

Llac/ë-a = syth çorapi a trikoje; gunë a veshje tjetër shumë e gjërë.
 Llaçek-u = lug i ngushtë e drejt e përpjetë përgjatë shpatit të malit nëpër të cilin, kryesisht gjatë dimrit, tërhiqen drutë.
 Llakë/a = gropë a pellg me ujë, zakonisht në mal, ku pijnë bagëtitë; pellg me ujë të ndenjtur.
 Llapateshk/ë-a = gjysma e drurit të çarë përgjysëm.
 Llapavic/ë-a = llapërkajë, llohë, baltë e borë e shkrirë, skllotë.
 Llapavit/em-a = bëj baltë, skllotë ose llohë.
 Llapërçin/ë/a = baltë e hollë, llucë; vend me baltë të tillë; borë e përzier me shi; llohë; llapërkajë.
 Llapërkajë/a = borë e squllët e gjysmë e shkrirë; llohë.
 Llapëtimë/a = shkëlqim.
 Llast/ër-ra = rasë guri e gdhundur.
 Llaz-i = rogë, lëndinë me bar në mes të pyllit a në faqe të malit, vend i shveshur në mes të pyllit; pjesë e shveshur ose e rrjepur; pullë, larë.
 Llazin/ë/a = vend i hapur e me bar, zakonisht në mes të fshatit, ku lidhin kafshët e barrës për të kullotur.
 Llëng/ë/a = vend i ulët si gropë, zakonisht me lagështirë, sidomos pranë lumejve e kënetave; lerë; luginë e vogël me bar; arë e vogël a kopësht i mbjellë me perime në një tokë të butë.
 Lloç/i = baltë e qullët dhe e hollë, llucë; borë e shkelur dhe e përzier me baltë.
 Llofk/ë-a = ligatinë, balçak.
 Llogaç/e/ja/et = hurdhë e vogël me ujë të ndenjtur; lerë.
 Llogober/e/ja = lule ku petalet janë hapur shumë.
 Lloh/ë/a = borë e përzier me shi ose breshër të imët që bie zakonisht në një mot me erë; borë e lagësht; kohe e keqe dhe e ftohtë me borë, shi dhe me erë; lagështi.
 Llokaç- i = baltë e hollë; llapërçinë, pallavi.
 Llokaj/ë/a = ujë i turbullt e i fëlliqur me baltë e me ndyrësira; llum; llucë.
 Llokoçitem = + eci nëpër ujë e nëpër baltë, duke bërë zhurmë si llapashitje; lëviz në ujë, duke bërë llok-llok.
 Llome/ja/të = lymi i lumejve a i përrejve, lymore; fundërri e diçkaje; llum.
 Llomërkaj/ë-a = ujë që rrjedh me baltë.
 Llomështi/a = llucë e përzier me papastërti të ndryshme, llum i keq; ndyrësi.
 Llomishtë = lymishtë.
 Llonzh/ë/a = pellg me ujë shiu; strofull; vrimë (llonzha e dhelprës).
 Llopajc/ë-a = borë me llucë; llapavicë.
 Llosh/i/e/et = + vend me bar të gjatë e të ngatërruar; fig., *diçka e ngatërruar, rrëmujë*.

Llurb/ë/a = + baltë e qullët; llucë; llum i trashë që krijohet nga prurjet e ndryshme të lumejve; borë e shkelur dhe gjysmë e shkrirë; vend me baltë e me llum.
 Llun/ë-a = uji vërshues i përroit pas shiut; ujë i përzier me baltë.
 Lluvriq-i = borë gjysmë e shkrirë.

M

Mack/ë-a = maja e majës së një mali a sendi; macurrel, micket.
 Maçan/e-ja = tokë në anë të qytetit me drurë nëpër të.
 Magjar = urës = gur i gjatë ku mbështeten drurët e zjarrit në vatër.
 Mahc/ë-a = tojë që lidh sythet kundruall opingës e pastaj lidhet në kyçin e kambës.
 Majer/e-ja = brezare, rrip i ngushtë toke mbi një rrip tjetër toke.
 Majhisht/ë-a = maja ma e lartë e kodrës.
 Majacuk/e = që e ka majën të hollë.
 Majarak = që është me majë; i mprehtë.
 Majer/e/ja/et = vend i pjerrët a tokë që zbret shkallë shkallë si brezare.
 Majëmal/i/e/et = majë mali.
 Majol/e/ja/et = majë e vogël e një mali, e një kodre, e një peme, etj.
 Majuc/i/a/at = pjesa më e hollë e majës së diçkaje; majë e vogël.
 Malacak/e = malësor, malsiák.
 Malas-i = banor ose bari nga mali.
 Malësor = malacak, malatak, malok.
 Malíe-t = vend me pyje; pyje.
 Malíj/ë-a = murrilan-i, erë e fortë që fryn nga mali.
 Malisht/ë-a = tokë kodrinore malore.
 Malisht/ë/a = krahinë e vogël malore.
 Malshesh/e/ja = rafshinë malore; pllajë e vogël.
 Maltar/e = malësor.
 Mand/ër/ra = kope bagëtish; vathë bagëtish; stan.
 Manjadis = pushon a qetësohet (shiu, bora): manji bora; manji breshëri.
 Manj/ë-a = një erë as e mirë e as e keqe që u vjen pijeve a ushqimeve por që nuk është era e tyre natyrale.
 Maresht/ë-a = vend i mbushur me mare.
 Mardh = mërdhij.
 Mardh/ë/a = të ftohtë; ngricë; brymë e ftohtë që i prish bimët.
 Margjënor/i = strehë nën shkëmb.
 Mashalla (arabisht e turqisht) = i bukur; i zhvilluar; (*Mashallah themi në turqisht kur duam të themi "i bukur!", "i zhvilluar!", "sa mirë!"*).
 Mash/ën/na = stan bagëtish të imta; kasolle barinjsh në vërrí; kashtore për ruajtjen e ushqimit dimëror të bagëtive.
 Mashnor/i = barí që shtegton me bagëti nëpër bjeshkë gjatë verës.
 Mat/i = buzë lumi, breg deti; ranishte.
 Matanmálas/e = që jeton matan malit.
 Matit-a = mardh, mbërdhij, narth.
 Matórik-u = pellg-u.
 Mbajc/ë-a = dru a hekur anësh shkallëve për tu ndihmuar në ngjitjen e tyre (parmac).
 Mbaje-a = dru anësor për tu mbajtur në urat e drunjtat të përrenjve a lumejve (parmac).
 Mbaj-s-i = vathë, vathore, torishtë.
 Mbaj-s/ë-a = gardh i lartë e i dendur.

Mballes/ë-a = kullot/ë-a.
 Mballim/i = udhë e shkelur nga bagëtia kur shkon në kullotë.
 Mbasbjeshkatar/i = banor në mbasbjeshkë.
 Mbasbjeshk/ë/a = krahinë a vend që ndodhet matanë bjeshkës.
 Mbledhaj/ë-a = borë që çon era; merlë (grumbull bore që krijohet kur bie borë e fryn erë), shfrë (borë e grumbulluar prej erës).
 Mbrezhd/ë/a = vathë e përkohëshme ku mbyllin bagëtinë për të mbledhur pleh.
 Mbris/ë-a = lak që i vihet lopës në brirë; lidhë.
 Mbudh/a/ur = e takoj dikë në rrugë.
 Mbudhem = takohem me dikë; + bëhem gati për rrugë.
 Mbushulli/a = sasi e madhe; shumicë (turqisht bollëk).
 Mbuz = afrojt pranë, fare pranë.
 Mbyllcak-u = pyll i dendur.
 Megj/ë-a = mezhde = kufi që ndan arat, livadhet, pyjet ose pjesë të shtëpisë.
 Mekës-i = pjesa e lakuar në shputën e këmbës.
 Mellsí-a = mill (turqisht këllëf).
 Menjë/a = nektar.
 Mer/ë/a = erë e mirë (mera e luleve).
 Merm/ë (i)/e (e) = që ka erë të mirë (*lule të merme*).
 Meran/ë-a = tokë e të gjithëve ose e askujt.
 Merl/ë-a = stuhi, mullavë; grumbull bore kur bie borë e shoqëruar me erë; mbledhajtë.
 Merla-merla = grumbuj-grumbuj (bora): *era e ka bërë borën merla-merla*.
 Merllang/em-a = fryhem në fytyrë, enjtem, ajem.
 Mertos = ngul, mbërthej.
 Merrl/ë-a = valishtë bore, borë shekullore a e përherëshme; ortek bore.
 Mesarak/u = rrip toke i ngushtë midis dy tokave.
 Meteh = kufi a teritor në një vend të naltë; fushë a livadh i vogël në bjeshkë.
 Mëdhes/ë/a = shtëpi përdhese.
 Mëkresë/a = gur varri.
 Mëmëzonjë = mëmëmadhe, nëna, mëma (turqisht gjyshe).
 Mënez-a = kokër mani, fryt (tëbam) mani.
 Mëng/oj/ova/uar = ngrihem qëmenatë; ja nis një pune herët; nxitoj.
 Mënj/ë/a = shi i hollë; vesë shiu.
 Mënjoll/ë/a = bimëz = bitme = degë e hollë, thupër.
 Mërdostë (i,e) = i egër, i ashpër, jo i butë: *lëkurë e mërdostë*.
 Mërdhacan/e = mërdhac = që mërdhin shumë.
 Mëti/ni/j/jt = tundës.
 Mëtiz-et-em = bëj të nxihet e të ënjtet një pjesë e trupit: *rrugëtimi nëpër stuhi më mëtizi duart*.
 Mëtyt = mbush plot deri në grykë a buzë; ngjesh (rancn, thesin).
 Miellaz/ë/a = borë e imët si miell.
 Mirakandas = me kënaqësi, me mirakande.
 Mirak/ë-a = skifter.
 Mishnjë/a = myshk i butë në lëkurën e drurëve të vjetër; leshterik.
 Mishtore = fanellë leshi që vishet si kanotjere.
 Mitan = jelek me mangë.
 Mitantrashë = xhup.
 Mixëllon = bulon: *kanë filluar të mixëllojnë lulet*.
 Miz/on/oi/uar = bie borë e imët, fijon, qimton.
 Mjak/em/ a(u)/ur = më thahet goja, më bëhet goja shkrumb nga etja e madhe, nga ndonjë sëmundje, etj.; rreshkem; mjakë = shkrumbi që zë goja nga etja, ethet, etj.
 Mjegulli/a = gjendje si me mjegull; gjysmëerrësirë.

Mjegullin/ë/a = mjegull e hollë; mjegull; kohë me mjegull.
 Mjegullnajë = mjegull e dendur e në hapsirë të gjërë.
 Mjegullishte = mjegulli, mjegullinë.
 Mjelláz/ë/a = borë e imët si miell që ngrihet në ajër nga era.
 Mjollak = dru fillak, i drejtë e pa nej.
 Mkahj/e-a = prejardhje, zanafillë, origjinë.
 Mlet/em-et = myket, prishet prej lagështirës (litari, teshat, ushqimet).
 Mlet/em-et = merr lagështi, ujcitet, myket nga lagështija.
 Mnyth-i = kallo.
 Mocanik = moshatar, bonjak, kohanik.
 Moçal = kënetë, ligatinë, ujerë, ujnajë, bërrakë.
 Moj/e-a = shesh, log.
 Molinë= pluhun: *tokë molinë = tokë pluhurore*.
 Mollak-u = gur që mundet me e kap në dorë e me e gjujtë.
 Molli-a = baltë; i mollishëm = që është me baltë.
 Monopat = dhiare, udhëz, udhishtë.
 Moren/ë-a = barishte, copa të tilla në fund të detit e afër bregut.
 Mot-i = kohë me rreshje të mëdha; rreshje të shumta e të zgjatura: *ushtojnë malet si prej motit*.
 Motkeq/e/ja = juga, era e shiut.
 Mozaik-u = thyezim, larmi.
 Mozg/ë-a = ferrë e madhe, muriz.
 Mrinj/ë-a = vend i thyeshëm; rrëpirë.
 Mrret-i = pyll i dendur, shpeshtinë.
 Mriz/i = vend me hije ku kalojnë vapën bagëtia; mërzim; koha e vapës më të madhe gjatë ditës.
 Mrizore = mriz; hijesirë.
 Mrrot/em-a = rrëzohem, marr rrokullimën.
 Mshehëz-a = kasolle me gjethe ku zënë pritë gjuetarët; fshehëz.
 Mshej/em = bie nga lart dhe bëhem me shenja në trup a në fytyrë.
 Mshelc-i = kyç, çelës.
 Mshelës-i = shul i derës.
 Mshic/ë-a = kapak.
 Mti = tpi, tundës (turqisht dybek); (rrokme/e/ja = filiç quhet rahësi i tundësit të qumështit).
 Muçk/ë-a = vezë e klluqtë.
 Mu/g/gu = muzg; muzgu.
 Mugëllon = zë e ngryset ose zë e gdhin.
 Mujaskin/ë-a = tokë me ujë, ligatinë.
 Mul-i = mushkë.
 Mulin/ë-a = rërë shumë e imët.
 Mullav/ë-a = stuhi e fuqishme.
 Muran/ë/a = grumbull gurësh në vendin ku është vrrarë ose varrosur një njeri; gurë të mbetur nga një mur i rrëzuar; gërmadhë me gurë; gurishtë.
 Muranj-i = erë e ftohtë, veri.
 Murg/ë-a = llum-i.
 Murgëztoj = errësoj.
 Murgshëm = vranët (moti).
 Muriq = i keq, i lagët (moti).
 Murrfic/ë-a = vend ku nuk bie dielli ose bie shumë pak; ftohtësinë, hijetinë.
 Murrilan-i = erë as e ftohtë e as e ngrohtë që vjen nga veriperëndimi dhe ndihmon në shkrirjen e borës.
 Murrilan i zi = erë e fortë dhe e ftohtë.
 Mushá/ja/të = tokë e lënë djerr për kullotë; kullotë e përbashkët e një fshati.

Musham = kullotë në periferi të një lagje fshati dhe që e përdor vetëm kjo lagje (Radomirë).
 Muzg-u = gjysmëerrësira pas perëndimit të diellit.
 Myc/ë/a = dru i thatë e i kalbur që thërmohet lehtë.
 Myj/ë/a = pjesa e brëndëshme e drurit nga palca deri tek ura, zemra e drurit; fig., *mesi i diçkaje, palca, zemra (myja e dimrit)*.
 Myjsh/ë/a = hiri që vë sipër thëngjilli; lëmashk në dru a gur; makrosë = shtrap = cipa që zë sipër një lëng a uji.
 Myl/k/ku/qe/qet = pronë e madhe (toka, kullota, vreshta, pyje, etj.) e trashëgueshme dhe e tjetërsueshme.
 Mys/i/e/et = pjesë e dalë ose e ngritur e diçkaje që vjen e harkuar e me kurriz; kurriz (mysi i dorës = kurrizi i dorës; mys i qiellit = kupa e qiellit).
 Mysët (i, e) = që është i dalë si gungë dhe i rumbullakët nga sipër e nga jashtë = grahuq.

N

Najo/j-va = vak, ngroh pak.
 Nalvin/ë-a = vend pak i ngritur, bregore.
 Nardh = mardh.
 Nartë (i) = i kulluar
 Natj/e-a = mëngjes.
 Nat/oj/ova/uar = kaloj natën.
 Nerring = gati në të rënë.
 Ndajnat/ë/a = në të ngrysur; në muzg të mbrëmjes.
 Ndajnatherë = pak para se të ngryset, në të ngrysur.
 Ndajver/ë-a = pranverë.
 Ndej/ë-a = vend ku rrihet për një kohë të zgjatur (*ndeja verore e Aleksandrit = banesa verore e Aleksandrit*); në urim: *ndjea mirë! = mirë se rrini!*.
 Ndejmbraj/e-a = buzëmbraj.
 Ndejt/ë-a = dhomë që përdoret gjatë ditës e natës për të ndejtur, dhomë ndejtje (italisht soxhorno, anglisht living rum).
 Ndel/ë-a = pelenë.
 Ndenj/je-ja = qëndrim në një vend; të ndenjurit.
 Ndërfush/ëz-a = fushë e vogël nën një fushë më të madhe.
 Ndërklis = dëmtoj dorën, këmbën, kryqet, kur bie nga lart; ndrysh, pëlkeje.
 Ndërklisem = ngatërohem, dal gabimisht në një vend tjetër.
 Ndërlikë/a = thurinë.
 Ndërlumna = vendi ndërmjet dy lumenjve.
 Ndërmit/a/ur = vras, shtyp; e ndërmiti këmbën; *ndjehesha i ndërmitur = i lodhur tej mase*.
 Ndërshen = bulon; qet sytha: *ka ndërshye mali*.
 Ndërshejç/ë-a = barrë që i shtohet kalit midis dy barrëve kryesore.
 Ndërraç/ë-a = koha kur ndërrohet hëna.
 Ndore = shpejt e shpejt: *ta jep përgjigjen ndore*.
 Ndor/e-ja = mbrojtja që i jepet dikujt (sipas kanunit të maleve) kur e ka jetën në rrezik.
 Ndortë = gjalmë, lidhëse opingash; tojë.
 Ndrizë = rrip prej leshi (si p.sh. për të lidhur foshnjen në djep), retër, cimboshë, dizgë, uvje.
 Nduj = lagur shumë: *më ka nduj shiu*.
 Ndyllcavtë = i lagët e ngjytës: *kjo baltë është e ndyllcavtë*.
 Ndylltë (i, e) = i butë e i qulltë; *bukë e ndylltë; toka të ndyllta*.
 Nejç/e = që ka shumë nyje; dru nejçe; litar nejç.
 Nejth-i = kyçi, nyelli, zogu i këmbës.

Nen/i = nyelli, syri i këmbës; *ju ënjt neni i këmbës*.
 Nerdorc-i = shportë dore e vogël.
 Nëngrykëz = copë, pëlhurë që i vihet një thesi a çante në pjesën më të sipërme që të mos derdhen artikujt që janë në të.
 Nënkye-ja = nënkryesë, (turqisht jastik).
 Ngalët (i, e) = që mezi ecën, i plogët.
 Ngarkojs/ë-a = copë leshi me toja të trasha për të ngarkuar në shpinë sende të ndryshme.
 Ngat = afër me gjak; para pak kohësh; pranë, afër.
 Ngecull/a/at = pengesë: *rrugë me ngeculla*.
 Ngol/ë-a = (turqisht gozhdë).
 Ngrënë/a = + vend i ngrënë në një send.
 Ngri-a = akull; borë e ngrirë: *vëndin e kaploi ngria*.
 Ngric/ë-a = të ftohtë që ngrin ujin, acar, mardhë, ngrijë, akullimë.
 Ngrydh/em/a/ur = grumbulloheni në një vend me shumicë e ngjishemi.
 Ngrruc/em-et = mblihem rreth vehtes: *të ftohtit e madh më bëri të ngrrucem*.
 Ngulaj/ë-a = shpatinë e pjerrët, rrelë, rrëvinë, rrëpirë.
 Ngulët (i,e) = i përpjetë: *shpat i ngulët*.
 Nguracak = shumë i ngjeshur e i fortë.
 Ngjethj/e/a = lëshon gjethe, vishet me gjethe; fig. *këndellet; ngjethet natyra në pranverë*.
 Nig-u = mjegull.
 Nirthm/ë-a = nirthje, narth, të nirthtun, të ftohtë.
 Nomé-ja = kullotë.
 Nort/ë/a = gjalm.
 Novin/ë-a = terr i thellë.
 Nuric; nuricje = ngacmim, gërvishje.
 Nyj/ë-a = lidhje e shtrënguar e një filli, litari, etj., komb, nyell, lak, lidhje.
 Nyç/e = neç/e = dru nyç; *arrë nyçe = arrë gungë*.
 Nyng/ë-a-t = nyjë e përdorur nga alpinisti e cila e lejon ose e pengon zbritjen e tij nëpër litar në vartësi nga ushtrimi i peshës së tij në të dhe që komandohet nga dora e tij.

Nj

Njegj = mot vere i nxehtë e me mjegullinë të hollë.
 Njegjëll = mjegull.
 Njet = lag, njom a zbus me pak ujë: *e njeta duhanin*.
 Njet/em-a = lagem a njomem pak.
 Njish/ë-a = kasolle.
 Njizë = + më herët se zakonisht: *u zgjova njizë; zu vapa njizë; këtë vit zu të ftohtët njizë*.
 Njomisht/eja = + vend i veshur me bimësi të njomë.
 Njomsh/i = bari i njomë.

O

O-óca = pasthirmë që përdoret për të shprehur ngecje: *o-óca litari*.
 Ograj/ë/a = kullote pranë pyllit a në mes të korijeve ku kullot bagëtia; pyll i vogël me lëndina për kullotë.
 Ojnik/u = erë e lehtë deti.
 Ojnite-t = kodra ndërmjet fushës e malit.
 Ormá = tërma, përpjetë.
 Ortek = masë bore që bie nga shpatet e malit me furri, rreshme, rrotullak rrungajë.

Oshnik/u = erë e lehtë, veri.

Ovore = erë e ngrohtë që fryn nga jugu e sjell shi.

P

Pah/u = pluhur i imët i diçkaje, si: *pahu i borës, etj.*

Pahi-a = gardh me hunj a dërrasa të holla që mbërthehen me një tërthorëse e ngjashme me kangjella, tavaz/ë-a.

Pahitem = pahis = freskohem a i bëj fresk/veri dikuj.

Pajoll/ë/a = lak, kurth.

Palakordh/ë-a = erë dimërore e thatë, shumë e ftohtë.

Palavig = urë e ngushtë prej druri mbi një përrua a mbi një prarom (kanal).

Palladá-ni = bota, njerzia që na rrethon.

Pallak = objekt që është i gjërë në krye e i ngushtë nga fundi, si pallë.

Pangar/ë-a = tokë djerr.

Panojmë (i,e) = që nuk i dihet vendi a drejtimi: *erdhi nga një vend i panojmë.*

Papërdhok = guralec.

Paraspúrë = e ligë, jo pjellore (toka); djerrë.

Parator = prijës.

Paror = simite.

Parz/ë-a = pjesa e përparme e trikos ose e një veshje.

Paslug/ë-a = ëmbëlsirë ose tëbam (frut) që jepet mbas ushqimeve që merren me lugë e pirun; perihim/e-ja.

Pasmal = pjesa prapa malit = temal.

Pasmuzg = koha pas muzgut, fillimi i mbrëmjes.

Paste-ni = mbulesë dimërore me disa lëkurë të qepura bashkë.

Pashore-ja = rrugicë që përdoret skaj shtratit në fjetën (dhomën) e gjumit.

Pashtegie = rrugë pa krye, qorrsokak.

Pasht/ër/ra = kullotë me bar të pashkelur; vend me bar ku s'ka kullotur bagëtia.

Patok = dardallë (+ mashkulli i patës).

Patokç/e-ja = tokë e kripur buzë detit që nuk punohet.

Patoz/i = tokë e ngjeshur me këmbë nga të ecurit, etj.

Pavdirë (i,e) = që s'shuhet e që s'venitet kurrë; i pavdekshëm (*bukuri e pavdirë*).

Pazë (i,e) mb. = i pazëshëm, i qetë, i heshtur (*vend i pazë*).

Pellg-u = gropë e vogël me ujë të ndenjtur, llakë, llonxhë, çeptirë.

Pellgaç/eja = pellg i vogël me ujë.

Pellgishte = vend me pellgje të vogla.

Pellgore = gropë e madhe me ujë; pellg i madh.

Pemël/la = tëbam-e, fryt peme; frut-a.

Pend/ë/a = sfrat i ngritur me gardh e me dhé, me zhavor e me gurë anës lumejve, gjatë bregut të detit, etj., për të penguar vërshimin e ujrave; digë.

Penkallë = stilolaps.

Pentar-i = litar.

Panxhin/ë-a = guralecë.

Perishtup = vit perishtup = vit i brishtë.

Perrlag/ë-a = vend i thiktë e i lagur i pasur me kullotë.

Perran/ë-a = rrugë e ngushtë, e vështirë e në një vend shumë të pjerrët.
 Petak/e = petashuq, rrasik.
 Petanor/i/ë/ët = vend malor i pjerrët e shkallë-shkallë; shkëmb i madh me disa shtresa si petë e që formojnë sheshe shkallë-shkallë.
 Petëzak/e = i sheshtë e i hollë si petë.
 Pezul/i/e/et = pjesë e dalë e diçkaje.
 Përánshëm (i) = anësor, dytësor, i tërthortë.
 Përbirohem = kaloj me vështirësi nëpër një vend të ngushtë; depërtoj diku, hyj thellë duke çarë përmes vështirësishë.
 Përbiroj/ova/uar = kaloj diçka nëpër një vrimë.
 Përbisht = përhap andej kënde; përndaj.
 Përbishtëm = largohem bashkë me të tjerët andej kënde; përndahe.
 Përbor/a/ur = i hedh borë dikuj a diçkaje; mbuloj me borë.
 Përborm/ë (i)/ e (e) = e mbuluar me borë; që shoqërohet me borë (*majë e përborme; erë e përborme*).
 Përbuj/ta/tur = e mbaj në shtëpi dikë për të kaluar natën; kaloj natën diku (buj = me kalu natën).
 Përbujtës = ai që përbun diku (*isha përbujtës tek Roku*).
 Përcëllak = + zjarr me flakë që bëhet për të përcëlluar diçka (pulën).
 Për/djeg/dogja/djegur = e djeg pak në sipërfaqe.
 Përfik/a/ur = ter pak, fikat; përfiket = fillon të teret, fikatet: *u përfikën robot në tel*.
 Përhedh/ë/a = shtresë e hollë dëbore.
 Përhër = zgjoj herët nga gjumi.
 Përhjekës-a = vegëz (litari a peri).
 Përjeç/ë-a = opinga lëkure.
 Përkëndëll = gjallëroj ngadalë e thellë: *dimri shkoi e Zoti përkëndeli qiell e tokë*.
 Për lag = lag ngadalë; lag nëpër të; përvesoj.
 Përles/ë-a = vend deltinor, pa bimësi, me lagështi e ku rrëshqet lehtë.
 Për lim = borxh, detyrim.
 Për linë (i,e) = shumë i pjerrët, i rripët: *shpat, përrua i për linë*.
 Përllang = bëj me baltë, baltëroj.
 Përllë-a = vend i pjerrët, i lagët e i zhveshur.
 Përllaç = fëlliç me baltë; përbaltem.
 Përmaj/e-a = rrymë ajri e fortë, korent.
 Për mal = për pjetë, tër mal.
 Përmën/oj/ova/uar = vonohem pak, mënoj.
 Përndahe = lagohet sejcili në drejtime të ndryshme.
 Përngjesh = e ngjesh diçka fort.
 Përshkoq/a/ur = thërmoj, shkoq; përshesh; shpërndaj, përshkëndit.
 Përshkul = shkul me forcë.
 Përtejkersh = vendi a njerzit përtej shkëmbit.
 Përtejlum = vendi a njerzit përtej lumit.
 Përter/a/ur = e ter pak diçka; përteret = teret pak.
 Përtruall = përtokë.
 Përtymur = i mbuluar krejt me tym, i tymosur.
 Përthaq = lym i hollë që mbetet nga vërshimi i lumit.
 Përthekohem = vishem e ngjishem e shtrëngohem fort.
 Përthekues = tojë; gjalmë me lidh grykën e thesit a rancs.
 Përthim/ë-a = sa nis agu; agshol; zbardhëllim.
 Përves/em/a/ur = lagem nga vesa; mbulohet me vesë.
 Përvëlak = adhures a dashnor i zjarrtë; fans.
 Përvok = përziej ujë të ngrohtë e të ftohtë që të mundem të lahem.

Përvónje = mbasdite.
 Përzhin/ë-a = dhé i imët e i thatë, tokë e thatë.
 Përrlag/ë-a = përrll/ë-a = përrlë, shpat i lagët e i gryer thikë.
 Përrosk/ë/a = përrua i vogël; rrëke uji; përrua mali që zakonisht thahet në verë.
 Pështymvdorë = shtresë shumë e hollë bore, si pështymë.
 Picel-i = majë e sheshtë e një kodre të lartë.
 Pic/ë-a = vend i pakalueshëm në pyll për shkak të bimësisë tepër të dendur; shpeshtinë.
 Picihul-i = majë e mprehtë shkëmbi; thep.
 Picunar/e/ja = burim me ujë shumë të pakët.
 Pik/i-a = rrëzohem pingul prej një lartësie.
 Pik-qok = një këtu e një atje, të shpërndara: *Thethi i ka lagjet pik-qok*.
 Pimaz = mënyrë e shpërndarjes së ujit gjatë ujitjes, nga pak e kudo që ta pijë toka ngadalë e të gjithë.
 Pinuc-i = njeri i shkurtër; djalë i ri, i njomë e me shtat të hollë.
 Pipiruc-e = që është me majë, jo i rrafshhtë; i rroshtë.
 Piptin/ë-a = pip, bisk; bar i njomë që del në bjeshkë në gropat ku shkrin bora.
 Pirrem = përkulem nga njëra anë, marr drejtim të pjerrët, anohem.
 Pirr/ë-a = rasë guri; shkëmb me fyta (fyt-i-a = lug i ngushtë në lartësi të pjerrta midis shkëmbjeve); grykë e ngushtë lumi. e me lugje.
 Pirrl/ë-a = ashkël ose petë e vogël guri.
 Pisk-u = nyjë e lidhur fort, komb, cimbthi (shtrënguar).
 Piskará-ja = hell akulli.
 Pishak/u/ë/ët = pishë me trung të trashë, cung pishe; pyll i vogël me pisha; pishtar.
 Pishnajë = pyll me pisha.
 Pit = thikë përpjetë.
 Pitërr = i shpeshtë, i dendur: *pyll pitërr*.
 Pizgë = + curril uji, etj.
 Piurrl/ë-a = cifël guri.
 Pizát = del curril.
 Pjerk = i varur, që rri si i varur: *gur a shkëmb pjerk*.
 Pjerrak/e = i pjerrët: *rrugë pjerrake*.
 Pjerrinë = pjerrësirë, shpat, shulnajë.
 Pjetposhtë = përposh, tatëpjetë.
 Plan-i = tokë e sheshtë, log, shesh.
 Pleng/u = kunj për të varur diçka.
 Plim = tufë; varg: *vinin zogjtë plim*.
 Plis-i = copë e madhe dheu, bucë, cabok.
 Pllajë = rrafshnaltë.
 Plloshm/ë-a = pellg ku uji nuk lëviz ose lëviz shumë ngadalë.
 Pluhnajë = shtresë e gjërë pluhuri.
 Plusk/u = pluhurizë; pjalm; plusk bore; cipë e hollë që zë në sipërfaqe çdo lloj lëngu.
 Pllaér/ë-a = vend ose arë në kodër; pjerrësirë.
 Pllat-i = pllakë e madhe bore në lartësi e cila mundet të shembet (mbi kulm).
 Pllaçak/e = petashuqe, gur pllaçak.
 Pllusk/ë-a = shtresë e hollë bore të qullët.
 Poçik-u = vend me bar e me gjethe ku mundet të ulesh; ultësirë mes lugjesh.
 Pop/ël/la/lat = gur a plis dheu që vjen si i rrumbullakët, plis.
 Pore-ja = vazhda shiu në tokë.
 Pork/ë-a = zagën (pjesë are e ngushtë dhe e gjatë); lehe, vllajë, hulli.
 Portar/e/ja = portë e bërë me thupra; lesë; vathë.
 Porropí /a = mbrapshti e keqe; shkatërrim, prishje; rrokullimë, greminë.

Postaf/i = lug i madh që vihet poshtë burimit për të mbledhur ujë që të pijë bagëtia; lugare.
 Poshtarak/u = banor i luginave të ulta; fusharak.
 Porrcak-u = gavetë.
 Porrcëz-a = fontanë, burim që e hedh ujin përpjetë, cërrkajë (turqisht shadërvan).
 Pósh/e-ja = shami që gratë e malsisë lidhin rreth ballit.
 Prajc/ë-a = vend me ndenjësë guri a druri në hije, për pushime në rrugëtimet e gjata.
 Prajs-i = gur a dru për tu ulur e pushuar në hije.
 Prapësin/a/at = vend në mal, në luginë, etj., prapa një pjese të ngritur e që nuk e zë dielli; hijesirë:
nuk shkrin bora në prapësinë.
 Prarom-i = pritë, stom me i pritë ujrak që të mos gërryejnë arat (turqisht hendek), vijë e thellë,
 kanal i thellë në tokë, kapt.
 Prásj/e-a = prajcë, pushim.
 Prásk/u = cipë a shtresë e hollë që vesh diçka; perde: *prask bore/akulli.*
 Pravullít = bëj që ta nxjerr të ftohurën duke djersitur i mbuluar fort e duke mbajtur fytyrën mbi
 një enë që avullon ujë pandërprerje.
 Prell/i/e/et = shullë, vend që e zë mirë dielli dhe e rreh pak ose aspak era.
 Prellisht/ë/a = shullë; prell i gjërë.
 Prend/ë-a = Prenë = hyjneshë Ilire si Venera për romakët.
 Pres/ë-a = vendi ku ndahet uji i vijës apo kanalit për të vaditur arën.
 Priáls-i = kyçi i dorës, mbasgrushti.
 Prij/ë/a/at = hulli përmes arës për kullim ose ujitje, presë; ngastër are midis dy hullive, lehe;
 rradhë pemësh në fund të arës (*prijë hardhishë*).
 Priz/ë-a = vijë e vogël uji e shkaktuar nga ujrak rrjedhës.
 Prozh-i = vath/ë-a.
 Prozhm/e-ja = rrahinë, rrethim me megja (kufinj që ndajnë arat a kullotat).
 Prushnore = mjet ku mundet të vendosim prushin dhe të ngrohim ambientin (turqisht mangall).
 Prrën-i = vend ku mblidhen e derdhen përrenj; ujëmbledhës përrenjsh.
 Prréz-i = hije e fortë, mriz.
 Pucanit/em-a = mblidhem e gatitem mirë për të kryer një punë a për të shtegtuar.
 Pucitem = vishem e mbërthehem fort.
 Puçek-u = puçik-u = gropëz në dhé apo më fort në gur që mban ujë.
 Puç/i = majë (e kokës, e vezës, etj.).
 Puçigan-i = vend i thellë në ujë; gobellë.
 Puçik-u = burim i ftohtë që sapo del prej toke.
 Puçil/ë-a = gropëz që mban ujë.
 Puçiqe-puçiqe = me pellgje: *pas shiut rruga ishte puçiqe-puçiqe.*
 Puh/a = erë e lehtë dhe e freskët, puhizë, fllad, fresk, veri.
 Puhizë = puh i lehtë.
 Puprriq = (i,e) mbledhur kruspull nga të ftohtit.
 Puprriqe = mornica, rrënoqethje.
 Purr/ë-a = prush, shpuzë.
 Purrit = përcëlloj në zjarr.
 Pusak-u = pus i vogël, pellg i vogël shiu.
 Pusterr-i = vorbull shumë e thellë në lumejtë malorë (me legjenda për qenie metologjike në to).
 Pusterr = shumë errët, terrnovinë.
 Pyllnajë/a = pyll i madh.

Q

Qafalak-u = pjesë e lakuar në një qafë mali.

Qafalik/u = qafë e vogël mali a kodre = qafër/e/ja = qafisht/ë/a.
 Qarkëz/a = tufëz bari i kositur që lihet në livadh për t'u tharë.
 Qas/ë/a = vend mërzimi, mriz.
 Qeçk/ë-a = mbërtheckë, kunj që përdoret për qepjen e barkut të berrit kur e pjekim në hell.
 Qekth/i = shi me pika të turbullta që si rregull bie kur ka shtrëngata me erë e pluhur; pluhur i hollë që u bie bimëve bashkë me vesën; vesë.
 Qelqe-t = enë e qelqtë (*bleva një qelqe me vaj*); (në turqisht shishe).
 Qepohem = shpohem me gjemb a me diçka tjetër me majë.
 Qerës/e/ja = tokë e lënë djerr; tokë pa bimë.
 Qerm/i/e/et = buza pak e ngritur anës arës, ledh; rrip toke i papunuar rreth një are; pjesa pak më e ngritur e vatrës nga ana e tymtajës; rreth i ngritur në grykën e pusit.
 Qerthull/i = + vija a vendi përreth diçkaje, qark (*i u afruam qerthullit të zjarrit*).
 Qerthull/oj/ova = ze vend rreth e rrotull dikujt a diçkaje; thur rreth e rrotull me gardh a me mur.
 Qerrët = mal a pyll i shpeshtë, i dendur; pyll me qarr.
 Qet/ë-a = copëz toke me bar në mes të kreshtave; zdërlug; shkëmb.
 Qez/ë-a = ashkël shumë e imët, spirrë.
 Qëmt/oj/ova/uar = mbledh diçka aty këtu e duke kërkuar; bie ngadalë borë e imët a shi i hollë.
 Qinos/a/ur = bashkuj bagëtitë e mija e të një tjetri për t'i ruajtur së bashku; qinosje.
 Qirithi = mbi dy këmbët e pasme (për kafshët); drejt përpjetë.
 Qok/ël-la = shenjë gdhendje në dru a gur.
 Qokisht/ë-a = vend me gurë skaj fshatit.
 Qor/e/ja = gropë në mal që nuk e zë dielli.
 Quk/a/ur = bie me sqep, çukit; shpoj me diçka që ka majë a teh; qukë = gjurmë këmbë e hapur nga alpinisti në truall të ngrirë me ndihmën e goditjeve, kryesisht me kazëm ose këpucë.
 Qukth = sqep i vogël.
 Qunëz = me ndenjë qunëz = me ndenjë në kambë.
 Qupl/ohet/ua/uar = trashet (tehu i një vegle).
 Qyé-ni-t = shumësi: qej = majë, pika e majës së malit.
 Qyl/ë-a = sëpatë e vogël.

R

Radhiq/e-ja = bimë barishtore që përdoret e zijer për sallatë, bresë, lëkore, çikore.
 Radhor/i = varg gurësh që dalin nga toka ose në një shtresë shkëmbi; gur i madh; varg që varet në qafë për zbukurim.
 Raj/ë-a = rrajë = rrehe = shteg nëpër borë.
 Rakit/ë-a = shelg buzë lumejve malorë.
 Ranc-i = ranc shpine me rripa.
 Ráv/ë/a = dhiare; rrugë e ngushtë e çelur nëpër borë; vijë që e lë pas diçka, gjurmë, monopat.
 Razog-u = pushim; koha për një pushim të shkurtër.
 Re-ja = thupër me të cilën lidhet një lëndë a një dru për ta ulur zhag (zvarrë) teposhtë.
 Repe-a = vend i zhveshur; tokë e thatë shtufore në brinjë.
 Res/ë/a = + vend në lumë ku i zihet pritë me thurina peshkut për ta kapur natën; pritë.
 Resh = bie mbi tokë (*reshi bora/shiu*); i jap me shumicë mall e plaçkë (*e reshi shtëpinë*).
 Resha-resha = shumë në sasi: *bie bora resha-resha*.
 Reshp/e/ja = shkëmb a gur i butë që thërmohet lehtë; ortek dëbore.
 Resht = ndaloj, largoj, përzë (*reshti shiu/era/dëbora*).
 Rét/ër-ra = dredhë e lëkurtë; dizgë për të lidhur foshnjën në djep.
 Rezin/ë-a = tokë e thatë, jo pjellore.
 Rezhg/ë/a = zgavër e hojeve të mjaltit.

Rëbok/eja = lëvorja e pishës.
 Rëfryrë/a = gdhe në dru.
 Riktoj = nis të zbardhë agimi; nis të duket pak (diçka); fig. shndëris, shfaqem (sa rikton moj vajzë).
 Rimë = që ka shumë lagështi; i njomur (kullota të rimuara nga bora e sapo shkrirë).
 Rëkor/eja = radhiqe.
 Rig/ë/a = curril i hollë, vijë e hollë uji (*rigat e shiut, dy riga lot; ra një rigë shiu = ra një vesë shi*), shi i imët, vesë e shkurtër shiu, mënjë, vesim.
 Rim/i/e/et = vijë e hapur nga ujrat e shirave; shteg; udhë e ngushtë; rrahe.
 Rimtë (i,e) = i bruztë: *qiell i rimtë*.
 Rirë (i) = i lagësht.
 Rodúm-i = ujdhesë zalli që formon lumi ose deti; stom zalli.
 Roga-roga = +, pulla-pulla, vende vende (*bie borë/shi roga-roga; ka zënë bora roga-roga*).
 Rogaj/ë-a = kullotë.
 Rogall/e-ja = tokë jo pjellore.
 Rog/ë/a/at = lëndinë me bar në mes të pyllit a në faqe të malit; vend i zhveshur në mes të pyllit; *rogat e bjeshkëve*; pjesë e zhveshur ose e rrjepur; pullë; larë.
 Rogoc/ë-a = rrip i ngushtë toke; rogë e vogël.
 Rogo/hem/ova/uar = shkrihet, tretet vende vende (bora); më bëhet koka pulla-pulla nga rënia e flokëve.
 Rogjá/ni/j/jtë = degë e një lumi që ndahet në shumë krahë para se të derdhet në det.
 Roit/i/ur = luzmon (ikën blea nga zgjoi bashkë me mëmën për të krijuar një familje më vehte, lëshon, shtie; fig., *shkojnë grumbul e me zhurmë; luzmë = + sasi e madhe e diçkaje*); zukat, gumëzhin, si: *roit shiu/era, ose roitin zërat e fëmijëve*; fig., më gëlon si: *më roitin mendimet (kujtimet) në kokë; luaj nga mentë, si: roiti plaku*; shket, vidhiset; rrjedh si: *roiti ena*.
 Rojk/ë/a = blea që ikën nga zgjoi i vet; bagëti që shkëputet nga tufa e vet.
 Rojsí/a = shi i rëmbyeshëm e i rëndë.
 Ron/ë-a = vërshim uji; bujanë.
 Rudinë = shesh i gjërë me bar të njomë në mal; lëndinë.
 Rumb/i/e/et = kunj druri; thumb; *edhe në kuptimin figurativ si: i futi një rumb*.
 Rup/ë-a = shpatinë me drurë.
 Rupizgë = boçe pishe.

Rr

Rrab/e/ja = tokë e keqe me gurë e kaçuba që jep prodhim të paktë; djerinë.
 Rraenës-e = i rrjedhshëm (ujë).
 Rrafshjan = banor nga rrafshi; fusharak.
 Rrafshok-u = vend irrafshhtë, rrafshinë.
 Rrafshulët-a = ultësirë.
 Rragam/i = shkëmb i madh; krep.
 Rrah/u/e/et = tokë buke a kullotë që hapet në pyll duke prerë drurët e shkurret e duke i djegur; shtrirë (për tokë, në shtrat) si: *u rrëzua rrah përdhe; ishin të gjithë rrah nga gripi*.
 Rrah/e/ja = udhë e ngushtë, e hapur në dëborë, etj.; rim; shtegu i flokëve.
 Rrahin/ë/a = rrah i lënë djerr; rrahishtë = tokë rrah; rrahitet = bëhet rrah vendi.
 Rrahisht/ë-a = tokë e rrahur.
 Rrajc-e = që ka shumë rrënjë (pemë).
 Rraj/ë-a = shteg nëpër borë; rrahe, rrehe.
 Rrajz/ë/a = glistër, krimb shiu.
 Rrallësin/ë/a = vend ose arë me bimësi të rrallë; pyll i rrallë; rrallishtë.

Rrallishtë = korije e rrallë.
 Rranic/ë-a = rrunicë = pjesë e mirë e diçkaje (bukë, djath, kullotë, etj.).
 Rrapishtë = pyll me rape.
 Rraptic/ë-a = shi vere që bie duke rraptuar (zhurmshëm).
 Rrasallit = rrasallis = ngjesh diçka që është e shkrifët dhe e butë (dheu, duhani) = rrasit.
 Rras/ë/a = pllakë guri; petë e trashë guri; faqe e një shkëmbi të petëzuar.
 Rrasik = petë guri; rrasë; që është si rrasë.
 Rrathtorë-t = shpate shkëmbore me shirita bari.
 Rre/ja/të = rrahe; gjurma që le pas dikush që kalon.
 Rrefkët (i,e) = që ka natyrë të ashpër e të rëndë; zëmërak; i rrëmbyeshëm, i vrrullshëm si: *shi i rrefkët*. *E shikoi a i foli rrefkët = i foli me ashpërsi, me zemërim*.
 Rrefkëtohem = bëhem zemërak, egërsohem, ashpërsohem; acarohet (moti).
 Rreg/ë/a/a/at = tokë e cila ka qënë punuar një herë dhe është prishur më vonë nga shirat e nga gurët që janë sjellë prej ujrave; rrip i ngushtë toke midis shkëmbinjve në një faqe mali.
 Rrej/ë-a = vend ku nisin me rrjedhë ujrë e shiut ndër male.
 Rrek/ë-a = borë në trajtë duqash (topthash) që ngjitet në pantallona.
 Rreknëj = rrëzoj nga lart duke rrokullisur, goromis, sukulloj.
 Rremb/ohet = ndahet në dega, lëshon rremba.
 Rrem/ë/a = vija e ujit të mullirit; vijë uji për të vaditur në arë.
 Rrenim/ë-a = ujë lumi a përroi që vjen me shkulma e shkatërron shumëçka..
 Rreptim-i = shi kalimtar i rreptë, i padëmshëm (jo rrebesh).
 Rreshme/ja = ortek; dragë, frojë, rreshpe, rrotullak.
 Rreshm/ë-a = furri, turr.
 Rreshpaj/ë-a = vend guror i pjerrët e i gërryer prej shirave.
 Rreshp/e/ja = shkëmb i petëzuar që thërmohet lehtë e bëhet leskra-leskra; ortek bore.
 Rreshpor = me rreshpe, si: *shkëmb rreshpor*.
 Rrethak/u = vend i thurur përreth me gardh a diçka tjetër.
 Rreth/e/ja = ograjë e rrethuar me mur të lartë; sorfullak; brezare.
 Rrethe-t = opinga lëkure të thurura me gjalmë nga sipër.
 Rrethoj/ë/a = thurimë që vendoset rreth diçkaje; tepsi ose tavë e rrumbullakët.
 Rrethos/ë/a = vend i rrethuar për të ruajtur barin.
 Rrethujz/ë- a = ishull.
 Rrev/ë-a = short: *shtinë rrevë*.
 Rrezim-i = vend i veshur majë malit, ku e kap rrezja diellore.
 Rrezin/ë/a = vend që e zë dielli për një kohë të gjatë, shullë.
 Rrezit/a/ur = rrez/oi/oi/uar = lëshoj rreze; fig., *shkëlqen, ndrin si rreze*.
 Rrëfanë/a = vjegë, vesh, dorëz; freri i rrushit, bishti ku lidhet kokra e qershisë ose kungulli.
 Rrëfat/et = degëzohet, përdeget.
 Rrëgall/em/a(u) = rrokullisem.
 Rrëgall/ë/a = vend i pjerrët i mbushur me gurë të rënë nga mali; rrëpirë; leranë; luginë e ngushtë plot me gurë (rrëgallë e thellë).
 Rrëgallin/ë/a = vend rrëgallë.
 Rrëkot/ë/a = mëshere (rrotull djathi); diçka e mbledhur si rrotull; vilar (*e mblodhi rrogazin rrëkotë*).
 Rrëmbaj-këmbaj = me rrëmbim; pa kujdes; shkel e shko.
 Rrëmbush/a = mbush plot e përplot.
 Rrëmbujthj/e/a = pjesa e fundit e mbetur nga bimët që korren a priten ose nga diçka tjetër; mbeturinë pa vlerë.
 Rrëmejtë (i, e) = që është thikë i pjerrët; që zbret thikë teposhtë.
 Rrëmet/i = rrymë uji e rrëmbyer; vërshim uji; (*shi me rrëmet*).

Rrëmiq/e/ja = rrëmor/e/ja = vend thikë në faqe të malit ku shkasin gurët e dheu; shkëmb thikë; shumicë gurësh që sjellin përrejtë malorë me vehte ose që shkasin nga lart; vend i mbushur me gurë të tillë; dhé i shkarë dhe i thërmuar.
 Rrëmor/e-ja = ujë që lëshohet me turr duke gërryer kah kalon; vijat e gërryerjet që lë pas ky ujë.
 Rrëngj/en/eu/yer = lëshon rreze të ndritëshme; shkëlqen, ndrin; shkrepëtin.
 Rrënim/ë/a = ujët e lumit a të përroit që vjen me shkull e rrëmben e prish çdo gjë që gjen përpara; gurë etj, që sjell lumi a përroi kur bie shumë shi.
 Rrënjull/ë-a = shpellë e vogël në shkëmb.
 Rrëshen = luzmon.
 Rrëshim-i = luzmimi, luzmë.
 Rrëshgatë = dhera që bien ujrart gjatë përmytjeve, aluvione.
 Rrëshqitë = shpat me borë ku rrëshqasin fëmijët, vend ku të rrëshqasin këmbët.
 Rrëshqitëz = vend me akull a shpat me baltë ku rrëshqitet, shkazmë.
 Rrënok/u = copë toke me bimësi të dendur në mes të kënetës; grumbull kashturinash në kënetë; bëz (breg a kodër e vogël rëre buzë detit; plis i madh dheu).
 Rrënor/eja = tokë e braktisur që nuk prodhon më; vend i shkretë.
 Rrënjisht/ë/a = cung a kërcu i nxjerrë nga toka me gjithë rrënjë; vend me rrënjë drurësh a cungje të mbetura; rrëzë, këmbë mali a kodre.
 Rrëpirë/a = faqe mali a kodre shumë e pjerrët, vend shumë i pjerrët; vend i gërryer a i thelluar nga një rreke, nga një përrua; shi i shkurtër që bie me rrëmbim; rreke shiu; vijë uji nga shiu.
 Rrëshkat/ë/a = tokë që ka rrëshkitur nga shirat; shkarëzimë.
 Rrëshqit/ë/a = shkarëzimë, shkazmë; lug i pjerrët i lëmuar, i ndërtuar për të lëshuar teposhtë drurë a diçka tjetër.
 Rrëvizg/ë/a = plasë e lëkurës së pjeprit.
 Rrëza/ll/lli/je/jet = rrënja e një bime me gjithë kallinj e degë; në shumës: mbeturina që lë lumi në zall mbas vërshimit; fundërrina.
 Rrëzim/ë/a = vend shumë i pjerrët; humnerë, shembëtitirë.
 Rrëzisht/ë/a = rrëzë e vogël shkëmbi.
 Rrëzit/a/ur = e shtyj e rras dikë a diçka në rrëzë të diçkaje; e rras në një skutë.
 Rrëzitem = mblidhem, shtrëngohem në rrëzë të diçkaje; strukem në një rrëzë a në një skutë.
 Rrëzom/ë/a = vend që shtrihet në rrëzë të një mali (fshatrat e rrëzomës), rrëzë; humnerë, shëmbëtitirë.
 Rrib/ë/a = vrrull i fortë i erës, erë.
 Rrim/e/ja = krimb shiu, glistër.
 Rripaq/e/ja = tokë gurishtë në një rripë.
 Rrip/ë/a = shpat shumë i pjerrët në faqen e një mali ose të një kodre, i ndarë anash nga vija të gërryera thellë; rrëpirë; shumë i pjerrët.
 Rripësir/ë/a = rripëtitir/ë/a = vend rripë a me shumë rripa.
 Rripin/ë/a = rrip toke.
 Rriponj/ë/a = rrip i ngushtë e i hollë i prerë nga diçka; rrip i ngushtë e i gjatë toke ose are.
 Rripovin/ë/a = shkëmb i butë, i ndarë në shtresa që shkërmoqet lehtë; grill.
 Rrisk/ë/a = + rrasë guri, pllakë e hollë guri; rriskull = rriskë e vogël.
 Rritkun/ë-a = shi i hollë e i shkurtër vere, rigtinë, rogël, vesallëk.
 Rrjedhí/a/të = uji që rrjedh nga mali pas shiu ose pas shkrirjes së dëborës.
 Rrjel/ë-a = vijë e hollë uji që lëviz ngadalë.
 Rrjep/ë/a = vend i zhveshur, pa bimësi; vend i rrjepur në lëkurë a në sipërfaqen e diçkaje.
 Rroç/i/a/at = pëllumb i bardhë pa kaçul; fëmijë i vogël plot shëndet, kolopuç.
 Rrodhë = plot e përplot: *mollët këtë vit janë rrodhë*.
 Rrok/e= i papjekur (frut); i pazier a i papjekur për mishin.
 Rrokaqiell = gradaçiel.
 Rrok/ë/a = vijë e përdredhur (spirale); shkallë spirale; mandall (reze për mbylljen e derës).

Rrokm/e/ja = filiç (rahësi i tundësit (mti, tpi) të qumështit).
 Rrokopujë = duke u rrokullisur teposhtë; kokëposhtë, rrokullimthi; fig., *në pështjellim të madh, në rrëmujë; mbrapsht*.
 Romak-u = gur disi i madh, rumbullak; rrosh.
 Rroshatak-u = rrafshinë ose kullotë e rumbullakët e rrethuar me pyll; rogë.
 Rrosh/e/ja = dhi me vathë, rezhdake, vathore.
 Rroshponj/ë/a = gropë e gërryer nga rrjedha e lumit anës bregut.
 Rozg/ë/a = degë e thatë a drizë që përdoret për zjarr; mbeturina drunore që sjell lumi; vend me shkurre, ferra e drurë të thatë.
 Rrshen-i = ujë i shtuar që lëshohet prej përrenjve të thatë kur bie shi.
 Rrshim-i = rreptim shiu.
 Rrshin/ë-a = shpat që rrëshqet.
 Rudhisht/ë/a = vend i thyer me shumë gropa e rripa.
 Rúfull/a/at = gjir = vorbull uji = shtjellë (edhe në kuptimin fig.).
 Rrugín/ë-a = shteg a udhë e hollë jo e ndërtuar (jo e rrahur) por e hapur nga kalimi i përkohëshëm i njerëzve në një arë.
 Rrugnaj/ë/a = rrugë e gjërë këmbësorësh; rrugët në një fshat, në oborin e një ndërtese, etj.
 Rúgës/i = përçor, oqiç, ballëtor.
 Rrugëtar = udhëtar.
 Rrugëtoj = udhëtoj.
 Rrugëz/a = rrugicë = rruginë.
 Rrugohem = nisem për rrugë, mbudhem; rrugëtoj, udhëtoj.
 Rrugó/oj/ova/uar = udhëtoj; mbudh.
 Rrukë = që i është hequr lëvozhga e gjelbër, pa shark (*arrë rrukë*); i zhveshur, i rrafshët (*vend rrukë; e bëj rrukë = e rrafshoj*).
 Rrumbullakthi = në trajtë të rumbullakët, duke ja lëmuar cepat e këndet.
 Rrumitem = lodhem, këputem.
 Rrung = me të ardhë diçka në shteg, me të dalë mbarë: *më erdhi rrung dhe nuk e fala; mbas një sorollatje të gjatë duke ndjekur lepurin, ai doli rung në lirishtë*.
 Rrunqaj/ë/a = ortek dëbore; turmë e madhe njerzish a kafshësh që lëvizin me rrëmbim; rrëmujë, pështjellim; dru i rrëzuar dhe i kalbur a i tharë; drurë e gurë e dhë që shëmben nga mali a që sjell lumi me vehte; përrua i rrëmbyer që sjell me vehte kërcunj e gurë; tokë gurishte që nuk jep prodhim; largim në rrëmujë, në pështjellim, si: *ikën rrunqajë*.
 Rrus/em/a/ur = zbres, varem poshtë (*u rrusën nga mali*).
 Rrushkull = shkurre e viseve mesdhetare, me kërcell të degëzuar e me lëng të hidhur, me gjethe të vogla përherë të gjelbërta e me majë si gjemb, që bën kokra të kuqe, të cilat piqen në dimër e haen; therpelë, (*ha si dhinë në rrushkull = ha si i zijosur; u bë rrushkull = u varfërua shumë*).
 Rrushkullí/a = hidhësirë; hidhërim; fjalë e ndyrë, lapërdhi.
 Rruva/n/ni = rrëfanë, (*rruvani i rrushit*).
 Rruvij/ë/a = vijë e hequr mbi një sipërfaqe; vizë pak e thelluar që hiqet në gur a në një dërrasë.
 Rryesh/ëm (i) me (e) = i ashpër, i thepisur.
 Rryentas = rryeshëm = me vështirësi, nëpër vështirësi (*punon/lëviz/ecën rryentas/rryeshëm*).

S

Sag/ë/a = tavë me vrima për të pjekur gështenjat.
 Saj/ë-a = rrëshqitëse në borë.
 Sakavic/ë/a = sopatë e vogël me bisht të gjatë e me mykë të kthyer për të kapur e ulur degët e pemëve.
 Sak/ë/a = sakic/ë/a = sopatë e vogël e me bisht të shkurtër, naxhake, latore.

Salamandër = pikëlore.

Sámtë (i,e) = i pashijshëm (për gatesat, si gjellë e samtë); fig., *i shplarë, i pakëndëshëm, si: realitet i samtë.*

Sanatadita = 21 Marsi e 23 Shtatori.

Sanë = bar i korrur e i tharë.

Saóra = në atë çast, menjëherë, si: *erdhi saora.*

Sáza = sasi shumë e vogël, fare pak; grimëherë; faftë (çast, moment).

Sazinë = vend i lagët që teret (thahet) vështirë.

Sekedímni = gjithë dimrin e plotë, gjatë gjithë dimrit: *sakedimni në Tiranë nuk ra borë.*

Sekullar-i = majë e lartë kodre me bar.

Skarratin/ë-a = kohë e vranët e me gjëmime = skorratinë.

Skep-i = sqep, qokth; thep guri, shkrep.

Skërk/ë-a = buzëripë, bokërimë.

Skllop-i = baltë.

Skllot/ë-a = shqot/ë-a, borë e përzier me ujë e baltë; cakërri, fërcalle; shi i përzier me borë; borë gjysmë e shkrirë; lashti, llohë, shushlek.

Skofet-i = gropë, gropishtë.

Skofjar-e = delikat, që sillet mirë, njerzor.

Skofnar-e = sqimatar, që mbahet me shije.

Skofish/ëm (i,e) = i përkorë, i lehtë, delikat.

Skurrjel = curril; cerrep, cërka, cërkatë, cërril, cërrkaç, cërrkamë, cërrlek, crrel, currel, currin, çuçon, çurrel, çurrig, çutër, gorril, gurrjel, pip; kur skurrjeli hidhet si shat(d)ërvan = porrçez.

Selishtë = kopsht ose arë e vogël pranë shtëpisë.

Selit = selis = mbjell e i shërbej një bime që ta rris; fig., *rrit me kujdes të veranc që të zhvillohet sa më mirë (e seliti nipin).*

Sëmbár/a/ur = e vë në rrugë të mbarë dikë.

Sinor = kufi që ndan një arë nga një tjetër ose tokat e një fshati nga një fshat tjetër; kufi.

Skërk/ë/a = shkëmb i thepisur e me maja të copëtuara; vend në mal me shkëmbej të tillë; tokë e thatë e tërë gurë në mal; gropë a guvë mes shkëmbejve të thepisur.

Skllaçit, skllaçis = bëj me baltë.

Skllop/i = skllot/ë-a = baltë e përzier me borë të shkrirë; baltë, llucë.

Skofí/a = sjellje e butë dhe e hijshme; qëndrim i sjellshëm e i kujdesshëm me të tjerët (courtesy).

Skofiar/e/ë/ët = ai që sillet me skofi.

Skrimtë (i,e) = i përkorë, i përmbajtur.

Skripsí/a/at = fije të holla bari që dalin në vende me ujë.

Skurrjel-i = currili, cerrepi, cërka.

Smag/u/ë/ët = kunj druri a grepç fare i vogël për të kapur a për të mbërthyer diçka; ngolë a thumb i vogël; thumbi i bletës ose grerëzës.

Smajk-u = cipa që vënë disa ushqime të lëngëta prej vapës.

Sohí/a/të = sohisht/ë/a/at = vend që nuk e zë dielli (zakonisht në mal); hijesirë (*bora e sohishtave*).

Sorfullak = vend për të ndenjur e soditur, holl.

Spequt/ë-a = strehë nën gur, gjamën.

Spërk/ë/a/at = stërkalë, stërkitë.

Spik = spikth, shirit, kordon, fill i trashë prej leshi të dredhur, gjalmë leshi a mëndafshi.

Spilt/ë-a = tepja, maja e kodrës.

Spirrak-u = gur me majë të mprehtë.

Spreth-i = streh/ë-a.

Stan = vend me vathë e me kasolle për bagëtinë, barinjte e bulmetin.

Stanar = barí i stanit, bjeshkatar; ai që punon bulmetin në stan.

Starf-i = presa e ujit, vendi ku ndahet ujët në vijën e madhe të katundit.

Ster/ë-a = depo e gërmuar në tokë për të mbledhur e ruajtur ujin e shiut.
 Stërkal/ë/a = pikla të lëngëta që shpërndahen me vrrull; stërkitë; spërkë; shkëndija (zjarri).
 Stërpik/u = filiz që lëshon druri afër rrënjës; fig., *pasardhës i një familje*.
 Stihí/a/të = dukuri e vullshme dhe e papërmbajtur që zhvillohet vetiu dhe që nuk mund të drejtohet sipas dëshirës (*stihitë e natyrës*); vrrull i brëndëshëm, forcë shpirtërore e papërmbajtur (*stihia e postit*); fig., *njeri a diçka tjetër me përmasa tejet të mëdha e të parregullta; + figurë e prrallave popullore*.
 Stjegull/a = buza e strehës së shtëpisë, ku bien pikat e shiut; çikë.
 Stom/i/e/et = rrip toke që ngrihet për së gjati në një vend të rrafshhtë; breg dheu, bregore; ledh që ndan arat; rrip toke në mes të një lumi a kënete.
 Strall = gurzjarr.
 Streç-i = shtresë e kristaltë varur në degë, tela, vetulla, mustaqe, e krijuar prej borës, shiut a mjegullës që ngrin; fnazë, ellí, kaçerr; krahnezë, kranëz, stezë, shtrezë.
 Strom/ë/a = shtrojë, (turqisht dyshek); stromat = shtresat e mbulesat.
 Strug/ë/a = mbulesë e leshtë që hidhet krahëve si rrobë ose që përdoret si shtrojë; brucë e bardhë e barinjve në disa krahina të Veriut të Shqipërisë; vend me ujë e me shkurre moçalore; vend i ulët si gropë që mban ujë edhe gjatë verës; vijë uji.
 Strujnoj = vjedh gjëra të vogla, bracnoj.
 Struk/ë/a = vend i mënjeluar, rrëzë ku mund të futemi për t'u mbrojtur; strehë.
 Strum/i/a = gropë e thellë në lumë; pellg i thellë ku bie uji me forcë; vijë që bëhet në një vend moçalor për të kulluar ujjat.
 Suferin/ë/a = erë e vullshme dhe e ftohtë, shpesh me dëborë e me shi të hollë.
 Sukalé/ja/të = tokë rrëzë malit.
 Sukalen-i = breg, sukale.
 Suk/ë/a = vend i ngritur si gungë në një fushë, kodër e ulët; breg i dalë në shpatin e një mali, bokë.
 Sukor/eja = kodër e rrumbullakët, çukë e rrumbullakët.
 Suval/ë/a/ët = valë e fuqishme, dallgë e madhe.
 Sylynjar/i = lëfyti i kroit.
 Syth/a/ur = si folje: bëj dhe shtrëngo një lak; si emër: sejcili lak i vogël që bën filli në rreshtin e diçkaje të thurur me shtiza; nyjë ku bën lak filli në çdo vrimë të rretës, lakth; rreth i vogël që bëhet duke e lakuar litarin për ta shtrënguar, laku i litarit; sejcila nga vrimat e rripit që shërbejnë për të futur kunjën e togzës (*lroi/shtrëngoi dy sythe të rripit*); sejcila nga vrimat e këpucës ku kalon gjalmi për të shtrënguar a lidhur këpucën pas këmbës.
 Syuj-i = burim në liqen: syuji i Viroit.

Sh

Shajní/a/të = vegim.
 Shajtim/i = të fikët, shitim (ndëshkim i zanave për atë që u prishte vallen a tryezën), shitë; diçka shumë e hidhur, helm (edhe fig.).
 Shakullin/ë/a = erë e fortë që vjen rrotull e ngre pluhur, borë, etj.; shtjellë, dredhë, vorbull.
 Shalar/e/ja = dru me një bigë të madhe që vihet në anë të një gardhi për të kaluar matanë, kapërçell, shalor.
 Shalator = dru me një gremçe për të varur diçka (trasta, etj.).
 Shalësin/ë/a = tokë jo pjellore.
 Sham/e-ja = tokë që rrëshqet; rrëshembje.
 Sharrak/u = pyll i vogël e i veçuar, zakonisht në mes të arave; shpeshinë.
 Sharrúemj/e-a = fundosje e papritur në borë: *nuk ecet prej të sharruemit, është e butë bora; çfarë të sharrúemje, deri në fyt!*

Shatorr/e = dendëshor (me degë e gjethe të dendura): *vidh, lis shatorr*.
 Shatorre = tendë.
 She/u/ra/rat = përrua që nuk shterr gjatë gjithë vitit.
 Shej/ë-a = përrua malor që mbushet me ujrat e shirave ose kur dejet bora.
 Shejni-a = simptomë-a.
 Shembëtir/ë-a = vend që shembet, vend i shembur, humbellë, rrëzim, lyshtër.
 Shem/ë/a = luzmë; zgjua me luzma; fig., *mizëri, si: shemë njerëzish*.
 Shemb/ën-na = vend i shembur; vend ku shembet dhé.
 Shermend/i/e/et = degë hardhije që e kijnë ose e presin për ta mbjellë.
 Sheshor/eja = shesh i vogël.
 Sheshtinë = vend i sheshtë; shesh i vogël.
 Shëmit/ër/ri = Nëntor-i.
 Shënëndre = Dhjetor-i.
 Shiez/ë-a = përrockë ose burim që del në kohë shirash a kur shkrihet bora.
 Shijakë/a = vend i ngushtë i dalë si raft në shkëmb (shtreth kur këmba vendoset lirshëm e lëpizë kur është shumë e ngushtë).
 Shijavin/ë-a = mot i lagët me shi, shijanë.
 Shinajë = tërësi shirash, shira që nuk pushojnë.
 Shinór-i = qafë e vogël midis dy majash; shkekë (hapje, hapsirë) mali.
 Shinor = i shiut, prej shiut: *ujra shinore*.
 Shirit = rrip.
 Shirok/u = erë e fortë e ngrohtë dhe e lagësht që fryn nga jugu ose nga juglindja dhe sjell zakonisht mot me shira; erë shiu.
 Shit/ë/a = ndëshkimi që i bënin zanat atij që u prishte pa dashur vallen ose tryezën (sipas besimeve popullore); shitim, shitimi.
 Shitohem = ngurosem nga këmbët e duart dhe humb gojën i magjepsur a i ndëshkuar nga orët ose zanat; shuplakem.
 Shivur-i = tokë e përbërë nga rrasa të imta, të buta, të renditura gjithë në një krah.
 Shkadhi/t/s = krasit një pemë a një dru; pastroj nga shkurret vendin nën kurorën e një peme.
 Shkal-i = rrebesh-i.
 Shkalem = mbetem i shituar, shuplakem; fig., *prishem nga mentë, lajthit*.
 Shkam-i = ndënjëse e vogël druri, zakonisht me tre këmbë e pa shpinore.
 Shkaprrut/ë-a = pyll me drurë të vegjël.
 Shkarëzím/ë/a = vend i rrëpirët ku rrëshqet dheu, shkazmë, rrëshqitë; vend i pjerrët a i lëmuar ku rrëshqasin fëmijët, rrokullimë.
 Shkarp = pingul, si i prerë me thikë: *faqja Jugore e malit të Arapit ngrihet shkarp mbi Theth*.
 Shkath/a/ur = shpij diçka që është mpirë (këmbët pas ndënjes, duart e ngrira në zjarr, etj.); e bëj më të gjallë e më të zhdërvjellët; e zhvilloj dikë, shkathtësoj.
 Shkazm/ë/a/at = rrëshqitë, shkarëzimë.
 Shkath-i = burim i vogël buzë shkëmbit.
 Shkek/ë-a = (po ashtu: shqek, shqekë) e çarë si xhep në tirq, gunë, etj.; + qafë e vogël mali.
 Shkelëz/a/at = këmbëz shkalle, shkallare; shkallinë.
 Shkesë = rreshje të forta e të befasishme që kalojnë shpejt.
 Shkëlboz/ë/a = lëkura e drurit.
 Shkëlfit/a/at = lëkura e drurit; fig., *ngacmoj, si: mos i shkëlfit këto punë*.
 Shkëmb = gur i madh e i fortë, karpë, shkrep, gërnxh, rragam, harc, qetë, curr.
 Shkëmbisht/ë/a/at = vend me shkëmbinj e me gurë; tokë shkëmbore.
 Shkërpic/ë/a/at = shkëndijë, xixë; fig., *arsye e kotë, si: mos qit shkërpica!*.
 Shkimnaj/ë-a = terr i thellë, terrovinë.
 Shkiz/ëm-ma = fije druri: *i hyri Mirit një shkizëm në gisht*.
 Shklluq/a/ur = pi njëherësh gjithë pijen që ka gota.

Shkojës/a = pore, vrimë e lëkurës.
 Shkokëlohem = shkoqet vetiu; fig., *gajasem së qeshuri*.
 Shkoq-i = shesh, log, vend i hapur.
 Shkors/ë/a = (= cerg/ë/a = qilim); trinë thuprash e lyer me baltë që vihej mbi vatër për të ruajtur trarët nga shkëndijat.
 Shkrel/ë-a = tokë e thatë ranore që për të mbjellat kërkon vaditje të shpeshtë.
 Shkorret/i/e/et = vend me shkurre e driza, shkurre, shkurrishtë, shkurnajë.
 Shkrep/i = shkëmb me majë të mprehtë; majë shkëmbore e zhveshur, krep.
 Shkrepin/ë-a = vend me gurë e shkrep.
 Shkres/ë-a = lak për të zënë shpeshë të egra.
 Shkryem/e-ja = orgji.
 Shkrrith = gërryen tokën me thonj (qeni).
 Shkuftë (i,e) = i rrallë, jo i ngjeshur, i çrrastë: *lakër e skuftë*.
 Shkujk/ë-a = rojë që vrojton prej një lartësie.
 Shkul-i = hurbë: *e piva gotën e ujit me dy shkula*; shkuma e fluskat prej përplasjes së ujit; majë vale.
 Shkulk/ë/a = vala e ujit që zjen (*po zjen uji me shkulka*; shkulavalë), shkulum i vogël.
 Shkullohem/et = kthjellohet, kullohet (për ujën e qiellin); lahem e pastrohem.
 Shkull/oj/ova/uar = e zbraz deri në pikën e fundit, e pi krejt, e shkënd, e shpik: *e shkuloi gotën*.
 Shkumor/e/ja = verë ose pije tjetër e gazuar që shkumon kur e hedhim në gotë.
 Shkundadim/ër/ri = tri ditë të ftohta në muajin Prill (si rregull 11-13) që sipas besimeve popullore, janë shfaqja e fundit e forcës së dimrit; plakat.
 Shkurtj/e/a = ditët e çastet e fundit të jetës, fundi, vdekja.
 Shkurtor/eja = rruga që pret shkurt.
 Shkurror = që është me shkurre.
 Shlapk/ë-a = flluskë sapuni, uji, shiu.
 Shlis = shkon mbarë: *na shlisi ngitja në majën e Diellit*.
 Shlis/em = shtrihem sa gjatë e gjërë: *tek u ktheva nga ekskursioni u shlisa në shtrojen që gjeta*.
 Shllak = pjesa e krahut nga bërryli tek supi.
 Shllat-i = tokë e pjerrët.
 Shllig/ë-a = nëpërkë.
 Shllinor/e-ja = tokë e kripur afër detit.
 Shmang/em = ndaloj për nevoja vetijake gjatë një udhëtimi në natyrë: *ecni ju se dua të shmangem paksa*.
 Shmenjem = mbingopem së ngrëni, së qari, së qeshuri.
 Shnakot = kuturu, në tym, nëpër tym: *mjegulla e dendur na bëri të ecnim shnakot deri sa e kuptuam se ishim buzë një honi*.
 Shndriz/ë/a = send që shndrit; gurë i çmuar.
 Shnoll/ë-a = kapse, karficë.
 Shnordh/em = ftohëm, heq dorë: *pritja e zgjatur për mot më të mirë na shnordhi nga synimi*.
 Shok/ë-a = brez leshi i gjërë, i gjatë e shumëngjyrësh me të cilin mbështillet mesi; dizgë djepi.
 Shokëz-a = bordurë; brez a shokë e vogël.
 Shom-i = rakia e fundit gjatë zjerjes.
 Short-i = pip, fidan pemë i mbjellë apo që do mbillet.
 Shot/ë-a = brrokë uji.
 Shpalc/ë-a = leckë a send për të larë enët apo për të fërkuar trupin.
 Shpatin/ë/a = shpat i vogël; kodër e vogël.
 Shpatuk/e = i shtypur nga dy anët; rrasik = shpatullak, si: *gur shpatullak*.
 Shpell/ë-a = zgavër, zgafellë, hep, guvë, gërrellë, gufoskë.
 Shpellin/ë/a = shpellë e vogël; vend me shpella.
 Shpeshtak/u = pyll me drurë të shpeshtë.

Shpërbenës = dëshmitar i rremë.
 Shpërthiq = shtrydh fort.
 Shpërvar/em/a (u)/ur = kacavarem (shpërvarem nëpër druj/ shkëmbej); nxjerr tupin jashtë dhe përkulem, varem; ulem poshtë, zbres tatëpjetë = zdirgjem.
 Shpif/ë/a = dordolec, gogol.
 Shplo/j-va = heq një shtresë: *shploj çatinë (nga bora), shploj tendën nga bora.*
 Shpluetin/ë-a = vend i zhveshur, pa bimësi.
 Shpni-a = punë shtëpie, punët e zonjës së shtëpisë.
 Shpofk/ë-a = vrimë.
 Shpore/ja = vijë ujitje në arë a kullotë.
 Shprish/ë/a = buka që hahet herët në mëngjes, zakonisht në verë; *sa për shprishhtë = fare pak, sa për të mos qënë esëll.*
 Shputa = kamçe pa qafa.
 Shqim-i = prag i derës.
 Shqimët (i,e) = tërësor, i plotë, total.
 Shqot/ë/a = shi me borë bashkë; shi me erë, zakonisht i shkurtër; shtërngatë, stuhi; valë shiu e rëmbyer.
 Shquetin/ë-a = vend i mbrojtur, strehë.
 Shquhetohem = zë një skajim mbrojtës, mbrohëm diku, fshihem diku.
 Shqut = përskaaj, pranë e pa e prekur: *shqiponja fluturoi shqut me flamurin e kampit tonë.*
 Shqyr/e-a = udhë shumë e ngushtë dhish.
 Shregull/a = litar lesi për të ngarkuar djepin në shpinë.
 Shtalbni-a = adoleshenca.
 Shteg- = vend i ngushtë kalimi, udhishtë, udhëz, (kapërcyell = shteg i ngushtë; rre = shteg i ngushtë; rim = vendkalim në arën e punuar; ravë).
 Shtegtar = rrugëtar, udhëtar me një synim të caktuar, njeri që është në udhë e sipër.
 Shtëllunget = ngrihet lart në trajtë shtëllunge.
 Shtërgat-i = borë e rrallë dhe në formë kokrizash; shtrat bore, breshnizë bore.
 Shtill-i = hapësirë; vëllim, vend.
 Shtir/a/ur = kaloj lumin a një rrjedhë uji, dal matanë; fig., *kapërcej një pengesë a vështirësi.*
 Shtjek/ë/a = + lak; syth; mënyrë lidhje e një filli a litari që zgjidhet lehtë duke tërhequr njëren anë, vjegëz; xhep pa astar për tirqet; vrima ku mbërthehet kopsa; ilik; lak; syth; shtegu që formohet në anë të ballit kur fillojnë të bien flokët; bishti i syrit nga ana e hundës; cepi i gojës (*qeshi shtjekë më shtjekë*); shteg a vijë që hapet për të çuar ujin diku (*një shtjekë ujë = aq ujë sa kalon në një vijë të tillë*).
 Shtjell/ë/a = rrymë e rrëmbyeshme uji ose erë e fortë që sillet rrotull me shpejtësi në trajtë hinke; vorbull.
 Shtjerr = bëj që një veshje të hahet nga përdorimi deri në grisje.
 Shtoj = fushë.
 Shtol-i = damar i vogël e i nëndheshëm uji (disa shtola formojnë një shtonë).
 Shton/ë/a = kanal, lug; vijë uji nën dhe; vend ku buron e mblidhet ujë; kanal ujrash të zeza.
 Shtrator/e/ja = shtrat pjergulle; pjergull.
 Shtrenjt-i = gërbellë.
 Shtresin/ë/a = shtresa e poshtëme e një shtëpie të re, e një rruge, etj., që shtrohet me gurë.
 Shtrez/ë-a = copë akulli që sjell lumi.
 Shtreth/i/a/at = kasolle stani në mal e bërë me degë; tendë; gjithashtu: raft, vend për të vendosur këmbën në shkëmb.
 Shtrez/ë/a = krahnezë; brymë e ngrirë.
 Shtërngatë = furtunë.
 Shtërngëz/ë-a = drunjë që mbajnë degët e mbushura të pemëve.
 Shtringëllon = zhurma kërcitëse që bën bora kur ecim mbi te: *bora shtringëllonte tek marshonim.*

Shtrojer/ë/a = vend që nuk e zë era e zakonisht me diell.
 Shtrojler-i = vend i fushtë, log, shkoq, ledinë, rrafsh.
 Shtrojs/ë-a = shtroje ose gjysëm kamçe për të mbajtur këmbën ngrohtë e kamçen të thatë.
 Shtruar/a(e)/ = shtresat për të fjetur; shtrojë; (*u ngrit nga të shtruarat*); të shtruarat = turshitë.
 Shtrun-i = bar, fier a kashtë në gjendje të thatë që shtrohen nën teshat ku flenë njerzit.
 Shtrung-u = cilido prej dy gurëve që vendosen në anë të derës së shtrungës për tu ulur mjelsi.
 Shtrung/ë/a = shtegu ku dalin një nga një dhentë nga vatha kur milen; shtegu që hapet për të kthyer ujin në arë.
 Shtuf/i = gur i lehtë i thërmueshëm; shkëmb ranor e i thërmueshëm; shtufak = shtufor, gocan.
 Shtufisht/ë/a = tokë me gurë shtufi; vend shtuf; tokë e varfër; shtufinë.
 Shtuher/ë-a = vend ku nuk rreh era.
 Shturqnohem = ndërroj fenë duke kaluar nga besimi musliman në një tjetër.
 Shtyr = kapërcej: *rryma e ujit ishte tejet e fortë e vendi kudo i thellë, kështu nuk mundëm të shtyrim lumin.*
 Shujtar = ai që e mer bukën me vehte tek lë shtëpinë a bazën e nisjes.
 Shujt/ë/a = ushqim; gjellë (*shujta e mëngjesit, bëri gati shujtën*); shujt/oj/ova = ushqej.
 Shujtohem = ushqehem.
 Shuk = kulmi i të ftohtit: *ishte 18 Janar, shuku i atij dimri.*
 Shulak = qingj mashkull motak; rrunzak.
 Shulm/ë (i)/e (e) = i sheshtë, i drejtë, pa të përpjeta e të tatëpjeta (*rrugë e shulme*).
 Shulor/e/ja = udhë që shkon shul në një faqe mali a kodre; tërthore.
 Shullë/ri = vend që e zë mirë dielli e që nuk e reh era.
 Shungullim/ë/a = gjësim i fortë, ushtimë e thellë, uturimë.
 Shuprak-u = pluskë bore, shtresë e hollë bore.
 Shur-i = zhavor-i.
 Shurishtë = zallishtë.
 Shurkam/ë/a = zhurmë a potere e madhe (*shurkama e ujvarës*).
 Shu(r)/ë-a = lug i ngushtë në shpate të pjerrëta malesh, nëpër të cilin rrëzohen rreshme e kullojnë ujra bore.
 Shurqel-i = ujvar/ë-a.
 Shurukon = zhurmon.
 Shushav/ë/a = toka djere, shpate, brinja të shpërndara andej-kënde; vise të largëta.
 Shushlek-u = borë e përzier me shi.
 Shushlis = shprush zjarrin.
 Shushmenk/ë-a = gëzhojë fasulesh, kikiriku, etj.
 Shut/ër-ra = thurrje prej kashte që u bëhen disa enëve prej qelqi.
 Shutroj = sharroj, ngec keq në baltë ose borë; fundosem në to.
 Shym/ë-a = prag i derës, shqim.
 Shyt = me majë të prerë e të rrafshhtë (*mal me majë shytë*).

T

Taktruk/e-ja = thuk druri për të shtypur hurdha.
 Tallabak/u = lymi që mbetet nëpër ara pas vërshimit të lumit e që me kohë thahet e ngjishet shumë.
 Tallanxh/ë-a = grrumbull grash e burrash që shkojnë për rrugë.
 Tallisht/ë-a = tallutë = arë misri e korrrur.
 Tam/ë/a = vendi ku buron një rrjedhë uji.
 Tando/hem = mundohem, lodhem, prish qetësinë time.
 Tan/ë-a = prita që i bëhet lumit a përroit për ta kthyer ujët në një kanal për mulli.

Tangall/ë/a = pyll i madh ku nuk është vënë sopatë.
 Taplot/ë/a = lopatë; shputa e këmbës.
 Tapuk = taka e këpucës.
 Taralel-i = vend përkundruall një vendi tjetër më të lartë.
 Tarit = fryn lehtë.
 Tarkaç/e/ja = trastë prej lëkure për të mbartur barinj të ushqimin e tyre.
 Tartakut/i = + të ftohtë i madh që na hyn e na jep të dridhura.
 Tarrac/ë/a = + brezare.
 Tbanisht/ë-a = tel/ë-a = vendi ku ngrihen stanet e vathat në bjeshkë; bunj, thanishtë, stanishtë.
 Tehemteh = skaj më skaj, anë për anë, gjithkah.
 Tejanë = ana e përtejme, matanë.
 Tejbart = shpie diçka nga një vend në një tjetër.
 Tejbartës = transportues.
 Tejbartje = transportim.
 Tejmal/i = temal = prapa malit (*pyjet e tejmalit/temalit*).
 Tejmalas = prapamalas, banor tejmalit, temalas.
 Tejpigjet = pigjet më shumë nga sa duhet (fruti).
 Tejz/ë/a = dell i hollë (kordë); gjalmë e hollë prej leshi.
 Tekandëj = matanë; atje tej; më pas, më tutje (*që atë ditë e tekandej*).
 Tekëndej = këtu afër; këtej, kësaj ane; këtej e tutje.
 Teposht/ë/a = tatëpjetë; poshtë.
 Terak/e = i thatë e pa lagështi, pa ujë (*tokë terake*).
 Teri/k/ku/qe/qet = terë, sterc; vend i thatë; terinë; fllad (*fryn teriku*).
 Terisht/ë-a = tokë pa ujë; terinë, terik.
 Terl/ë/a/at = vend me shumë tëbana (stane) në mal.
 Term/ë/e = thatë (*vend i termë*).
 Tershër-i = vend midis barëve të bërrorës (turqisht bërrorit) ku mundet të vihet një ngarkesë shtesë.
 Tervës/ë-a = tryezë buke (tervestar-i = ai që rri në tryezë të bukës).
 Terrin/ë/a = errësirë (*terrina mesjetare*).
 Teujas-i = ai që banon matanë lumit a liqenit.
 Tëbam-i-a = frut i një peme frutore, pemël.
 Tëbanë/a/a/at = bun; stan; vathë bagëtishë, kasolle.
 Të/hjek-hoqa = bie në peshë kur kam peshë të tepërt: *kam tëhjekur dy kilogram*.
 Tëhu = këndej, në këtë anë.
 Tëlána-t = ujra të papastëra nga larja e enëve.
 Tërcall = thyej një teh, bëj me shkallë: *tek thyeja akullin që vishte shkëmbin tërcalli tehu i kazmës*.
 Tërkaç/i = trasta e bariut.
 Tërkuzore = teleferik.
 Tërllaçk/ë-a = dru i kalbur.
 Tërmaal = përpjetë; tërmaleja = e përpjeta; (*termaleja ka teposhtën*).
 Tërpasme/ja = e përpjeta që lë pas dikush kur i ngjitet një kodre a një mali.
 Tërsír/ë/a = litar.
 Tërthoj = ndërroj rrugë, ndryshoj drejtim: *tërthova nga e majta*.
 Tërthor = drejtpërdrejt, mespërmas, horizontalisht, jo kiamas.
 Tërthor/eja = rrethina e një qyteti a fshati; rrugë e tërthortë që shkon me dredha drejt një lartësie.
 Tërvit = parvjet.
 Tin/ë/a = lym; baltë.
 Tingting/ë/a = tatëpjetë, teposhtë (*mori tingtingën*).
 Tingthi = duke u hedhur me një këmbë (*kërcente tingëthi*).

Tirand/ë/a = krahoshe, krahëza.
 Tit/ërr-rra = vend i pambrojtur nga dielli, era, etj.
 Tizg/ë/a = rrip leshi që përdoret për të lidhur kallcat (kallc/ë-a = kamçe burrash pa shputë e të gjata deri tek kofshët), flokët, fëmijën në djep.
 Toj/ë/a = + gjalmë me shumë fije të dredhura që përdoret për të lidhur kamçet, opingat, etj.; retër (dredhë e lëkurtë); lidhëse; litar.
 Tokanik = tokë e mirë e pa gurë.
 Tok/ël/la = kokër; toptth dheu aq sa kap dora (*tokël sheqeri*).
 Tokëllim/ë/a = vend pa bimësi, tokë e zhveshur.
 Tokúr/ë/a = istëm; rrip toke midis dy detesh.
 Tonít/a/ur = ujit, lag ngadalë dhe e ngop me ujë; thith e mban lagështi (*tonit muri*).
 Topor/e/ja = sopatë e vogël.
 Torisht/ë/a = vathë.
 Torolákem = rrokullisem; torolak/a/ur = rokullis.
 Tortë = litar i trahë prej lëkure liri që përdoret për të lidhur a tërhequr barrë të rënda.
 Torúa = gjurmë që lë në tokë këmba e njeriut a kafshës; mbresë; gjurmë; shteg i fshehtë (*nuk doli gjahu në torua*); kujdes i veranc a vemendje që tregohet për të kryer një gjë; mëndje.
 Trag/ë/a/ët = vija që lë rrota e qeres në tokë; gjurmë; udhë e ngushtë dhe e vështirë në mal; dhiare; tragë e verbër = udhë që herë shquhet e herë humbet.
 Tragëz/oj/ova/uar = shkoj pas rrugës a pas gjurmës.
 Trahm/ë-a = erë që kanë a lëshojnë ushqimet.
 Trap-i/e/et = vija që hap plori, hulli; vijë e thëllë në tokë; përrua i ngushtë e i thellë; gropë e thellë në tokë ku futin patatet gjatë dimrit; udhë e ngushtë në mal, shteg; dhiare; mjet për të kaluar në ujë.
 Trapí/t-s = eci nëpër trape (në mal në pyll); eci nëpër shtigje a rrugë që shkurotjnë udhën, pres shkurt; bredh poshtë e lart; kërkoi dikë në çdo vend; bëj gjedhen (formën) e një veprë artiskike me baltë, me allçi, me laps, etj.; përvijoj; modeloj.
 Traz/ë/a = lesë druri e mbërthyer mbi tymtajë, mbi të cilën vemë mishin për t'u tharë; thurimë që vihej përmbi zjarr për të pritur shkëndijat.
 Trejt-i = gatime me petë si flia, byreku, etj..
 Trejtoj = gatuaj; pres me háje të mira.
 Trek = fjalë që përdoret për të treguar zhvendosje të sakta: *e mori kupën trek në tavolinë*.
 Treng-u = gur që lëshon tingull (tingëllon) kur e godet.
 Tretdhé/u = vend shumë i largët.
 Trënd = trand = rrëzoi borën nga dega.
 Trij/ë-a = shokë djepi, brez për të lidhur foshnjat në djep.
 Trik-u = zhgun; gunë.
 Trin/ë-a = thurinë me thupra që shërben për të nderë gjëra të ndryshme mbi të; derë e vogël e thurur me thupra që mbyll vathën; shpina e dorës; kurrizi i këmbës.
 Trisk/ë-a = grimcë guri.
 Triv/ë/a = fërkem (gjurmë që lënë zakonisht kafshët e egra në dëborë, baltë, etj).
 Troj-i = shtrat druri.
 Trok/ë/a = truall, dhé; shesh i vogël me dhé të ngjeshur; shumë i thatë, fare pa lagështi.
 Trollisht/ë-a = vend me borë të shtypur me këmbë.
 Trop/i/e/et = bërsi rrushi; rrush i shtypur që lihet për t'u bërë verë.
 Tropol/i/ë/ët = gur i madh që nuk mund ta lëvizësh nga vendi.
 Trungaj/ë/a = shpat mali me trungje të prerë.
 Trúp/e/ja = vijë uji që kalon në mes të oborrit; vijë kulluese në arë.
 Tug/ë/a = temperaturë e lartë, afsh; erë e nxehtë.
 Tubrric/ë-a = grumbulli i theut që bëjnë buburecat ose thneglat.
 Tufan = furtunë, uragan.

Tujg/em-a = lagem e bëhem qullë në ujë.
 Tultin/ë-a = tokë deltinore e bardhë dhe pjellore në vise malore.
 Tumb = i papjekur (*fik tumb*).
 Tumir/em-a = përshtatem në një mjedis të caktuar, mësohem, ambjentohem.
 Tun/i = ana e kundër e presës së thikës, spatës, sqeparit; pala e të mbathurave, xhupit, etj., ku futet llastiku ose një fill.
 Tundull/oj/ova/uar = e tund dhe e lëkund diçka fort disa herë.
 Tusht-i = erë e përzier me borë.
 Tusht/ë-a = fërfëllizë.
 Tutëlohet = bëhet me rrudha, zhubroset; ngatërrohet, koklavitet (flokët, litari).
 Tut/ërr-rra = zgavër lisi.
 Tuturec/ë-a = strehë kapeleje.
 Tvojtetárdhë = duke shkuar e duke u kthyer brënda ditës.
 Tymtaj/ë/a = re tymi e përzier me re e me pluhur; mjegull e dendur; re e hollë.
 Tymtar-i = (turqisht oxhak-u).

Th

Tharbët (i,e) = që vjen si i thartë (edhe fig): dimër i tharbët = dimër i ftohtë.
 Thardoj = stampoj.
 Tháshëm = që nuk ka ngrënë asgjë, esull (*jam thashëm*).
 Thekuní = emocion.
 Thellonjë = gropë e thellë dhe e shtruar ku mblidhet uji i një burimi (turqisht hauz); gropë uji; ujëmbledhës.
 Thellom/ë/a = vend i thellë në lumë, det a liqen.
 Thepaj/ë/a = vend a majë me shumë thepa.
 Thepak/u = majë e mprehtë, thep.
 Thepç = që është me majë të mprehtë, me thep.
 Thepël/a = copë me thepa e shkëputur nga diçka e ngurtë.
 Thepin/ë-a = hapsirë e thepisur; vend shkëmbor me maja e me thepa.
 Thepor/eja = vend me thepa; vend i thepisur, vend thikë.
 Theqafj/e/a = vend që zbret thikë poshtë; greminë.
 Thëllim = erë shumë e ftohtë; erë që të pret; të ftohtë i madh e i thatë; acar.
 Thëllon = fryn.
 Thërngí-hi = qymyr-i.
 Thiç-i = lloj guri që thyhet me vështirësi; granit.
 Thikës-e = i thikshëm (vend).
 Thile/ja = filik/u, filiq, lak.
 Thirr-i = blozë.
 Thojas = me shumë vështirësi, me thonj e me dhëmbë.
 Thurim/ë/a = send i thurur; gardh.
 Thyesë = lak (*thyesa e litarit*), thysk/ë-a.
 Theyeza = pjesë nga diçka e thyer (gur, mermer, etj.).
 Theyezim = bërje mozaik; theyezoj = bëj një mozaik.

U

Ûall-i = korja e bukës.
 Ubá = animirë, dakort, në rregull, OK.
 Ûb/ël/a = gropë e madhe që hapet në viset malore për të mbledhur ujin e shiut për të pirë bagëtia.

Udhak = udhëtar.
 Udhakím = qarkullim.
 Udhëçelës = udhërrëfyes.
 Udhëtarçe = si në udhë e sipër, shpejt e shpejt (kur hamë).
 Udhisht/ë/a = rrugë e ngushtë; shteg kalimi, udhëz, dhiare, monopati.
 Udhohe = vijë në rrugë të mbarë; hyj në brendinë e një çështje, ia gjej fillin, filloj ta kuptoj e bindem për diçka, përudhem (udhoj = përudh).
 Úf/ëm/ma = vapë e madhe dhe mbytëse; kohë e nxehtë e me re që të zë frymën; bulçim.
 Ujac/ë/a = ujer/ë/a = tokë që mban ujë e nuk kullon plotësisht; ligatinë.
 Ujdhesar/i = ishullor; ujdhesë = ishull.
 Ujbore = ujë që del nga shkrija e borës; ujë i cemët.
 Ujëmirë = që ka ujë të lehtë e të ftohtë: *burim ujëmirë*.
 Ujëmore-ja = burim-i.
 Ujësirë = ujnajë, ligatinë.
 Ujnaj/ë/a = vend i gjerë me ujë; shumicë ujrash që rrjedhin.
 Ujoj = i jap ujë me pi kafshës: *ujova mushkën*.
 Ujor/e-ja = pellg-u.
 Ujvarë = shurqel, balladër, lëvare, katarakt.
 Ultësirë = fushëgropë, rrafshulët, gropësirë.
 Ullak-u = ujë i rrëmbyeshëm shirash që gërryen arat e bie gurë e zall, nganjëherë dëmton rrugët e bagëtinë, etj.
 Unák-u = mjet hekuri për të lartësuar drutë në vatër që të ndizen më mirë.
 Urisht/ë/a = grumbull dheu që ngre urithi kur gërmon.
 Urtyt/ë/a = dredhëz, luleshtrydhe.
 Urrel/ë-a = vijë uji për ujitje e që merret nga një lumë a përrua.
 Ūsh/ël-la = flluskë në lëkurë e shkaktuar nga puna (në duar), nga djegja a nga ndonjë sëmundje.
 Ushka = kaliaqfë.

V

Vaepavá = me ose pa kohë; me ose pa masën ose kohën e duhur: *ai flet vaepava; ai vjen vaepavá*.
 Vagëllimë = muzg, mugëtirë.
 Vajc/ë-a = sythe spangoje a gjalmi për të kaluar gjalmin a tojën për lidhje.
 Vakëmisht/ë/a = vend që e zë dielli mirë, vend i ngrohtë; shullë.
 Vакрëp/e-ja = tokë zallishtë afër detit a liqenit dhe në grykëderdhje të lumejve.
 Vакth-i = pasuri e përbashkët e katundit që përdoret si kullotë.
 Val = gurë të rënë nga mali (*Lugu i Valit, Maja e Valit*).
 Valisht/ë-a = bornajë e përjetëshme; ortek.
 Valor/e-ja = kusi e madhe.
 Valltallëk-u = baltovinë.
 Vallt/ë-a = kënetë.
 Van/ë/a = muri i ngritur rreth grykës së një pusi.
 Vardar/i = vendi ku bashkohen dy përrenj a lumej; uji i dy përrejve a dy lumejve që bashkohen e rrjedhin më tej bashkë; ujvarë e vogël; njëri pas tjetrit, varg, varda (*shkonin vardar, varda*).
 Vare/ja/të = shpat mali i zhveshur, vend shumë i pjerrët e pa bimësi.
 Varosh/i = vend për kullotë.
 Varrosh = dy a më shumë varre bashkë.
 Vashk/ë-a = gjurmë këmbë; fërkem; hulli që le pas lundra a një mjet lundruës, vazhdë.
 Vath/ë-a = vend i rrethuar natyrshëm me gurë e shkëmbinj, ose rrethuar me trina, që ka vetëm një dalje (ose e ndërtuar si e tillë nga bariu).

Vdor/ë-a = borë; dëborë.
 Veçin/ë/a = arë e veçuar nga të tjerat; arë djerrë.
 Veg/ë-a = laku i këmbës, gilca, pjesa në anën e kundërt të kupës së gjurit.
 Vegëz-a = llacë, syth çorapi; vjegë në pikën ku lidhet një litar a tojë; mënyrë lidhje e perit a litarit që të zgjidhet me një tërheqje të tij; gojë, lilë, përhekës.
 Veneraki = brezabel, ngjyros, vijakuqe, brezi qiellit, shoka e kumbarës, vaj e verë e uthull (turqisht ylber).
 Verája-t = të korrat e verës.
 Verdhisht/ë-a = blerishtë, vend i gjelbëruar.
 Verestul-i = vesh rrushi pasi i hiqen kokrat; gërdhajë rrushi.
 Verëz/a = dita e parë e pranverës, dita e verës.
 Vergjo/j-n = del nga pak ujë prej tokës.
 Veri = erë që vjen nga veriu; murrilan; puhi, fresk.
 Verig/ë/a = lak, vjegëz (nyjë e lidhur si lak që mund të zgjidhet lehtë); vesh rrushi; gath, resë.
 Verisht/ë/a = erë e fortë që fryn nga veriu; shakullinë, dredhë.
 Verízí-u = veri shumë i ftohtë.
 Verush/ë-a = erë që fryn para se të ndërojë moti.
 Vesallëk-u = shi i dobët, i lehtë.
 Veshak/e = pjesë e dalë anash në një send, vesh.
 Veshnaj/ë-a = dollapi i rrobave që mbajmë për veshje; garderobë.
 Vesht-i = kufi, teritor: *tashmë ne kemi hyrë në veshtin tonë*.
 Vetanak-u = ai që vepron vetëm sipas kajtjes (interesi të vet); individualist.
 Vetanak-e = privat-e: *këta vetanakët e sotëm nuk shkojnë sipas rregullave të lojës*; + vetjak-e: *mbështetu në forcat e tua vetanake*.
 Veterrik/u = shteg që hapet në vijë të ujit për ta kthyer ujin në arë.
 Vetëtira-t = dridhje të shtatit.
 Vetj/e-a = njeri, individ, personazh.
 Vën/g/gu/gje/gjet = lak i vogël në anët e opingës ku futet gjalmi.
 Vërlim/ë-a = shqetësim i brendëshëm për diçka.
 Vërvejc/ë-a = trap lumi.
 Vërrí = vend i ulët e i ngrohtë që nuk e zë era; kullotë dimërore në vende të ngrohta.
 Vërrkat = kruaj me diçka të fortë.
 Vërrí/a = vënd i ulët që nuk e zë era, vend i ngrohtë; kullotë dimërore në vise të ngrohta; dimërishtë; vërrisht/ë/a = kullotë dimërore; vërrí.
 Vërrvërre/-ja = furtere gështenjash, sagë.
 Vëzhgam/ë-a = zhurma që krijohet nga ecja në një sipërfaqë të mbuluar me gjethe të thata.
 Vgje/ri/nj/njtë = pishë; vgjerishtë = pyll me vgjenj.
 Vica = plot e përplot: *shporta është vica me fiq*.
 Vikam/ë-a = jehonë, ushtimë.
 Vir/i/e/et = vijë uji; vendi më i thellë në një liqen, det, etj.
 Vir/ua/oi = rrjedhë e madhe uji; përrua.
 Vis-i = vend-i (vise-vise = aty-këtu).
 Vis-i = stom a vend i ngritur në fund të arës i krijuar nga lërimi i saj gjatë viteve.
 Visor/e/ja/e/et = ved i hapur që e zë syri të gjithë; pamja e përgjithme e natyrës e një vendi të caktuar; vizatim a pikturë që paraqet një pikturë a peisazh nga natyra, pejsazh, pamje, panoramë.
 Vivar = pellg.
 Vizam/ë-a = vendi ku shkruhet marka e prodhimit të një artikulli për veshje, etiketa e veshjes.
 Viz/ë-a = pushai, pushtamall (turqisht peshqir).
 Vizgator/i = kurth, grackë, lakleq, ngalës (turqisht çark).
 Vjazhg/ë-a = shpat i zhveshur e me gurë të imët ku lëshohet rrëshqanthi landë e dru.

Vjegëz = lak që mundet të zgjidhet lehtë duke tërhequr njërën anë të fillit, vjegë, shtjekë.
 Vndes/ë-a = vendi ku prodhohet një mall: *këto kapele e kanë vndesën në Shkodër*.
 Vojtin/ë-a = varg kodrash.
 Vojvit = bëj punë të vogla, të dorës së dytë: *unë do prashis, për të tjerat, vojvitë, kujdesu ti*.
 Vold-i = kthesë rruge; leqe.
 Vorbëtin/ë/a = gropë e ngushtë si hinkë në një vend malor; gropore.
 Vorbëz/a = gur i bërë si gropë që mban ujin e shiut.
 Vobull = shtjellë.
 Vore = erë e ftohtë e veriut.
 Vrag/ë/a = udhë shumë e ngushtë për kafshë a kalimtarë; dhiare; mbresë; gjurmë.
 Vrajén-i = damar uji i një bunari.
 Vrell/ë-a = burim natyror që del direkt nga toka.
 Vrigjëm = rigë shiu.
 Vrikthi = vrik, rrufeshëm.
 Vriz/ëm/ma = grimcë, thërime, dromcë; fije; shi i imët, një vesë shi.
 Vruj/ë/a = vend ku buron pak ujë.
 Vrujim/i = burim; shushurima e burimit të ujit.
 Vrujisht/ë/a = gropë në bjeshkë, e mbushur me ujë bore që shkrin në verë pak e nga pak.
 Vruj/on/oi/uar = buron (uji, kënga, ndjenjat); shushurin (uji i burimit).
 Vrujinë = lagështirë.
 Vrujishtë = gropë e madhe në bjeshkë e mbushur me borë.
 Vruk-u = bar i gjelbër mbi ujë të liqenit.
 Vrundu/ll/li/jjt = vrull; hov; valë, dallgë (*vrundujt e erës/shiut, vrundulli i mendimeve*).
 Vrushkull/a = + curril, rëke.
 Vuem/e-ja = va për të kaluar më këmbë.
 Vur/g/gu = tokë e ulët që mban lagështirë; kënetë, moçal; lëngu i trashë e i zi që mbetet mbasi shtrydhen ullinjët; murgë (fundëri vaji).
 Vuth = fushë e vogël, shesh.

X

Xaj/ë-a = mjeshtëri, zanat.
 Xangón-i = humbishtë, humnerë, hon.
 Xetje = karthje, krande për të ndezur zjarr.
 Xibërrakë = tokë e keqe që nuk prodhaon = xibërr/a; xibërrishtë.
 Xifnoj = rrjedh nga pak: *vendi rri i lagët ngase xifnon*.
 Xingon/ë/a = humnerë, hon, greminë.
 Xip/i = maja e mprehtë e diçkaje (hostenit).

Xh

Xhëzham/ë-a = zhurmë që bën zjarri kur në të bie ujë a gjë të lagur; zhurma e vajit të nxehtë kur mbi të hidhet veza, etj.
 Xhitër-a = rrodhe.
 Xhol/e-ja = gjurmë shiu në tokë.
 Xhomp = me humb sikur me të përpirë toka: ra gjilpëra e u bë xhomp.

Y

Yfk/ë-a = dru gjysëm i kalbur.

Ylenik-u = vend ku lihen vegla të ndryshme.

Z

Zabel = koriqe; vend me drurë e shkure të dendura.

Zahaq-i = vend pa diell, me bimësi hijedashëse që e do lagështinë.

Zall = gurë relativisht të vegjël në shtratin e lumit, zhur; zallinë, zallishtë (zhurk), shurishtë.

Zanç/e-ja = tapë, shtupë.

Zan/ë-a = bar i kositur në livadh e i mbetur në rrjeshta; arë, kopësht a kullotë e thurrur.

Zblo/k/ku = vend i hapur, shesh.

Zburrage-t = të përbrëndëshmet e gjësë së gjallë.

Zdërhall/em/a/ur = harlisen (bimët); e kaloj kohën me gosti të shfrenuara; dehem në gosti.

Zdërllu/g/gu = vend i ngushtë e i thellë në mes të shkrepave, lug i ngushtë mali.

Zdërvaj = rrëzoj pjesërisht vende-vende: *ka zdërvaj rrebeshi grurin/barin/thekrën.*

Zdirgjem = ulem poshtë; zbres tatëpjetë (*zdirgjem nga bjeshka*).

Zdraj = zbut një teshë/veshje duke e futur në ujë.

Zdrit/zdris = ndriçoj (*i zdit ylli në ballë*); përshkohet nga drita.

Zdritshëm (i)/ e (e) = i përshkueshëm nga drita.

Zdrom = ndyj, fëlliq.

Zefir = erë e lehtë që fryn nga perëndimi.

Zér/e-ja = gjë shumë e vogël, e papërfillëshme (*asht një zére, bahet qerre*).

Zezelin/ë/a = vend që nuk e zë dielli, hijesirë.

Zezon/ë/a = fatkeqësi e madhe, gjëmë; mjerim, rënim, shkatërrim i madh.

Zëmërher/ë/a = koha e zamrës; (koha midis drekës e darkës).

Zgafell/e/ja = vrimë e madhe në mal a kodër; shpellë; guvë.

Zgaj/em-a = lehtësohem duke hequr teshat e tepërta.

Zgaq/i/ë/ët = llum, fundëri; mbeturina.

Zgarb/ë/a = zgavër; zgërbonjë.

Zgëq/i/e/et = vend i ngushtë; qoshe e fshehtë; skutë.

Zgërlyq-i = grykë e ngushtë midis malesh; lug në një vend shkëmbor.

Zgërvallohet = kthjellohet moti, qielli; nisin të largohen retë.

Zgërvellë = plasaritje a çarje e thellë në tokë.

Zgërrojç-e = gur i gërryer nga brënda; që është bërë me bira e plasa.

Zgluq-i = gropë, zgavër.

Zgobinet/ë-a = gobellë, vend i thellë me (në) ujë; gropë natyrore në male.

Zgork/ë/a = gropë në shtratin e një lumi; vrimë; vend i zbrazët.

Zgorr/e/ja = skelet (*zgorreja e njeriut*); vend me shkurre e driza të dendura ku kalohet me vështirësi; blacë.

Zgrapac/ë-a = shteg për të kaluar mbi një gardh.

Zgrip = buza e një gremine, etj.

Zjarmure/t = zjarre të mëdha që ndizen pranë njëri tjetrit në një vend të dukshëm në raste festash, për të njoftuar diçka, etj.

Zguer-i = zgavër në lis; gauk, gorajë, zgurdhë.

Zgur/ë-a = tub, grumbull, gurësh të vegjël të mbledhur nga era.

Zllap = dallgëz e vogël; stërkalë e plotë uji a balte të hollë.

Zmuq-i = mjet me dy rrota e një shkop që në viset malore përdoret për të lëvizur drutë nga një vend në një tjetër.

Zno/n-j = rrjedh nga pak (*një enë me turshi, buti i verës, etj.*).

Zuçam/ë-a = ajër i ngrohtë e i rëndë në një vend të mbyllur.

Zh

Zhagalan/i = zjarr i madh; flakadan.

Zhag/ë-a = vend i lëmuar ose me borë ku zhagiten fëmijët, fuzajë; limozhdë, rrahi, rrëshqitë, vazhgë.

Zhag-u = trastë buke e bariut.

Zhak/ë-a = bërrak/ë-a.

Zhakar/at = drurë, gurë, baltë, etj., që sjellim me vehte lumejtë a përrejtë kur vërshejnë e zbresin me rrëmbim.

Zhamel/i = copë shkëmbi; gur i madh, popël.

Zhardhec/i = helmi i gjarpërit.

Zhargin/ë/a = vend që shembet nga lagështira, tokë që rrëshqet; humnerë.

Zharrjel/ë-a = gur i madh; copë e madhe druri.

Zhaurim/ë-a = erë e fortë dhe e zhurmëshme.

Zhavi-a = gjurma, vraga që lë në tokë druri i prerë në mal e që tërhiqet zhag (zvarrë) teposhtë për në shtëpi.

Zhavor = rërë e trashë e përzier me gurë të vegjël.

Zhdaravit = shpërndaj andej-këndeje.

Zhdjerga/t = festë që bëjnë barinjët kur zbresin nga bjeshkët (*nata e zhdjergave*).

Zhdirdhem = shprishet vetë (*litari u zhdordh*); kthehem menjëherë mbrapsht ose në anën tjetër.

Zheg/u = vapë shumë e madhe; pisku i vapës.

Zhegit/zhegis = kaloj vapën; çoj bagëtinë diku që të mërzejë në kohën e vapës.

Zhgurriq-i = vendi ku derdhet një ujvarë e vogël.

Zhuk/ë/a = burim, uji i të cilit nuk rrjedh në një vijë, po përhapet nëpër sipërfaqe të tokës dhe humbet; vend me shumë lagështirë; buronjë.

Zhumbal/ë-a = gur i madhësisë që mundet të flaket me dorë.

Zhurinë = zhavor i imët; zhur; zurishtë.

Zhurishtë = tokë e keqe e plot zhur.

Zhvalet = bie, derdhet teposhtë: *u zhval bora*; *u zhval një masë e madhe shkëmbi*.

Zhvërrij = ul me dorë a me një mjet diçka që është e varur në një lartësi; zhvjerr: vajza është e vogël dhe mu desht që të zhvërrij setrën e saj.

Zhym/i = hiri që lë duhani kur digjet; blozë (zhymi i kandilit).

Zhym/ë-a = moçalisht/e-ja.

Përgatiti Aleksandër Bojaxhi, Mjeshtër i Edukimit; lekaboja@yahoo.com

Kosovë, Maj 2005 - Shqipëri, Nëntor 2007.